

In Memoriam: Abaz T. Hoxha (1930-2026)

Bashkëbisedimi i pabotuar më parë me studiuesin dhe historianin e kinemasë

ABAZ T. HOXHA

“Aktoren Eglantina Kume e pritën në Kinë sikur të ishte Marilyn Monro!”

Bisedoi: Enver S. Morina



180-vjetori i lindjes së Naim Frashërit (1846-2026)

Poeti i gjuhës së zjarrtë...

(fq. 6)

Nga Ymer Çiraku



Përvjetorët përkujtues të shkrimtarëve, siç është rasti i 180-vjetorit të N. Frashërit, janë “stacione” meditimi e reflektimi rreth vlerave shpirtërore, që ata u kanë sjellë plot përkushtim brezave.

Për asociim përvjetorësh, kujtojmë se si këtu e një shekull më parë, një grup studentësh në Graz të Austrisë (1925), që më pas do të bëheshin pothuaj të gjithë emra të njohur në botën shqiptare, me rastin e 25-vjetorit të ndarjes nga jeta të Poetit - morën përsipër botimin e librit përkushtues me titullin “Naim Frashëri! Vjershëtorit dh’ edukatorit kombëtar.”

Prilli i Kadaresë në Nju Jork

Nga Elidor Mëhilli

E hënë, 27 prill. Ndërtesa me adresën 53 Washington Square Park South ngrihet buzë parkut me të njëjtin emër, i cili sot, si çdo ditë me diell, është i stërbushur me njerëz, kafshë, tregtarë ambulantë dhe muzikë.

SHËNIME MBI LIBRAT

“Dardha lulëzoi në dhjetor” një roman i Shpend Sollaku Noé-së

Nga Fabio Strinati (fq. 7)

Në 85-vjetorin e lindjes së shkrimtarit: Koço Kosta: arkitekti i absurdit dhe gjeografia e tjetërsimit

Nga Luan Rama (fq. 8)

Botohet në turqisht vëllimi poetik “Gjithçka që më pret – Të mbledh diell” Poezia e Visar Zhitit në Turqi Përktheu dhe përgatiti: Eda Zh.

(fq. 10)

Mbi botimin “Themeluesit korçarë të komedisë shqipe”

Komedianët korçarë: rikthimi i një tradite

(fq. 14)

Nga Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)

Diskutim në përrurimin e librit “Falmi sytë e tu, Homer” të poetit Agim Vinca

MES VARGJEVE ME VLERA TË PËRHERSHME

Nga Dimitrov Popoviq (fq. 9)

Historia e një busti të Gjergj Fishtës
MREKULLISHT I SHPËTUAR
Nga Namik Dokle

Romani “Njerëz Normalë” i Sally Rooney-t

A jemi vërtet “njerëz normalë”

Nga Xhoina Salaj (fq. 23)

J. BRODSKI

Ligjërata për qumështin e derdhur

Përktheu nga origjinali dhe pajisi me komente: Agron Tufa



(fq. 20)

BIBLIOTEKË

Mira Meksi (fq. 12)

Frosina e Janinës
Alban Tufa

Katër poezi për katër lloje mungesash (fq. 15)

Artur Baku (fq. 17)

Darka e amshuar

Odise Kote (fq. 18)

Midis meje dhe teje

Besa Kalaja (fq. 19)

Kati i tretë

Arben Meksi (fq. 24)


Karikatura e së shtunës

E diela e heshtur në Kishën e Shën Dhimitrit në Mandricë
Nga Mimoza Hasani Pllana (fq. 5)

Libri shqip në Amerikë

Dërgesa të shpejta dhe të sigurta me një klik

www.albibris.al



Profesioni yt?

Dëgjo se ç'ndodhi. Prirja ime ishte studimore. Qëllime studimore kam pasur gjithmonë. Dërgojnë në Pragë Hysen Hakanin për të studiuar për inxhinier zëri. Hysen Hakanin, regjisorin, e dërgojnë për të studiuar për inxhinier zëri. Ai, gjatë gjithë vitit të parë, nuk dha asnjë provim. S'kishte idenë ç'ishte inxhinieria. Ai kishte prirje artistike. Po të kishte vazhduar si aktor, do të ishte bërë i shkëlqyer. U rrëzua. Atëherë më thanë mua, meqë s'kisha pasur bursë në vitin e tretë, mora bursën. Më në fund shfrytëzova një rast. U hap një pasuniversitar, që e mbaroja fakultetin e inxhinierisë. Ishte një degë që quhej "Teknika e Studiove të Filmit, Radios dhe Televizionit". Dhe kryesisht studimi përqendrohej në optikën akustike, elektroakustikën.

Të zërimt?

Po. Te sallat e kinemave, te sallat e regjistrimit e të tjera me radhë. Edhe mekanikën e precizionit, që ishin kamerat.

Ti tashmë dije gjuhën çeke, rusishten?

Po. Isha në vitin e tretë. Kisha marrë edhe bujë atje. Më thërrisnin. Kisha folur dy herë në Radio Praga në emër të studentëve të huaj, se isha edhe student i mirë, për paqen. Vajta e bisedova me ta. "Më pranoni mua? Unë nuk e kam mbaruar fakultetin. Jam në vitin e tretë. Po më pranuat, ta bëj paralelisht." "Nuk mund ta bësh paralelisht, se këtu ka shumë provime." "Po, sikur të pranoj unë?" u thashë. "Po si je me studime?" "Mirë jam", u thashë. "Merr një vërtetim nga dekanati që ke mundësi t'i bësh të dyja paralelisht." Ajo ishte pasuniversitare. Do ta mbaroja fakultetin dhe do të vija atje. Unë akoma s'e kisha mbaruar universitetin. Mora një vërtetim se isha student i mirë dhe i vazhdova të dyja paralelisht. Vitin e fundit, vetëm për atë degë, përveç degës sime, radarëve, kam dhënë dymbëdhjetë provime. Plus katër që ishin këto të fundit të kësaj dege; gjithsej gjashtëmbëdhjetë provime kam dhënë. Dhe mora atë profilin e Studiove të Filmit, Radios e Televizionit. Në këtë kohë më thonë të shkoj në Kinostudio; kishin ardhur aparaturat, sapo ishin inauguruar, në '52-shin.

In Memoriam: Abaz T. Hoxha (1930-2026)***Bashkëbisedimi me studiuesin dhe historianin e kinemasë Abaz T. Hoxha i pabotuar më parë*****ABAZ T. HOXHA**
"Aktoren Eglantina Kume e pritën në Kinë sikur të ishte Merilin Monro!"**Bisedoi: Enver S. Morina**

Abaz T. Hoxha autor i veprave: "Teknika e Kinoprojeksionit" (1969), "Akustika e mjediseve të brendëshme" (1970), "Filmi Artistik Shqiptar 1957-1984" (1987), "Arti i Shtatë në Shqipëri 1900-1944" (1994), "Enciklopedi e Kinematografisë Shqiptare" (1999), "100 vjet kinema në trevat Shqiptare" (2002), "Enciklopedi e Kinematografisë shqiptare" (2002), "Greta Garbo-Vajza që u kthye në legjendë" (2002), "Kinematografia e vendeve Skandinave" (2002), "Ne u shkolluam në Pragë" (2003), "Historia e Kinematografisë Botërore 1895-1945" (2005), "Historia e Kinemase në Shqipëri 1897-1944" (2007), "Në gjurmë të filmave për Shqipërinë" (2007), "Shqiptarët në kinematografinë botërore" (2008), "Historia e Kinematografisë Botërore vëllimi i dytë 1945-2005" (2005), "Na ishte një herë një kinostudio" (2013), "Vëllezërit John dhe James Belushi" (2015), "Historia e Kinematografisë shqiptare 1945-2000" (2015), "Dallgët e trazura të jetës" (2016), "Historia e kinematografisë Shqiptare 1945-1990" (2021), etj.

Ti kishe njohuri për Kinostudion, për çfarë ndodhte në Shqipëri, nga Praga?

Jo, s'kisha njohuri fare.

Dije që ishte themeluar Kinostudioja?

Vetëm kaq: që ishte themeluar në '52-shin. Unë isha në '53-shin, një vit më vonë, në kohën kur mora këtë degë. Prandaj ishin dërguar studentët për inxhinier zëri, se ishin një teknik.

Kush ishin studentët përveç Hysen Hakanit për film atje, në atë kohë?

Për regji ka qenë vetëm Hysen Hakani. Përpara Hysenit kanë qenë aktorët Kadri Roshi, Lazër Filipi, që kishin ikur tashmë, por që kishin bërë përgatitjen. Më vonë erdhi Serafin Fanku.

Po ti atje takove vetëm Hysen Hakanin?

Hysen Hakani erdhi atje pas meje. Pastaj atë e kthyen në regji dhe u bë regjisor. Erdhi në '57-ën dhe punën e diplomës e ka bërë këtu, atë filmin "Fëmijët e saj". Ishte punë diplome që e mbajti, e mbrojti atje pastaj. Tani, ka me mua një keqkuptim. Meqë aparaturat qenë të gjitha ruse në Kinostudio, unë thashë të njihem me aparaturat para se



të shkoj në Kinostudio dhe, pasi të mbaroj, të shkoj dy-tre muaj në studion e Mosfilm-it, që të njihem me këto aparatura. Më vjen një telegram; nuk e di që është bërë gabim. Thotë që të aprovohet të shkosh gjashtë muaj në Moskë. Më vonë doli se ishte gabimisht. Nuk u aprovua.

Dhe ti nuk shkove?

Nuk vajta. Unë pastaj, sapo mbarova fakultetin, u punësova në studion e filmit artistik në Barrandovë, në Çeki.

Atje fillove punën?

Nja tre-katër muaj punova, se ata hapën një repart që ishte reparti i zërit, që kishte aparaturat si këto; i kishin marrë nga Rusia. Mirëpo çekët bënë disa modifikime. Ato nuk kishin nivel dhe, pas gjashtë muajsh, i hoqën prapë. Kur erdha unë, erdha me këtë psikologji tani: që ato nuk janë aparatura të mira. Në pamjen e jashtme të merrnin në qafë. Ishte një kopjim i dy firmave: një firme amerikane dhe një firme gjermane. "Klangfilm" i thoshin gjermanët. "Klangfilm" do të thotë "film me zë"; prodhimi kështu quhej. Këta i thoshin "Kinap", "Kinematografiçeskaja Aparatura". Po ishte model i gjermanëve, i kopjuar. Dhe aparati i regjistrimit të figurës së zërit, kur hidhej në shiritin e filmit, ishte amerikan, Mitchell. Kështu që unë kthehem në Shqipëri. Mirëpo diplomën e kisha marrë për radarë. Bëra shumë histori! Diplomën e kisha për radarë. Vij këtu; unë prapë e kisha mendjen te radarët, se ishte degë e re. Për herë të parë hapej në Shqipëri. Mirëpo, ku të veja unë për radarët?! Vete në Institutin e Kërkimeve Shkencore; ishte Stefanaq Pollo...

(...)

Këta të këshilluan që të mos shkosh?

Në vitin '56 u pushua drejtori i Kinostudios nga puna, në Konferencën e Partisë të Tiranës. Dhe mbetëm pa drejtor. Unë isha i pari me arsim të lartë.

Vanxhush Zallemit?

Jo, jo, ishte Nesti Zoto. Kishte qenë edhe zëvendësministër i Jashtëm përpara dhe e prunë aty. Ishte njeri me kulturë, me shkollë të mesme, me Liceun Francez. Mbetëm pa drejtor që në '56-ën, në fillim të '56-ës. Nëndrejtorin e kishim me katër klasë fillore. Unë isha i vetmi me arsim të lartë në kinematografinë shqiptare, që e njihja, se vajta edhe në Kinostudion në Barrandovë e ku di unë. Kështu, dashur pa dashur, u futa në degën që doja. Pse? Arrita të drejtoja edhe Këshillin Artistik, diskutimin e filmave, diskutimin e skenarëve, shikimin e filmave. Kjo mua më ndihmoi të ngrihem nga ana profesionale dhe ta njoh më mirë kinematografinë. Deri në vitin '65 unë kam qenë kryeinxhinier. Të gjitha studimet që janë bërë për zhvillimin e kinematografisë i kam bërë. Të gjitha.

Në këtë periudhë kush ishte drejtor?



Drejtori erdhi në fund të '58-ës. Ka ardhur Llazar Lipivani. Ka qenë një njeri i mrekullueshëm.

Domethënë, prej '56-ës deri në '58-ën, ti ke qenë njeriu kryesor?

Isha kryesori. Unë e drejtoja gjithë Kinostudion.

Pikërisht në këtë periudhë u xhirua filmi i parë artistik i metrazhit të gjatë, "Tana"?

Në pesëdhjetë e tetën kishte ardhur Llazari. Llazari ishte njeri me iniciativë. Edhe kishte një gjë shumë të mirë. Ishte i vetmi drejtor, se unë kam kaluar disa drejtorë, që jo vetëm u besonte kuadrove të reja, por, edhe po t'u dilte ndonjë gjë, ai e merrte përgjegjësinë për vete. I mbronte. Edhe u besonte, por edhe i mbronte. Dhe ai ua dha këtë mundësi, të xhironin filma artistikë. Atëherë ishte akoma shpejt për ne; s'kishim mundësi!

Po, si e kujton këtë kohë? Ti që je më kompetenti, që e ke përcjellë kinematografinë, një pyetje e drejtpërdrejtë: cilin konsideron filmin e parë artistik shqiptar: "Fëmijët e saj" apo "Tana"?

"Fëmijët e saj".

Pse?

Pse? Sepse gjithë bota me filmin e shkurtër ka filluar, e para. E dyta, edhe si vlerë. Filmi "Fëmijët e saj" është film shumë i mirë.

Pavarësisht që është i metrazhit të shkurtër?!

Po, dhe kanë marrë pjesë aktorët më të mirë tanë. Marie Logoreci ka pasur rolin kryesor, Naim Frashëri. Kështu që filluan të promovoheshin në kinematografi edhe aktorët e parë. Naimi ishte edhe në filmin "Skënderbeu", edhe Maria ishte, po ka rol të vogël. Po, unë këtë e kam mbrojtur me të madhe gjithnjë: që ai ishte filmi i parë, se unë merrem me historinë e kinemasë. Historia e kinemasë fillon me filmin e shkurtër. Unë nuk mund të abuzoj, sepse i pëlqen njërit apo tjetrit. Mirëpo Hysen Hakani nuk kishte ndonjë mbrojtje, se nuk ishte anëtar Partie. Kristaq Dhamo ishte anëtar Partie. Gjithandej doli "Tana" i pari... Ai shkruante vetë "filmi i parë artistik", ku di unë, deri në vitin '95, kur u bë 100-vjetori i kinematografisë botërore, kur u bë festivali i dhjetë, ishte Vath Koreshi kryetar i Komitetit të Festivalit. Më takon në rrugë, më thotë: "Ku dukesh ti? Ne kemi nevojë." "Pse mos të më thërrasësh ti të më pyesësh?" Po përgatisnin materialet për të bërë festivalin dhe do të festohej 100-vjetori i kinematografisë botërore. "S'më ke thirrur", i thashë unë. "Si të vij unë vetë?" i thashë. "Hajde andej", më tha. Vete unë atje, shikoj materialet. I thashë: "Përse bëhet ky?" Thotë: "Për njëqindvjetorin e kinemasë botërore." "Po filmin shqiptar ku e keni? Mund të harrohet filmi shqiptar, e para?! E dyta, çfarë thoni me këto letra këtu: filmi i parë artistik është filmi "Tana"! S'është e vërtetë kjo! Filmi i parë është "Fëmijët e saj"." "Po", tha, "kështu është shkruar gjithnjë." Kaq dinte ai, se ai kishte ardhur vonë në Kinostudio. Këtë e kishte bërë vetë Kristaqi dhe shokët e tij, "Shiko, historia është histori dhe shkruhet siç është. Unë merrem me histori dhe në histori nxirren krejt dokumentet. Referojuni shtypit", i thashë: "Shkurt, 1958, u shfaq filmi i parë "Fëmijët e saj". Është dokument historik i shkruar në shtyp. Korrik '58 është shfaqur filmi i parë i metrazhit të gjatë, "Tana". Pra ky është i pari; pse do ta mohojmë këtë?!" ... Që atëherë u njoh që filmi i parë është "Fëmijët e saj". Unë edhe në libër këtë e kam vënë.

(...)

Po një ekranizim i veprës së Heminguejit,



po në atë kohë, nga Dhimitër Anagnosti e Viktor Gjika?

Jo, ata ishin studentë në Moskë. Ishte film i Moskës. I Mosfilm-it. Ishin studentë.

Këtu ta kem të qartë, pasi jam i ri në këtë aspekt. Filmi "Skënderbeu" apo "Furtuna" nuk mund të hyjnë, si të themi, te filmi i parë artistik?

Jo. "Furtuna", megjithatë, jo. Flas për ata që i xhiruan vetëm shqiptarët; gjithë forcat krijuese janë shqiptare. "Skënderbeu" mund ta quash filmin e parë për arsye se ka pasur edhe shqiptarë që kanë luajtur. Pastaj muzika. Pastaj ka qenë asistent regjisor. Viktori, për shembull; megjithatë, kanë qenë studentë në atë kohë. Ka pasur skenografinë Stavro Rafaeli dhe një tjetër, bashkë me një rus.

Ishin aktorët?

Po, ishin aktorët: Naim Frashëri, Besa Imami, Marie Logoreci e sidomos kjo, Mamica.

(...)

Një dukuri, pasi tashmë jemi te filmi. U xhiruan, për shembull, "Oshëtimë në bregdet", pastaj "Skëterra". Pse nuk u shfaqën pas xhirimeve, vetëm u shfaqën premierat? Pse u hoqën disa filma? Nuk u shfaqën as në kinema, as në televizion.

Kur?

Në vitet '70, '80; filma të viteve '60? Për shembull, "Oshëtimë në bregdet" nuk u shfaq!

Tani, a e di pse nuk shfaqeshin? Se ishte Kujtim Spahivogli. Luan rolin. Kujtim Spahivogli u konsiderua i padëshiruar, e internuan. Më dëgjon?

Kjo ishte arsyeja?

Kjo ishte arsyeja. "Detyrë e posaçme" u hoq për arsye se ishin tre emra, a katër. Ishte Xhemal Broja, që interpretonte rolin, megjithëse kishte rol negativ, kryetar i Frontit të Rezistencës, ku di unë se ç'ishin ato, diversantët. U dënua Xhemal Broja. Xhemal Broja pse u dënua?! Xhemal Broja ishte një nga themeluesit e Teatrit Kombëtar, ishte një nga veteranët e Luftës Nacionalçlirimtare, po ishte martuar me një ruse. Dëgjon? Dhe u dënua ajo rusja dhe i thanë Xhemal Brojës që duhet ta ndante. Tha: "Unë nuk e ndaj.

E kam grua." "Po do t'ju dënojnë!" "Do të shkoj mbrapa saj." Dhe vajti mbrapa saj. Nuk pranoi ta ndante. Dhe me këtë u bë armik, pse u bashkua me gruan e tij.

(...)

Të kthehemi te viti 1958, kur u shfaq "Fëmijët e saj". Ta them edhe këtë: ishe ti që e vure që të shfaqej? Nuk ishte shfaqur deri në atë kohë? Për kohë të gjatë? Apo për metrazhin e shkurtër?

"Fëmijët e saj" nuk ishte problem, sepse edhe aktorët ishin Naim Frashëri, Marie Logoreci, Loro Kovaçi. Nuk ishte asnjë problem nga pikëpamja ideologjike. Shfaqej nëpër fshatra, se ishte film i shkurtër. Bashkohej me disa filma dhe shfaqeshin.

(...)

Na thuaj më tepër për ngjarjen e 2003-shit.

... Pra, edhe censurë politike ka pasur dhe atje. Dhe më s'është. Unë, në vitin 2003, pata një ftesë në Venecia. Bëheshin evenimente për Shqipërinë dhe unë kisha një masterklasë në Universitetin e Venecias për studentët dhe profesorë. Fola atje për kinematografinë shqiptare dhe u ngrit një profesor në fund dhe më tha — prapë, synonin ata censurën në vendet komuniste — tha: "Puna e censurës?!" "Zotëri", i thashë, "censura nuk ka filluar në Shqipëri, ka filluar këtu tek ju dhe ka filluar jo në dyzet e pestën, por që në një mijë e nëntëqind e tetën (1908), kur akoma kinematografia nuk ishte ndonjë rrezik për publikun. Prandaj", i thashë, "ka lloj-lloj censurash: ka censurë erotike, ka censurë politike, ka censurë të biznesit, se ai do të ketë para dhe nuk i intereson çfarë bën, mjafton që të ketë spektatorë. Prandaj shumica e filmave bëhen për publikun e gjerë, që të tërheqin sa më shumë spektatorin. Atë e tërheq kjo. Pse s'e bëjnë filmin "Skënderbeu", konkretisht, po e bëj unë pyetjen tani? Sepse nuk e ka tregun e madh. Ku do ta shikojnë shumë? Do ta shikojnë në Shqipëri, në Ballkan. Po bëjnë për një princ anglez që mezi është dëgjuar në histori, sepse ai ka shumë shtete që e shikojnë."

Ka shumë shtete që interesohen për atë ngjarje, për atë personalitet?

Pra, të marrim sistemet diktatoriale. Përgjithësisht kanë pasur censurën politike. Hitleri? Hitleri, jo vetëm në kinematografi, por edhe në literaturë. Ai i bëri piring veprat e shkrimtarëve të mëdhenj evropianë, i bëri piring në mes të Berlinit dhe u vuri zjarrin.

Çdo kulturë të huaj e zhdukën, sepse "Deutschland über alles", Gjermania mbi të gjitha, do të thoshin. Por, ama, sa i përket filmit, ishte tepër liberal për erotizmin. Filma nga më të ndryshmit erotikë u xhiruan dhe u shfaqën. Ose ishte tepër i rreptë, sepse çdo film e shikonte Goebbels-i, ministri i Propagandës. Çdo film që kishte emrin e ndonjë çifuti hiqej, zhdukej. Çdo aktor a regjisor që kishte origjinë çifute u persekutua e u dogj në kampet e përqendrimit, ose iku jashtë Gjermanisë. Pra, është censurë politike. Ama kinematografinë sovjetike, edhe vetë Goebbels-i, edhe vetë Hitleri, e adhuronin për forcën e propagandës që bënte. Por jo ajo propagandë, sigurisht; atyre u duhej. Dhe ata kanë bërë një film shumë të madh propagandistik, që, me gjithë mend, është një nga filmat më të fuqishëm propagandistikë të Hitlerit. Ia ka bërë Leni Riefenstahl, regjisore. Ka qenë edhe aktore fillimisht. Quhet "Triumfi i vullnetit".

Kam dëgjuar për atë film. Nuk e kam parë. E kam lexuar te ti, te "Histori e kinematografisë botërore".

Vuri Hitleri në dispozicion të gjitha mjetet. Ajo është një regjisore e madhe, prandaj ia dha të gjitha mundësitë ai. Ajo u bë si perandoreshë e filmit gjerman. Edhe pse edhe ajo origjinën e kishte çifute-polake. Po ajo u vu në shërbim të Hitlerit. Ishte bërë me Hitlerin. Po kështu Italia. Italia, kur e mori pushtetin Musolini, që e ka marrë shumë herët, në '22-shin, '23-shin, i dha rëndësi të jashtëzakonshme filmit dokumentar. Dhe kinematografia italiane, nga viti '23, kur mori pushtetin Musolini, deri afër mesit të viteve tridhjetë e pesë, s'ka asnjë peshë në filmin artistik. Nuk i dha rëndësi Musolini. I dha rëndësi filmit dokumentar për arsye se ishte forcë propagande. Më vonë pastaj e kuptoi që edhe filmi artistik mund të bëjë propagandë. Kur u hap Qendra e Kinematografisë, kur u hapën studiot e Romës, Cinecittà-ja, atëherë mori zhvillim filmi artistik.

Kështu ndodhi edhe në Shqipëri, në vitin 1952, kur u themelua Kinostudioja? Universiteti katër vite më vonë?! Apo pesë vite?

Universiteti në pesëdhjetë e shtatën. Kështu ndodhi edhe te ne. Sistemi? Paratë? Ai që të jepte paratë, ai do të komandonte. Por ama duhet pasur parasysh edhe një gjë tjetër: se nganjëherë ne bëjmë përgjithësimin global që të gjithë filmat e asaj periudhe kanë qenë politikë. Nuk është e vërtetë. Filmi dokumentar, po. Se dokumentari është propagandë. Dhe jo filmi i lirë dokumentar. Mos harroni se janë xhiruar mbi 400

filma dokumentarë për figura të shquara kombëtare, për folklorin, e ku di unë, traditat popullore në kostume, në ndërtime e të tjera me radhë, që janë vlera kombëtare, se tregojnë kulturën kombëtare. Këta nuk kanë propagandë brenda. Fare. Propagandë kanë ata për vizitat e Enver Hoxhës, kongreset e të tjera. Ata ishin filma me porosi.

(...)

Ju ishit vetëm?

Ne do të mësonim nga mishi ynë. Do të mësonim nga vetvetja. Në këtë drejtim kanë një meritë të veçantë këta që kishin studiuar dikur: Anagnosti, Gjika, Kristaqi, etj. Këta që kishin studiuar andej, sepse ata u bënë shkollë për të tjerët. Pra, shumica ishim autodidaktë. Asnjëri s'ka titullin regjisor te ne, me përjashtim të Hysen Hakanit, Viktor Gjikesë e Kristaq Dhamos. Të tjerëve u është dhënë titulli regjisor, por nuk kanë studiuar për regji. Pra, në punë e sipër, kanë xhiruar disa filma. E filluan me filma dokumentarë: Saimir Kumburo, Rikard Ljarja, etj.; pastaj kaluan në filmat artistikë. Kanë bërë filma shumë të mirë. U përgatitën këtu në vend. Shkolla nuk kishim ku të përgatiteshim. Këtë duhet marrë parasysh.

Domethënë, derisa atëherë ekzistonte censura ideologjike, ti thua se sot ekziston censura e producentit?

Po. Patjetër. Shiko filmat që bëhen sot, të lutem shumë! Merre tematikën. Denigrim i vendit. Lejohet kjo?! A e di se ku lejohet kjo? Edhe Italia e bëri këtë pas luftës me neorealizmin. Filmat neorealistë denigronin sistemin kapitalist italian, gjendjen e Italisë pas luftës, që ishte shkatërruar; Italia ishte në varfëri absolute, që nga "Vjedhësi i biçikletave", që konsiderohet

ndër filmat më të mirë. Xhiroheshin në rrugë, sepse studiot ishin mbushur me njerëz të pastrehë. Xhiroheshin rrugëve, me shpenzime të pakta. Dhe tregonin plagët e shoqërisë kapitaliste të asaj periudhe. Ne na interesonin, prandaj ne i shfaqëm gjithë ata filma të neorealizmit. Ama, në dyzet e tetën, dyzet e nëntën, doli një ligj i Parlamentit Italian që ndalonte daljen jashtë Italisë të këtyre filmave. Ndalohej subvencionimi i këtyre filmave. Pse? Se Italia tashmë kishte hyrë në rrugën e demokratizimit dhe këta filma bënë propagandë të keqe. Aq më tepër që Italia ishte në rrezik të kalonte në një sistem socialist, ku Partia Komuniste Italiane ishte duke e marrë pushtetin. Ashtu sikurse edhe në Francë, në këtë periudhë. Pra, u ndaluan. Por, ama, kur këta regjisorët tanë filluan të konsolidoheshin, të krijonin autoritetin e tyre, filluan ta thoshin fjalën e tyre më lirshëm. Nuk i dilte dot përballë kështu meskinit që ta kritikonte, se kishte fituar autoritet. Viktor Gjika apo Dhimitër Anagnosti, e të tjerë. Pra, gradualisht filluan të shkëputen nga ajo censura e fortë e dikurshme.

Sidomos në vitet e tetëdhjeta?

Po. Bile atëherë u bë një plenum i Lidhjes së Shkrimtarëve për kinematografinë. Është bërë në Muzeun Kombëtar. Aty ka një liberalizëm të plotë. Filluan diskutime të hapura. Sekretari i Lidhjes së Shkrimtarëve atëherë tha, duke iu drejtuar shkollave: "Mos kini frikë nga izmat, të keni kurajë." Atëherë ishte një investim. U ngrit Kujtim Çashku atje, hodhi disa teza shumë të mençura, se Kujtimi ka qenë me kurajë. Kupton, është një çikë i çakërditur, por është një regjisor shumë i mirë. Dhe ka thënë fjalën e tij. Bile atëherë edhe i vunë ca nofka. Meqë kishte qenë nja dy vjet në Rumani, nuk i thoshin Kujtim Çashku, por Kujtim Çausheku. Ne jse. Pra,



me konsolidimin e regjisë, gradualisht filluan të fitojnë autoritet, aq sa censuresit s'kishin kurajë t'i kritikonin. Pse? Se përballeshin me njerëz tashmë të stabilizuar. Kjo ishte njëra. Edhe autocensura vetëkuptohet. Plus kësaj u treguan një çikë të zgjuar. Morën disa tema; shumica e temave nuk kishin shumë lidhje me politikën.

(...)

Në kohën e izolimit, kur ishit hapur me Kinën, ishit në Kinë?

Jo, nuk isha. Por kinezët kishin mësuar nga filmi shqiptar.

Kinezët kanë mësuar nga filmi shqiptar?!

Kinezët kanë mësuar. Dhe është e çuditshme që edhe sot jehona e filmit shqiptar në Kinë është e madhe.

E madhe vërtet ishte. Eglantina Kume ma ka thënë këtë.

Eglantina ma ka thënë edhe mua. Ta them unë. Atë e pritën sikur të ishte Marilyn Monroe, në aeroport, sa që u çudit i biri dhe tha: "Çfarë jemi ne këtu?" E pritën në aeroport me duartrokitje.

Ashtu më ka thënë.

Dhe kur udhëtonte me makinë, i thotë shoqëruesi: "E njeh se kush është? Është filania." Ai fillonte të këndonte këngën e filmit.

"Ngadhënjim mbi vdekjen"?

Po, kështu, në kinezçe. Ose një regjisor, që më vonë, kur u hap Kina, shfaqti një film në Bruksel, më duket, dhe kishte vënë fragmente nga filmi shqiptar. Dhe i bënë pyetje: "Ç'është ky?" "Shiko", tha, "ne shkolla shqiptare na ka përgatitur. Filmi shqiptar na ka dhënë një mesim të madh për atë kohë." Se ajo i merrte filmat dhe i bënte në 5000 kopje, se ishte numër i madh. Në pesë mijë kopje shfaqej filmi. I këndonin rrugës këngët e filmave shqiptarë në atë kohë. Do të thuash ti që ishte vend i mbyllur? Ishte si ishte, po ama pati influencë në një vend me një miliard e ca banorë.

(...)

Po, 1971, 1972, ku të zuri ty?

Unë në '73-shin kam ikur nga ky sektor, vajta në Arkiv.

Si e përjetove rastin e arrestimit të Edit, të Mihos, të të gjithë atyre?

Ajo ndodhi në '74.

A nuk ndodhi pas Festivalit të Këngës në RTV?

Po, po, po mund të jetë në '72-shin! U hoqën këta filma ku interpretonin këta. U hoqën nga qarkullimi. Konsideroheshin të padëshiruar. Unë, kur kam vajtur aty, kishte edhe absurditete. Kishin frikë njerëzit, dhe kishin të drejtë. Përpara se të isha unë atje, ishte një inspektor i kinemave që e drejtonte programacionin, filmat që shpërndaheshin nëpër rrethe. Vajta unë dhe kishte hequr nga qarkullimi mbi 480 filma të huaj. Shumica ishin filma rusë; ne s'kishim marrëdhënie me Rusinë, por edhe të tjerë. Vete e shiko një listë të tërë me mbi 485 filma të hequr. I them: "Me se do t'i furnizojmë kinematë? Po pse i keni hequr këta?" "Po ja, me rusët kemi marrëdhënie kështu, me çekët kemi këto marrëdhënie, me këta gjermanët kështu." "Ore i dashur", i thashë, "këtu, në këta filma rusë, shumica janë filma që kanë lidhje me historinë. Nuk janë të gjithë të Revolucionit Socialist. Kanë kompozitorin Glinka, kanë të bëjnë me këtë shkrimtarin e madh amerikan Xhek Londonin, kanë të bëjnë me kompozitorë, shkrimtarë dhe gjithë të tjerët, me radhë. Kanë histori të periudhës së lashtë ruse. Ka përralla." Edhe unë merr e shiko, hidh në qarkullim. Arrita në afërsisht 480. Pesë filma më mbetën pa i hedhur në qarkullim.

(...)

Ta përfundojmë kapitullin për Kosovën. Te filmi shqiptar i Kosovës.

Në çfarë aspekti?

Kur e pe ndonjë film nga Kosova, ndonjë regjisor?

Fillimisht e kam parë filmin në të cilin luante Abdurrahman Shala. Ishte një regjisor serb.

"Si të vdiset", edhe me Faruk Begollin?

Jo.

"Uka i Bjeshkëve të Nemuna"?

Po, "Uka i Bjeshkëve të Nemuna".

Ai është një nga filmat më të shikuar, për shkak se është shikuar edhe në Kinë.

Atë e kam parë të parin nga filmat e Kosovës. Edhe këtë me Bekim Fehmiun, te filmi "Mbledhësi e puplave". Pastaj me Bekim Fehmiun kam parë edhe të tjerët. Vinin nga Italia, se nuk kishim lidhje me jugosllavët.

Tiranë, 12 dhjetor 2015



Prej tavolinës ku po pija kafënë, shihja këmbanoren si një kullë të vetme, kryelartë mbi të gjitha çatitë. Jo se ishte aq e lartë, por diferenca krijohet ngaqë shtëpitë përreth ishin dykatëshe, prandaj këmbanorja dukej si një obelisk i vetmuar. Kur e pashë ashtu, gjëja e parë që më shkoi në mendje ishte: mos vallë ishte rrënuar apo shembur Kisha? Këto mendime më erdhën shpejt, si vetëtima. Ashtu si erdhën, edhe ikën. Brenda pak sekondash u kthellova dhe nisa ta arsyetoja veten pse më shkoi mendja pikërisht aty. Ndoshta ishte një ndjesi instinktive e krijuar nga vendi prej nga vij, i cili më ka ngulitur bindjen se ndërtime të tilla nuk mund të qëndrojnë gjatë në këmbë dhe se e vjetra shpesh rrënohet për t'i lënë vend të resë. Thujse asgjë e kësaj natyre nuk ka mbetur, kështu ne shpesh herë kemi zhdukur edhe shumë shenja të kujtesës sonë arkitektonike e kulturore, të një kohe ndërtimi si ajo që shihja para meje.

Me përshtypjen se mesha fillonte në orën 09:00, ndonëse askush nuk ma kishte konfirmuar këtë, u nisa drejt oborrit të kishës, që ndodhej përballë hotelit të fshatit "Bukur shtëpi". Hyra vetëm pak minuta para orës nëntë, me njëfarë dileme se mos isha vonë dhe se njerëzit mund të kishin hyrë tashmë brenda. Megjithatë, këto mendime i lashë pas dhe u ula në oborr, e tërhequr nga hijet e disa drunjve të mbjellë në vijë të drejtë. Edhe hijet e tyre ndiqnin të njëjtën vijë. Hijet ishin të rrumbullakëta, si kupola të vogla, pasi degët e tyre ishin krasitur me kujdes në forma rrethore.

Nën njërën prej këtyre hijeve takova një banore. Nga hijja im e përshëndeta shqip:

- Mirëmëngjes.
- Nuk vi gegja (nuk të dëgjoj), më tha.
- Jam e re në fshat, dje erdha në Mandricë, ia ktheva.
- Mirsen jertë dë, me shindet (mirë se erdhe), ma ktheu.
- A flet shqip?
- Da (po).
- Mirë.
- Mirë.

Kaq mjaftoi për të kuptuar se këtu më duhej një përqendrim tjetër për të folur dhe për të kuptuar në gjuhën e njejtë. Nuk shtova asgjë më tej. Si në heshtje, u nisëm bashkë drejt Kishës. Që në hapat e parë vendosa të eci krahu me të dhe madje të ulem pranë saj kur të hyjmë brenda. Mendova t'ia jap fletoren që kisha me vete, që të më shënonte fjalët që më tha, nga të cilat, kisha kuptuar vetëm dy: "mirë" dhe "da", njërën nga shqipja, tjetrën nga bullgarishtja. Në heshtje ramë dakord të vazhdonim rrugën e mbetur bashkë.

Në hyrje na priti Katerina Hristova Ilieva, duke na uruar mirëseardhe me përqafime. Ajo na tregoi se brenda ndodhej baba/gjyshe Sulltana, e cila dinte shumë këngë shqipe dhe mund të rrëfente për zakonet dhe jetën e dikurshme të fshatit. Sipas saj, ajo kishte kujtesën më të mirë dhe më të hershme në fshat, duke qenë edhe e vetmja që kishte festuar më shumë se nëntëdhjetë ditëlindje, ndër kohë që gëzonte ende shëndet të mirë fizik dhe një kujtesë të mprehtë për të shkuarën. Me të njëjtën dashamirësi tha se së shpejti do të vinin Kostadin Georgie Beishev dhe Katia Kostadinova

E diela e heshtur në Kishën e Shën Dhimitrit në Mandricë

Nga Mimoza Hasani Pllana

(Vijon nga numri i kaluar)



Veleva. Më pyeti se me kë dëshiroja ta nisja bisedën dhe, duke e falënderuar, i thashë se do të vazhdonim pas përfundimit të Meshës.

- Në ç'orë vjen prifti dhe kur fillon ceremonia? - e pyeta.

Ajo më shpjegoi se prej kohësh nuk mbahej meshë dhe se prifti nuk vinte më në Kishën e fshatit. Në fshat kishte vetëm shtatë a tetë banor, të cilët mblidheshin të dielave, ndiznin qirinj, luteshin dhe më pas kalonin kohë së bashku në restorantin përballë. Kjo bisedë zgjati më shumë se zakonisht, pasi të dyjave na duhej sqarime shtesë, pavarësisht pritjeve tona se do të kuptoheshim lehtësisht pasi që flisnim shqip.

xxx

Brenda, në muret e Kishës, më ranë në sy disa fotografi të varura në mure. Në disa prej tyre shiheshin gra të buzëqeshura me veshje tradicionale, në të tjera, fëmijë, ndërsa në fotografitë e fundit, gra dhe burra së bashku, sikur festonin diçka. Thujse të gjitha ishin bardh e zi. I lashë për më vonë, me dëshirën që dikush të më shpjegonte më shumë rreth tyre.

Në sallën ku prisja të mbahej Mesha, pashë vetëm një grua ulur në karrige, me shikim drejt derës, ndërsa altarin e kishte në anën e djathtë. Flokët i kishte krejt të thinjuara, shikimin e butë dhe buzëqeshjen e ngrohtë, fytyrën plot me rrudha që

i rrinin për hijeshi. Kjo pamje më krijoi ndjesinë sikur këtë gura e njihja prej kohësh, ndaj i afrova e përshëndeta dhe e përqafova. Më ftoi të ulesha pranë saj, duke lëvizur lehtë dhe duke rregulluar fustanin e saj deri në gju, një gjest fisnik që më kujtoi elegancën e grave të dekadave të kaluara, atë finesë që nuk del kurrë nga moda.

Zonjës Sulltane Gramenova Aleksandrova i tregova se kisha parë një video ku ajo këndonte këngë nga fëmijëria e saj dhe se ato këngë përbënin një ndërthurje fjalësh shqipe dhe bullgare, ndoshta edhe elemente të tjera gjuhësore, të cilat nuk arrija t'i dalloja plotësisht. Më pas, për disa minuta folëm për ne të dyja, për familjet tona, për jetën e saj në Mandricë dhe timen në Sofje e në Prishtinë, aq sa mundëm të kuptoheshim, pasi komunikimi ynë zhvillohej mes dallimeve të dukshme gjuhësore.

Unë përpiqesha t'i përgjigjesha pyetjeve të saj, si: nga vjen/ga ha jesh, çfarë punon/çe pënosh dhe si quhesh/kush sohesh, por jo lehtësisht arrija t'i kuptoja fjalët e saj, për shkak të dallimeve të dukshme që paraqet e folmja e Mandricës në raport me shqipen e sotme. Në këtë situatë, më duhej të tregoja vëmendje të shtuar, duke u mbështetur në kontekst, në gjeste dhe në fjalë të njohura nga një fjalor që kisha lexuar paraprakisht lidhur me të folmen e Mandricës e që në bisedën tonë shfaqeshin herë pas here në pyetje të saj.

Vazhdon: Këngët dhe veshjet popullore të Mandricës



Kisha e Shën Dhimitrit në Mandricë



Katerina Hristova Ilieva dhe Sulltane Gramenova Aleksandrova



Këmbanorja e Kishës

Përvjetorët përkujtues të shkrimtarëve, siç është rasti i 180 vjetorit të N. Frashërit, janë "stacione" meditimi e reflektimi rreth vlerave shpirtërore, që ata u kanë sjellë plot përkushtim brezave.

Për asociim përvjetorësh, kujtojmë se si këtu e një shekull më parë, një grup studentësh në Graz të Austrisë (1925), që më pas do të bëheshin pothuaj të gjithë emra të njohur në botën shqiptare, me rastin e 25 vjetorit të ndarjes nga jeta të Poetit - morën përsipër botimin e librit përkushtues me titullin "Naim Frashërit! Vjershëtorit dh' edukatorit kombëtar." Në libër janë përfshirë me shkrime apo me krijime letrare disa emra si: Asdreni, Lasgush Poradeci, Norbert Jokli, Sevasti Qiriazzi, Lumo Skëndo, Krist Maloki, Et'hem Haxhiademi, Safet Butka etj.

Siç e theksojnë ata studentë në "Parafjalën" e librit, synimi i këtij botimi nuk ish aq "mbushja e një detyre kujtimi, se sa më tepër të rrëmuarit e drejtimit të veprës së Naimit në palcën e saj dritëdhënëse për një stërvitje kombëtare të vërtetë..." Krahas autorëve të shkrimeve të tjerë, Krist Maloki do të botonte këtu një pjesë të studimit të tij të njohur "Naim Frashërit", ku veç të tjerash, vrehet se për herë të parë në kritikën letrare shqiptare, ai aplikon metodën studimore psiko-analitike, e cila, sapo kishte nisur të qarkullonte edhe në Europë aso kohe. "Si një yll i mallshëm e përcjell ky emën rrokullitjen e botës s' onë shqipëtare... gjithmon i pagj[q] shëm e gjithmon plot dritë", do ta projektonte profilin e këtij poeti, ky kritik i talentuar.

Ky libër i studentëve shqiptarë, i përgatitur në përkujtim të Naimit, ishte në fakt dëshmi dhe apel i fortë "antiamnezije", dëshmi dhe apel i mbajtjes gjallë të kujtesës e të shpresës. Autorët e përfshirë në të, ardhur nga vise të ndryshme të Shqipërisë, madje deri dhe nga arbëreshët (Terenc Toçi), me zellin e dëshmuar shërbestar e adhuronjës për misionin/detyrën e marrë përsipër, na kujtojnë e na ngajnë ashtu si ata rojtarët e kujdestarët besnikë, apo si rabinët e përkushtuar ndaj librave të shenjtë, ndaj Testamentit të Madh. Në këtë rast, të Testamentit Poetik Naimian. E këta të ashtuquajtur rojtarë besnikë të kujtesës/memories sonë kombëtare, janë përcjellësit për te të tjerët i atyre Porosive, që vijjnë prej asaj Kujtese.

Dikur, një shkrimtar i njohur european pati shkruar se kufijtë e një vendi, d.m.th. integriteti dhe egzistenca/siguria e tij, mund të ruhen me ushtarë – ose me statujat e poetëve. Atëhere, ashtu si për çdo popull e çdo komb tjetër, pa mëdyshje mund të thuhet se poetë shqiptarë të përmasave si Naim Frashëri, janë dhe mbeten shtyllat vertebrale e të sigurta të shqiptarisë. Dhe do t'ia vlen të popujt t'ia mbërrinin asaj dite, që përfundimisht - ata kufij realë e kulturorë, të mund të mbrohen me "armët" më të sigurta e më paqësore, pra, me shpirtin dhe dritën e kulturës e të artit të tyre identitar, të përcjellë përmes magjisë së letërsisë. Këtë vlerësim do ta formulonte edhe gjuhëtari i shquar Eqrem Çabej, kur shkruante qyshse ishte fare i ri për N. Frashërin se ai: "është frymë nga fryma jonë dhe gjak nga gjaku ynë". E portretizon Naimin si një apostull të idesë nacionale, si një patriot të madh panshqiptar e jo lokalist, si një idealist të kthyer me të drejtë në simbol e gati një mit, një legjendë e nacionit shqiptar (shih: E. Çabej "Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe", botim anastatik, 2009, Tr.)

Vepra letrare dhe kontributi i gjithanshëm prej misionari i Naim Frashërit, dihet se ka fituar një status të lartë nderimi. Me emrin e tij janë pagëzuar në hapësirat shqiptare një mori shkollash, rrugësh, institucionesh dhe aktivitete të ndryshme. Njëri prej tyre, është edhe Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit", i cili, vazhdon që të organizohet suksesshëm prej mbi një çerek shekulli në qytetin e Tetovës, në Maqedoninë e Veriut.

Asdreni, autori i Himnit të Flamurit kuq e zi shqiptar, po ashtu autor i lirikave të shumta atdhetare dhe filozofike - do t'ia drejtohej kujtimit të poetit me mirënjohjen e thellë, si

(180-vjetori i lindjes së Naim Frashërit 1846-2026)

Poeti i gjuhës së zjarhtë...

Nga Ymer Çiraku

atit të vet shpirtëror: "...t'adhuronj me mall e besë, se bashk' me zërin t'ënd hyjnor jam rritur..."

Dhe ndikimi i Naimit do të ishte vërtet fort i ndjeshëm te poetët dhe shkrimtarët e mëpasëm, të cilët, siç do të shkruante nga të parat shkrimtare femra shqiptare, Musine Kokalari, ata shihnin tek ai Apostullin e Kombit. Ky përcaktim sublim për të, nuk do të vinte prej ndonjë autoriteti të jashtëm ndikues apo imponues, por veçse natyrshëm - prej pengut për të dëshmuar nderimin e një misionari, i cili, e shkriu jetën e vet për kauzën e Atdheut. Dhe kjo sakrificë e tij si prej një shenjti, vinte sepse, siç shkruante për të Lasgush Poradeci:

Se guxove të na thuash me kalem të zi në kartë,

Mall' e Math që të pat djegur. Fjalët e Gjuhës së Zjarhtë... (poezia "Naim Frashërit")

L. Poradeci do ta cilësonte Naimin një figurë qendrore të kulturës shqiptare. Madje, që ishte fort i dalluar mes asaj plejade patriotësh, të cilët, derdhën pa u kursyer në asnjë çast e në asnjë rrethanë sado të vështirë për ta, gjithë energjitë e tyre - për ta ndriçuar e për ta drejtuar popullin drejt horizonteve të përparimit dhe të çlirimit kombëtar. Dhe Naimi i jep kësaj lëvizjeje historike "...mistikën e udhëheqësit të madh, zemrën e profetit, pa të cilën, s' është e mundur ndjekja e asnjë ideali". (L. Poradeci, Vepra II, Onufri, 1999). Lasgushi e vlerëson Naimin si poetin kombëtar të shqiptarëve, simbol të bashkimit.

Në Shoqërinë e Stambollit, që do të ishte një vatrë e përgatitjes së Rilindjes Kombëtare, Naimi mbetej figura vendimtare, që vokacionin e tij poetik do ta kthente edhe në një bosht ideologjik, pikërisht në orientimin drejt qytetërimit Perëndimor. Do të ishte një boshllëk i madh për kohën do të shkruante Lasgushi "... pa Poetin e atij shkrimi [në fushë të letërsisë e më gjerë], pa prijësin e atij qëllimi, pa Misionarin e atij bashkimi, pa Apostullin

e asaj dogme, pa profetin e asaj Feje. Naimi ndërhyq dhe i jep Shoqërisë shpirtin për të cilin [ajo] kish nevojë, i dhuron shenjën e yllit që duhej të jetë ajo për Lëvizjen. Ay bëhet simboli i saj me vjershën e tij të zhuritur atdhetore, e cila, sikundër ish vet e zhuritur, zhuritte dhe rrëmbente me vete gjithë sa e këndonin, sa e dëgjonin, dyke i tretur dhe purifikuar në zjarrin e madh të bashkimit fetar dhe kombëtar të të gjithë Shqiptarëve..."

Edhe një personalitet si Faik Konica, mjaft buzëhollë në vlerësime, sidomos kur është fjala për letërsinë, por edhe inatçor që s' i harronte meritë e krijuara, siç ishte rasti me Naimin (deri sa do ta quante me nerv zëmërak si "poetin e ti-ti-ve dhe to-to-ve"), nuk do të kursehet t' i bëjë vlerësimin e merituar: "Unë dua vetëm në pak fjalë, të them se ç' punë të fortë e të palodhur bëri ky burrë me fletë për kombësinë tonë...i ditur, i mbaruar në greqishte të vjetër e në persishte e në shumë gjuhë të tjera, mendjelëruar e ndjesihollë, do të kish mundur e dëshëronte të shkruajë gjëra më pak të nevojshme e më shumë të bukura... U kufizua pra, në qark të ndershëm e të shkëlqyer të mësimit kombëtar. Jo se nuk gjenden në libra të Naim beut faqe të hieshme e të mbaruara; janë, përkundra, të dëndura, por rrëfejnë veç të gjitha dëshirën [para së gjithash] të mësohet kombi..." Dhe ka bindjen se me ndarjen e poetit nga jeta, vërtet e shpunë në Stamboll për t' u prehur në banesën e fundit, por kjo nuk është tjetër veç "një mënyrë foljeje", sepse do të vijë dita ta presë një komb i tërë. Sikundër ndodhi. Prehen këtu jo thjesht dhe vetëm eshtrat, por para së gjithash, është i pranishëm autoriteti sovran i personalitetit të tij.

Naim Frashëri është poeti, që prmes artit të tij poetik e lëvroi mjeshtërisht shqipen. Ai ia arriti të derdhë në krijimet e veta, tërë



stolitë e saj të çmuara. Qëmtoi dhe gjallëroi fjalët e "fjetura", apo të struktura në të folmet e krahinave, e pastroi nga "ferrat" e fjalëve të panevojshme të huaja dhe e pasuroi si rrallë kush tjetër me fjalë të reja, të krijuara prej atij vet, të kulluara dhe të selitura prej thesareve të gjuhës amtare. Këtë do ta vinte në dukje edhe gjuhëtari e albanologu i shquar european, Norbert Jokli, i cili, e krahason metodën e Naimit për pasurimin e shqipes me principet e Leibnitz-it (1646-1716) për pasurimin e gjermanishtes, veprën e të cilit me sa duket, poeti e ka njohur nga përkthimi i saj në frengjisht më 1768. Dhe dihet se krahas gjuhëve të tjera, Naimi njihte mirë dhe frengjishten. Shumë fjalë si: dritare, fletore, vjershëtor, të pasmit, mëmëdhe, qytetëri, fatbardhësi, padijë, poshtëri etj. zënë vend në krijimtarinë e Naimit dhe shumica e tyre kanë fituar statusin e përdorimit në gjuhën e sotme shqipe. Ato janë sjellë nga "ringjallja" e fjalëve të vjetra të përdorura nëpër dialekte, të ndeshura në tekste të ndryshme të autorëve të vjetër, në tekste liturgjike etj. Ka dhe mjaft fjalë të krijuara nga vet Naimi, përmes përshtatjes nga gjuhë të ndryshme, apo të modeluara sipas ligjësisë të shqipes.

Por mbi të gjitha, Naimi solli në botën shqiptare ide dhe dëshmi krenarie mbi historinë dhe fatet e Atdheut.

Në ceremoninë jubilarë me rastin e 40 vjetorit të vdekjes së poetit (1940), organizuar gjatë pelegrinazhit në vendin ku do të preheshin eshtrat e tij, Ernest Koliqi do të theksonte zjarrminë atdhetare që kishte në shpirt ky njeri, si një ndër apostujt më të autoritetshëm të "vllaznimit" të shqiptarëve. Tërë vepra dhe jeta e Naimit dëshmoi fuqishëm lidhjet e thella dhe misterioze të gjakut e të gjuhës mbi ndasitë fetare dhe krahinore. ("Bota e re", nr. 12/1940) Ai do të mbetej vizionar në përcaktimin e padiskutueshëm të shqiptarëve në qarkun e qytetërimit perëndimor dhe do të jenë kuptimplotë ato vargje, ku poeti e shpalos poetikisht këtë përkatësi natyrale të shqiptarëve. Prandaj e shqipton në mënyrë apelonjëse edhe thirrjen për ta rigjetur sa më shpejt atë vend të përtjetërsueshëm, por tragjikisht të tronditur e të përhumbur, nëpër rrugët e vështira të historisë sonë:

*Jak' o ditë e uruar
Që lind nga perëndon,
Atë anë e ke ndrituar
E ne, pse na harron?...*

Siç do të vrente një nga studiuesit e apasionuar dhe të ngulët të veprës naimiane (Jorgo Bullo), N. Frashëri është poeti që e pasuroi me një frymëzim të ri traditën poetike të shqipes, duke nyjtuar zëra të tjerë të panjohur më parë prej saj të shpirtit njerëzor, edhe atëhere kur i këndoi mallit të mërgimtarit, edhe atëhere kur venitet nga malli i dashurisë, edhe kur kridhet në mjergullën e misticizms bektashiane dhe kur shkëputet prej saj, edhe kur ngrihet në qiejt e meditacioneve metafizike, edhe kur zbret në tokë... Duke ndjekur përcaktimin metaforik të këtij studiuesi, kjo krijimtari e begatë, bën pjesë në atë nivel të lartë arti poetik, që është magji e vërtetë mbresëlënëse. Dhe vet poeti i saj, mbetet si një ndër "magjistarët" e endjes virtuoze të fjalës shqipe.

Pra, lirika poetike e Naimit, dëshmoi mundësitë e pakufizuara të gjuhës shqipe për të shprehur e për ta derdhur artistikisht tërë pasurinë e ndjenjave njerëzore dhe idealeve patriotike. Përmes krijimtarisë së tij, poeti arriti që të krijojë një tipologji të pasur stilistike e tematike, duke nisur që nga poemat



epike narrative, lirikat përsiatëse meditative, të peizazhit e të dashurisë. Këto krijime u endën mjeshtërisht përmes një frymëzimi spontan, fryt i talentit të begatë dhe i kulturës së pasur, të fituara prej atyre të lindjes e të perëndimit. Këto dije të gjera e të thella, nuk mbetën stoli të jashtme dhe as një amalgamë informacioni eklektik apo enciklopedik, por u shkruanë organikisht me epërsinë dhe finesën artistike, në hapësirat e vargjeve të këtij opusi të gjerë letrar.

Për vet përmasat e pazakonta të këtij personaliteti, veprës së tij i janë drejtuar studiues të kohëve e disiplinave të ndryshme. Nuk kanë munguar dhe shkrimtarët me vlerësimet dhe përkushtimet letrare ndaj figurës së tij si: Lasgush Poradeci, Ismail Kadare, Ernest Koliqi, Nonda Bulka, Dritëro Agolli, Ali Podrime, Fatos Arapi, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo, Zija Çela, Qazim Shemaj, Ilirian Zhupa...

Në një nga poezitë kushtuar Naimit, D. Agolli do të shkruante:

Vargjet e tua me thërrimet e dheut janë përzierë

*Dhe na duket se me qënien tonë janë shkrirë,
Se i kemi thithir mes qumështit, frutave, erës
Dhe në burime me ujin i kemi pírë...*

*Ti si bujk i mirë lërove arën e fjalëve,
Arën e fjalëve të stërgjyshërve mbetur djerrë,
Mbuluar nga barëra të liga të maleve,
E lërove që djerrë mos të mbetej asnjëherë...*

("Naim Frashëri")

Po ashtu nuk kanë munguar dhe gjuhëtarë, historianë e antropologë, të cilët, kanë depërtuar në përmasat komplekse të kësaj vepre e të këtij kontributi në tërësi, ku vlerat letrare estetike, transmetojnë e gërshetohen edhe me nyjëtime idesh e trajektore të gjera epokash historike, kulturologjike, religjioze, gjithnjë në funksion të një depërtimi sa më të thellë të mesazhit të transmetuar. Mes tyre mund të përmenden: Eqrem Çabej, Namik Ressuli, Rexhep Qosja, Dhimitër. S. Shuteriqi, Alfred Uçi, Ali Xhiku, Jorgo Bulo, Sabri Hamiti, Engjëll Sedaj, Idriz Ajeti, Norbert Jokli, Androkli Kostallari, Adriatik Kallulli, Jani Thomaj, Gjovalin Shkurtaç, Kristo Frashëri, Mahmud Hysa, Qemal Haxhihasani, Zija Xholi, Gazmend Shpuza etj.

Studiuesi R. Qosja ka realizuar mbase studimin më të plotë deri më sot rreth figurës së Naim Frashërit, duke e sinjalizuar metaforikisht veprën e tij si një Porosi të Madhe, e cila, vazhdon që të përcillet sot e kësaj dite dhe do të vazhdojë të përcillet ndër breza edhe në të ardhmen. Ky studim është një "skaner" shkencor mbi gjithë strukturën letrare të veprës së Poetit. Brenda këtij titulli të veprës së tij të gjerë monografike ("Porosia e madhe"), studiuesi dëshmon epërsinë e një personaliteti, që i kapërçen epokat. Dhe në mbështetje të kësaj teze, kujton atë që thekson filozofi i njohur i antikitetit Platoni për Homerin, se ky shkrimtar i madh me veprën e tij, e ka edukuar krejt Greqinë. E sipas studiuesit kjo mund të thuhet edhe për Naim Frashërin, pasi vepra e tij, ka ndikuar në popullin shqiptar më shumë se një sërë institucione kulturore e politike. Është fjala se figura të tilla, me veprën dhe aktivitetin e tyre, arrijnë që të kthehen vet në institucione të autoritetshme. Autori thekson se: "Naim Frashëri është bërë mësuesi i popullit shqiptar, kurse vepra e tij, mbetet pjesë e pandarë e vetqënies së tij shpirtërore dhe morale, sepse për shumë kohë të pastajme, ia ka ndriçuar rrugën..."

Dhe pikërisht ky dimension i pazakontë i këtij personaliteti, e ka kthyer Naimin në një përmendore nderimi për çdo shqiptar.

Prandaj dhe vjen natyrshëm ajo që shkruante dikur Ernest Koliqi plot nderim për të: "Naim, emni i Yt, ka me u përmendun ndër urime e ndër bekime!"

Populli e ka skalitur dhe e ka përjetësuar Poetin me vargjet sublimuese: "Naim Frashëri Shqipëria..."

Kjo konfirmon fuqinë e Testamentit Poetik të veprës naimiane, i përcjellë ndër breza dhe duke i dhënë kështu asaj Veprë, vendin fort të meritueshëm në Panteonin letrar shqiptar.

"Dardha lulëzoi në dhjetor" një roman i Shpend Sollaçku Noé-së

Nga Fabio Strinati



Është një vepër narrative e jashtëzakonshme, shpesh tragjike, madje edhe përplotëse. Një vepër informuese, e shkruajtur me kulturë dhe pjekuri. Një roman plot identitete të mbetura pezull, mbushur me të vërteta të dobisë së shkallës së parë. Fjalori i autorit është i rafinuar, i ndjeshëm, i mprehtë dhe i efektshëm. Gjuha e tij është e sinqertë, e drejtpërdrejtë dhe e vëmendshme ndaj ndryshimeve të vetëtimta të ringut ndërkombëtar. Faqet e tij janë therëse, të shqetësuar dhe të ankthshme, që arrijnë të të prekin thellë me mënyrën inteligjente të një kulture joshëse, me tone dhe ngjyime të bollshme, që karakterizojnë synimet më të larmishme të thelbit njerëzor. Një roman që përshkon tek lexuesi një tallaz emocionesh.


Më poshtë një vazhdim i këtij recensionit në vargje, i dedikuar dhe i frymëzuar prej romanit me të njëjtin titull.

Dardha lulëzoi në dhjetor, mes shquarsisë Drithnik të Shqipërisë. Me penën të kredhur në intrigat e argjendta tek një roman rojtar i një luleje në të lashtin Berat rrugica që përumben gjatë tingëllimave këmbanore të muzës së veshur me lule të verdha dhe bishtaja vaniljesh. Shtëpi nën suva mistikash ngritur në shullë të një rrezeje të vetmuar mëngjesore, me plepin që arrin pothuaj të dhunojë kufirin e frymëmarrjes Supreme të Zotave si buka e nxehtë gojëmbullur prej yçklave të thanës

Dardha lulëzoi në dhjetor, ndanë të lashtit Drithnik të Shqipërisë. Me vështrimin e magjepsur ndër përvijime cimbalesh mes gishtave të dashuruesit rebel. tek heshtja harmonia e tulatur.

Fabio Strinati, muzikant, kompozitor dhe poet nga më origjinalët në Italinë e sotme letraro-artistike.

E solli në shqip: Edi Salla.



Në historinë e letërsisë shqipe të ngjymës së dytë të shekullit XX dhe të periudhës postkomuniste, Koço Kosta përfaqëson një nga rastet më të veçanta të shkrimtarit që nuk mund të lexohet brenda skemave tradicionale të realizmit shqiptar. Ai mbetet jashtë realizmit socialist, por edhe jashtë realizmit kritik të tranzicionit dhe postmodernizmit klasik evropian. Vepra e tij krijon një univers autonom, ku historia, kujtesa, erotika, gjuha dhe absurdi ndërthuren në një strukturë ekzistenciale të errët e të fragmentuar.

Nëse romani "Absurdi" mund të konsiderohet kulmi konceptual i krijimtarisë së tij, ai nuk përfaqëson një shkëputje nga veprat e mëparshme, por emërtimin e hapur të një poetike të pranishme që në fillimet e saj. Nga "Unë dhe komiti" (1969), te "Mëhalla e Pelës" (2023) dhe deri tek romani në dorëshkrim "I shkreti Foto Pagunë" të cilin unë kam patur fatin ta lexoj, përmes romaneve, novelave dhe tregimeve të tij, shfaqet i njëjti univers antropologjik: njeriu shqiptar si qenie e tjetërsuar, e çarë shpirtërisht dhe e paafte për të krijuar marrëdhënie të qëndrueshme me realitetin.

Në këtë kuptim, Koço Kosta nuk është thjesht shkrimtar i absurdit; ai është anatomist i krizës së qenies shqiptare në kohën e socializmit dhe në tranzicionin pasues.

I. ABSURDI SI KATEGORI HISTORIKE DHE EKZISTENCIALE

Absurdi në veprën e Koço Kostës nuk paraqitet vetëm si atmosferë psikologjike apo teknike narrative. Ai është mënyra përmes së cilës individi përjeton ekzistencën në një botë ku raportet midis njeriut, së vërtetës dhe realitetit janë shpërbërë.

Në traditën evropiane, absurdi lidhet me krizën metafizike të njeriut modern; tek Kamy me heshtjen e universit, tek Kafka me burokracinë e pakapshme, tek Beketi me zbrazëtinë e pritjes. Tek Koço Kosta, absurdi merr dimension historik dhe kulturor shqiptar: ai lind nga deformimi i ndërgjegjes nën presionin e historisë.

Në sistemet totalitare, absurdi krijohet nga kontrolli total mbi jetën private, survejimi ideologjik dhe zhdukja e individualitetit.

Por madhështia e vizionit të Koço Kostës qëndron në faktin se absurdi nuk përfundon me rënien e sistemit totalitar. Në periudhën postkomuniste ai transformohet në absurdin e zbrazëtisë morale dhe shpirtërore.

Kështu, vepra e tij rrezon iluzionin se liria politike mjafton për ta çliruar njeriun. Tek Koço Kosta, individi mbetet "peng" dhe "i plagosur" edhe pas rënies së sistemit që e shtypet.

Në këtë kontekst edhe natyra humbet neutralitetin realist dhe bëhet pasqyrim emocional i krizës së brendshme:

"Gjithçka gjallërohej përsëri, dhe, në zallin e bardhë për anë urave, mbi gurët e ngritur mu midis rrugajës nën degë të kërlëshura asish të palexueshme të drurëve, bëhej një pamje gazmore. Aq gazmore! Aq të fuqishëm, me kaq dufe e pasion e epsh na gatove, o Lumë!

O Qielli ynë! (Absurdi).

Këtu peizazhi nuk funksionon si dekor, por si shpërthim ekzistencial.

II. LETËRSIA E TJETËRSIMIT

Një nga boshtet themelore të krijimtarisë së Koço Kostës është tjetërsimi. Personazhet e tij nuk janë heronj të veprimit, por qenie të humbura në një realitet që nuk arrijnë ta kuptojnë dhe as ta kontrollojnë.

Ata jetojnë në pasiguri të vazhdueshme, nuk komunikojnë dot në mënyrë autentike dhe shpesh redukohen në figura groteske. Ky depersonalizim është një nga tiparet më moderne të prozës së tij. Shpesh personazhet mbeten pa emër dhe identifikohen përmes detajeve fizike ose atmosferës së rrëfimit.

Ky proces kulmon në "Ata të dy dhe

Në 85-vjetorin e lindjes së shkrimtarit:

Koço Kosta: arkitekti i absurdit dhe gjeografia e tjetërsimit

Nga Luan Rama

të tjerë", ku personazhet kryesorë quhen Peshku i Kuq dhe Djaloshi i Pashëm. Këto nuk janë nofka, por forma të identitetit të shpërbërë. Personazhi nuk ekziston më si individ social, por si figurë perceptimi dhe gjendjeje.

Në një nga skenat më të forta të romanit: "Përjashta Galerisë, përtej në trotuar, më në fund ndaloi, hoqi syzet, u kthye nga Peshku i Kuq, qeshi e vështrroi drejt, e pështolli me krahët e gjatë dhe e puthi.

Dhe qau.

E di sa u preka? Edhe tani që e kujtoj prekem. Per kokën e

mamasë!

Qante nga gëzimi, sepse atje ishte me të. Që u takuan bashkë atje te Rembrandi. Nuk ta shpjegoj dot, nuk ta përshkruaj dot. Po çmendej nga gëzimi! Si të dashuruar! (Ata të dy e të tjerë).

Ky moment e zhvendos marrëdhënien njerëzore nga realizmi social drejt një intimiteti ekzistencial, ku arti bëhet më i rëndësishëm se identiteti.

Në sistemet totalitare individi humbet veten për shkak të mungesës së lirive individuale; në tranzicion, për shkak të fragmentimit moral dhe zbrazëtisë shpirtërore. Ky deformim shfaqet qartë edhe në mënyrën si përshkruhet edukimi në romanin "Absurdi":

"Fshati ynë! Edhe neve na sjellin në shkollë që të na mësojnë të shqejmë, të hamë, të spiunojmë shoshonin. Ç'nuk bëjnë që të na modelojnë të ligj e të pagdhundur. Perëndi!"

Kështu, Koço Kosta krijon figurën e "njeriut pa qendër": një qenie që endet midis frikës, dëshirës, kujtesës dhe vetmisë pa arritur të ndërtojë identitet të plotë.

III. SHPËRBËRJA E NARRATIVËS KLASIKE

Një nga aspektet më të rëndësishme artistike të veprës së Koço Kostës është prirja drejt shpërbërjes së strukturës tradicionale narrative.

Në realizmin socialist rrëfimi duhej të ishte linear, konflikti i qartë dhe fundi optimist. Koço Kosta e saboton këtë model nga brenda.

Në prozën e tij koha fragmentohet,

kujtesa ndërhyr vazhdimisht në rrëfim, realja dhe irealia bashkëjetojnë dhe subjektet nuk zhvillohen sipas logjikës klasike. Rrëfimi shpesh merr karakter halucinant dhe enigmatik, i ndërprerë nga shpërthime metaforike dhe gjendje psikike.

"O Fshati me kaq derte!"

Këto shpërthime emocionale e afrojnë Koço Kostën me traditën moderne evropiane të Kafkës, Beketit dhe romanit ekzistencialist të shekullit XX. Megjithatë, ai mbetet thellësisht shqiptar në atmosferë, traumë historike dhe ndjeshmëri kolektive.

IV. GJEOGRAFIA E TJETËRSIMIT

Në korpusin letrar të Koço Kostës, Nhapësira nuk është sfond neutral ku zhvillohen ngjarjet. Ajo është strukturë psikike dhe metaforë e krizës ekzistenciale të personazheve.

Qyteti, fshati, rruga, hani, stina me borë, nata provinciale apo periferia urbane ndërtojnë një topografi ankthi dhe vetmie. Hapësira tek Koço Kosta nuk të orienton; ajo të humb. Personazhet lëvizin vazhdimisht, por nuk mbërrijnë askund. Rruga nuk çon drejt zgjidhjes; ajo bëhet metaforë e humbjes së kuptimit.

Ashtu si tek Kafka, individi endet në një realitet që nuk e kupton dot plotësisht. Por ndryshe nga Kafka, labirinti i Koço Kostës është thellësisht shqiptar: me lagështinë e provincës, mbylljen morale të komunitetit dhe heshtjen kolektive të trashëguar historikisht.

Natyrë nuk paraqitet si harmoni romantike, por si pasqyrim i çrregullimit të brendshëm të njeriut. Bora shfaqet si figurë e izolimit dhe mpirjes emocionale; nata si territor ankthi; shiu si atmosferë paqartësie morale.

Një nga veçoritë më të dallueshme në shumicën e veprave të tij është prania e kafshëve si qenie narrative: kali, pela, qeni, gomari, lopa. Në "Mëhalla e Pelës" ato nuk janë dekor rural, por pjesë e strukturës emocionale të botës:

"Kali i Pelo Xhurapës... shkoi drejt pelës."

Kafshët shpesh duken më të natyrshme dhe më të pandryshuara sesa njerëzit. Ato ruajnë lidhjen me instinktin dhe natyrën, ndërsa njeriu shfaqet i deformuar nga



historia dhe ideologjia.

Në këtë kuptim, hapësira tek Koço Kosta ka gjithmonë dy nivele: një realist dhe konkret dhe një metafizik e psikologjik. Shqipëria e tij duket njëkohësisht reale dhe halucinante; jo vetëm vend, por edhe gjendje shpirtërore.

V. EROTIKA DHE TRUPI

Erotika në veprën e Koço Kostës nuk ka funksion sentimental apo romantik në kuptimin tradicional të letërsisë shqiptare. Ajo lidhet me vetminë, ankthin dhe nevojën e dëshpëruar të individit për të shpëtuar nga zbrazëtia ekzistenciale.

Në veprën e tij, marrëdhëniet njerëzore janë thellësisht të brishta. Personazhet afrohen fizikisht, por mbeten shpirtërisht të distancuar. Trupi bëhet mënyrë komunikimi atje ku gjuha dështon, por edhe ky komunikim mbetet i përkohshëm dhe i paplotë.

Prandaj erotika tek ai ka dimension tragjik.

Personazhet kërkojnë tek trupi i tjetrit ngrohtësi, strehim dhe harrim të përkohshëm nga absurdi i botës. Por ky pezullim zgjat pak; realiteti rikthehet gjithmonë me të njëjten ndjenjë zbrazëtie.

Në këtë kuptim, edhe fragmentet me ngarkesë të fortë sensuale nuk ndërtohen si himn i kënaqësisë erotike, por si shfaqje e një trazimi të thellë të brendshëm. Në përshkrimin e gruas "si një sorkadhe adoleshente", narratori mbetet i magjepsur nga bukuria fizike, por njëkohësisht i pushtuar nga një shqetësim që nuk shuhet. Pohimi: "Syri, shpirti im nuk ngopet me femër. Ajo është brenda vetes sime, ndaj s'gjej prehje", e zhvendos erotiken nga dimension i trupor drejt një përvoja ekzistenciale, ku dëshira nuk sjell qetësi, por vetëdije më të fortë të mungesës dhe pamundësisë për përmbushje.

Në këtë pikë, erotika tek Koço Kosta afrohet me traditën moderne evropiane ku trupi nuk është simbol harmonie, por vend ku shfaqen ankthi, frika dhe vetëdija e dështimit njerëzor. Edhe te Kafka, trupi dhe marrëdhëniet njerëzore shfaqen shpesh si hapësira ankthi, tjetërsimi dhe pamundësie komunikimi. Dëshira dhe afërsia nuk sjellin përmbushje, por një ndjesi pasigurie dhe izolimi ekzistencial. Erotika, kur shfaqet, nuk është çliruese, por e ngarkuar me tension psikologjik dhe mungesë harmonie.


Edhe personazhet femërore nuk ndërtohen sipas modeleve tradicionale të idealizimit. Ato janë figura komplekse, të lënduara dhe enigmatike. Gruaja tek ai nuk është "muzë romantike", por qenie po aq e vetmuar dhe e tjetërsuar sa burri.

Dashuria tek Koço Kosta nuk e shpëton njeriun nga absurdi; ajo vetëm e bën më të dukshme nevojën tragjike për afërsi dhe pamundësinë për ta realizuar plotësisht atë.

VI. GJUHA SI FORMË E KRIZËS

Një nga arritjet më të mëdha estetike të Koço Kostës është gjuha. Ai largohet nga realizmi transparent dhe komunikimi i drejtpërdrejtë.

Gjuha tek ai bëhet metaforike, simbolike, poetike dhe shpesh delirante. Fjalët nuk tregojnë vetëm botën; ato tregojnë krizën e vetë perceptimit të saj.



Kjo e bën prozën e tij intensive, të errët dhe të mbushur me tension të brendshëm poetik. Në këtë kuptim, Koço Kosta krijon atë që mund të quhet realizëm i ndërgjegjes së traumatizuar.

Kriza e gjuhës shfaqet qartë në mënyrën se si përshkrimi i trupit dhe i ndjenjës nuk mbetet në nivel referencial, por shpërthen në figura të ngarkuara poetikisht dhe emocionalisht. Shprehje si: “U bukurua dhe më. Shumë e bukur. Bukurane si një sorkadhe adoleshente që e pat zënë mëngjesi i parë...” tregojnë se gjuha nuk po përshkruan thjesht një realitet të jashtëm, por po e rindërton atë përmes një filtrimi të fortë subjektiv dhe imagjinar. Po ashtu, intensiteti i ndërhyrjeve emocionale të rrëfimitarit, si: “Sytë e mi të befur nuk dinin ku të ndalnin!” apo “Syri, shpirti im nuk ngopet me femër”, e zhvendos prozën drejt një gjendjeje ku fjala nuk kontrollon më përvojën, por përkundrazi, përvoja e tepruar erotike e shpërbën stabilitetin e gjuhës. Në këtë mënyrë, tek Koço Kosta gjuha bëhet vetë shenjë e një ndërgjegjeje të trazuar, ku realiteti nuk paraqitet, por përjetohet si shpërthim metaforik dhe emocional.

VII. PASURIA LEKSIKORE DHE MEMORIA ETNOGRAFIKE

Një nga dimensionet më të rëndësishme të krijimtarisë së Koço Kostës është pasuria gjuhësore dhe etnografike që përshkon veprën e tij. Nën sipërfaqen e absurdit ekzistencial dhe strukturave moderne narrative, veprat e tij ruajnë një marrëdhënie organike me kujtesën kulturore shqiptare.

Ai realizon një ndërthurje të rrallë: eksperiment modernist dhe ruajtje të memories gjuhësore shqiptare.

Proza e Koço Kostës karakterizohet nga një fond leksikor tepër i pasur, ku bashkëjetojnë fjala e ligjërimit të përditshëm bisedor, idiomat krahinore, fjalë të vjetra të shqipes, termat e jetës rurale dhe një metaforikë moderne me ngarkesë poetike.

Ai nuk përdor gjuhë sterile apo standard të thatë institucional. Përkundrazi, gjuha e tij ruan ritmin e artikullimit gojor, frymën e ligjërimit popullor dhe ngjyrimin emocional të shqipes së jetuar.

Në shumë fragmente të prozës së tij, fjala nuk shërben vetëm si mjet komunikimi, por si mbartëse e kujtesës kolektive.

Kjo e bën gjuhën e Koço Kostës njëkohësisht moderne dhe arkaike, poetike dhe popullore, filozofike dhe tokësore.

Kjo shfaqet në regjistrin e gjuhës së përditshme, ku dialogu ruan strukturën e ligjërimit popullor:

“S’ke hedhur samar? Vjeshtën që vjen.”

“Nuk i hyjnë qoqet mashkullit. Gjynah!”

Edhe bota e kafshëve përfshihet në këtë sistem të gjuhës së gjallë:

“Kali i ri bëri fjalë me hingëllima brenda në grykën e gjatë.”

Në këtë aspekt, ai krijon një sintaksë të ndërmjetme mes rrëfimit modern psikologjik dhe ligjërimit bisedor tradicional shqiptar, duke e ndërthurur me kujtesën etnografike.

Sintaksa e tij nuk është lineare. Ajo fragmentohet, ndërpritet nga kujtesa dhe ndjek ritmin emocional të ankthit më shumë sesa logjikën klasike të tregimit. Kjo krijon një prozë me puls të brendshëm poetik dhe ndjesi të vazhdueshme paqëndrueshmërie ekzistenciale.

Një element tjetër i rëndësishëm është prania e botës etnografike shqiptare: zakone, rite, hapësira rurale dhe kode tradicionale morale. Por këto elemente nuk paraqiten në mënyrë folklorike apo dekorative. Etnografia tek ai nuk idealizohet; ajo shfaqet si pjesë e memories së një bote në shpërbërje.

Ai nuk shkruan për fshatin si mit kombëtar, por për rrënimin gradual të strukturave tradicionale dhe zhdukjen e lidhjeve njerëzore autentike.

Kjo krijon një nga paradokset më interesante të veprës së tij: ndërsa struktura narrative është moderne dhe e fragmentuar,

materia gjuhësore dhe etnografike mbetet thellësisht shqiptare.

Koço Kosta modernizon formën, por ruan kujtesën kulturore.

Në fund, edhe kur personazhet humbasin identitetin dhe realiteti shpërbëhet, gjuha mbetet bartëse e kujtesës njerëzore. Absurdi mund të deformat jetën, historia mund të plagosë individin, por gjuha ruan ende gjurmët e njeriut.

Dhe pikërisht këtu qëndron dimensionin më i thellë humanist i veprës së Koço Kostës.

VIII. KOÇO KOSTA DHE LETËRSIA SHQIPE

Koço Kosta zë një vend të veçantë në historinë e letërsisë shqipe moderne. Ai nuk i përket plotësisht asnjë rryme dominante dhe pikërisht kjo e bën një nga autorët më të pazakontë të prozës shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI.

Në kohën e realizmit socialist, kur letërsia shqiptare duhej të funksiononte sipas skemave ideologjike të optimizmit historik dhe heroit pozitiv, Koço Kosta krijoi gradualisht një botë krejt tjetër: të errët, të fragmentuar dhe estetikisht jokonformiste.

Ai nuk e kundërshtoi realizmin socialist me deklarata politike; ai e refuzoi estetikisht. Vetë mënyra si ndërtoi personazhin dhe rrëfimin ishte formë rezistence artistike.

Në vend të heroit ideologjik, ai solli individin e pasigurt dhe qenien e tjetërsuar. Në vend të realizmit transparent, ai solli ambiguitetin, mjegullën psikologjike dhe krizën e gjuhës.

Pas vitit 1990, kur shumë autorë shqiptarë kaluan drejt kronikës së tranzicionit ose eksperimentit formal postmodern, Koço Kosta vazhdoi të ruante boshtin e vet themelor: analizën e krizës së njeriut shqiptar.

Ai nuk u bë shkrimtar i ngjarjes politike; ai mbeti shkrimtar i traumës antropologjike.

Kjo e dallon nga shumë autorë të tranzicionit që e trajtuan rënien e komunizmit si çlirim përfundimtar. Tek Koço Kosta, rënia e sistemit nuk e shëron individin; ajo nxjerr në pah zbrazëtinë morale, fragmentimin social dhe krizën e identitetit.

Në këtë aspekt, ai është ndër të paktët autorë shqiptarë që krijuan vazhdimësi organike midis traumës totalitare dhe krizës posttotalitare.

Nga pikëpamja estetike, Koço Kosta përfaqëson një urë të rrallë midis traditës narrative shqiptare, modernizmit europian dhe antiromanit bashkëkohor.

Ai nuk kërkon ta kënaqë lexuesin; ai kërkon ta fusë atë në krizë.

Dhe pikërisht këtu qëndron rëndësia e tij: Koço Kosta e zhvendosi prozën shqipe nga rrëfimi i realitetit drejt eksplorimit të ndërgjegjes së traumatizuar shqiptare.

PËRMBYLLJE

Vepra e Koço Kostës përbën një nga hartat më të errëta dhe më të thella të shpirtit shqiptar në letërsinë moderne. Në të, historia shndërrohet në ankth, liria në zbrazëti, erotika në pamundësi shpëtimi dhe individit në qenie të përhershme të tjetërsuar.

Por përtej absurdit historik, proza e tij ruan një marrëdhënie të thellë me kujtesën kulturore shqiptare. Përmes pasurisë leksikore, elasticitetit sintaksor dhe elementeve etnografike, Koço Kosta arrin të shpëtojë në art gjurmët e një bote shqiptare në shpërbërje.

Ai është filozof i absurdit shqiptar, arkitekt i antiromanit modern shqiptar dhe hartograf i krizës së njeriut shqiptar.

Në fund, vepra e tij na çon drejt një përfundimi të hidhur: sistemet politike mund të rrëzohen, por plagët që ato krijojnë në ndërgjegjen njerëzore vazhdojnë të jetojnë gjatë.

Dhe pikërisht aty fillon letërsia e Koço Kostës.

Historia e një busti të Gjergj Fishtës

Mrekullisht i shpëtuar ...

Nga Namik Dokle

Preç Ndoc Ndoj dhe të bijtë, jo më kot, ia vunë emrin “Hylli i Dritës” restorantit të tyre në një vend piktoresk të Troshanit, pak pasi ke kaluar Kallmetin e Vogël. Ky emër të kujton revistën e famshme në të cilën kontribuonte më së shumti poeti i shquar Gjergj Fishta. Dhe Preçi ka gjithë të drejtën e Zotit ta përdor këtë emër, sepse është i biri i Ndoc Hil Ndoit, njeriut që shpëtoi bustin origjinal të Fishtës.

Ishte viti 1968, një vit pas “cunamit të diktaturës” që mbylli kishat dhe xhamitë në gjithë vendin, faro ikona dhe gravura, dogji e hodhi në plehëra libra me vlera historike, apo edhe thjesht letrare e kulturore. Një vit më parë, ai kishte qenë i pranishëm, kur kjo shëmti ndodhi edhe në qendër të qytetit të Lezhës. Çfarë digjej u dogj, çfarë nuk digjej u hodh në lum. Që nga ajo ditë, sa herë kalonte atypari, Ndoci nuk mund ta hiqte vështrimin nga lumi; me kureshtje a me shpresë, - vëshirë të përfytyrohet sot. Dhe një ditë, në pakësim të ujërave të lumit, ai vuri re diçka të zezë. Një ndjesi e çuditshme, përzier me frikë, e shtyu drejt lumit. E mori në dorë objektin dhe u drodh: njohu bustin e Pater Gjergjit, siç e quanin në Troshan. I përvluan duart dhe e lëshoi përsëri aty ku e gjeti. Doli në breg dhe i dukej sikur ishte në cak të një gremine, ku, nga imta në imtë, mund të shkonte huptas. U largua dhe, një Zot e di, çfarë ka menduar një natë e një ditë, derisa mori atë vendim, të frikshëm për ato kohë, por që sot ngjan me një mrekulli. Në natën e dytë, bashkë me një të njohur të tij, shkuan te lumi.

“Ndoc, për çka e ke atë thes, çfarë ka qit lumi?!” e pyeti tjetri.

“Hyn e merre atë gurin e zi”, i tha ai.

Kur tjetri e nxorri bustin, zëdrithshëm, i tha:

“A m’duket mue, apo asht Pater Gjergji ky?”


Ndoci nuk tha as po, as jo. E futi bustin në një thes dhe e çoi në shtëpi. Nuk i tregoi askujt se çfarë kishte në atë thes të lagur...

-Po pastaj? - e pyes Preçin, që po ma tregonte këtë ngjarje tronditëse.

-Baba vdiq në vitin 1987, - më tregon, - por pak para se me dekë, më thirri e më tregoi një cep muri në oborr të shpisë. Kam një amanet në atë mur, më tha, u bënë 19 vjet që e mbaj të fshehur aty, lus Zotin që ti të mos e mbash aq gjatë sa e mbajta unë. Veç një porosi po të jap: Mos lejo kurrë të bahet ma keq se asht bā.”

Dhe erdhi koha e zbulimit të “idhujve të ndaluar”. Preçi e nxorri në dritë bustin e Gjergj Fishtës. I propozoi dikujt që ta ekspozonin në një vend a mjedis publik, por, me sa dukej, frika nuk ishte vërtet ende në mendjen e të gjithëve. Dhe Preç Ndoc Ndoj vendosi ta vinte bustin e poetit të madh, aty ku ai kishte qëndruar i fshehur për 22 vjet. Edhe kur kryeministri i vendit ia kërkoi që ta çonte diku tjetër, ai iu përgjigj:

- Le të rrojë aty ku ka lë.



Një ngjarje për letrat shqipe, por dhe për poezinë bashkëkohore në Ballkan, është botimi në Turqi i poezisë së Visar Zhitit nga shtëpia e njohur botuese turke “Tekin Yayınevi” në Stamboll, - shkruhet në njoftimin zyrtar.

Titulli i librit është “Gjithçka që më pret – Të mbledh diell”. (“Beni Bekleyen Her Şey - Güneş Toplamak”).

Poezitë e përktheu Fatma Büşra Çalı, e njohur në studimet e përkthimit dhe letërsisë krahasuese në Turqi, posaçërisht nga gjuha angleze.

Botimi i poetit Visar Zhiti doli në maj 2026 dhe bën pjesë në serinë prestigjioze poetike turke: “Dünya Şiir Okyanusu - Çağdaş Dizi”, (“Oqeani Botëror i Poezisë - Seria Bashkëkohore”).

Ky botim përbën një paraqitje të rëndësishme të poezisë së Visar Zhitit në hapësirën letrare dykontinentale turke, duke e vendosur autorin shqiptar pranë emrave bashkëkohorë të poezisë botërore që publikohen në këtë seri.

Një emër i njohur i poezisë, Ataol Behramoğlu, më i madhi sot i letërsisë moderne turke, është redaktori i serisë, duke e shtuar kështu, sipas kritikës, rëndësinë e kësaj serie.

Në tekstin promovues të vendosur në kopertinë, Behramoğlu shkruan:

“Të njohësh Visar Zhitin si poet dhe si njeri është një pasurim i madh ndjenjash dhe mendimesh, - dhe shton se, - botimi i këtij libri nga “Tekin Yayınevi” përbën një kontribut të rëndësishëm për botën turke të poezisë”.

Të thëna prej, nga zëri me ndikim të madh në kulturën turke dhe në poezinë bashkëkohore ndërkombëtare, ky vlerësim merr një forcë të veçantë e me rëndësi.

Në kopertinën e pasme janë dhe fragmente poetike të Visar Zhitit, vargjet:

Gjithçka që më pret,
Diell të mbledh dua...

Shiu im,
kthimi në rrugën që rrjedh
nga shtëpia bashkë me mallin,
Ja, kaq janë ato që mund të të jap.

Po, të desha ty!
Deti i kaltër, abazhurët që bien mbi
fjalë,
dita ime kryengritëse,
Ja, kaq janë ato që mund të të jap.

Të desha, sa shumë të desha ty.
Në sytë e mi qielli blu derdhet
në sytë e tu,
Ja, kaq janë ato që mund të të jap.

Të kam dashur gjithmonë,
që nga fillimi.

Po ashtu aty është vendosur dhe një pikturë nga Atjon Zhiti.

Poezia e Zhitit ruan edhe në turqisht karakterin e saj lirik, dramatik dhe meditativ, duke sjellë një gjuhë të ndjeshme të dashurisë, kujtesës dhe mbijetesës shpirtërore.

Në prezantimin e librit përmendet edhe historia dramatike e autorit gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri. Botuesi turk kujton se Visar Zhiti u burgos për poezinë e tij dhe kaloi vite

Botohet në turqisht vëllimi poetik “Gjithçka që më pret – Të mbledh diell”

Poezia e Visar Zhitit në Turqi

Përktheu dhe përgatiti: Eda Zh.

në kampet famëkeqe të Spaçit dhe Qafë-Barit dhe se ai memorizoi gati njëqind poezi gjatë hetuesisë dhe shkruajti fshehurazi gjatë viteve të burgut, për të mbijetuar shpirtërisht.

Ky dimension biografik, - sipas tyre, - i jep poezisë një forcë të veçantë morale dhe njerëzore, që tashmë po prezantohet edhe për lexuesin turk.

Data e botimit: 6 maj 2026

ISBN: 9789944613699

Faqe: 144

Formati: 13.5 x 21 cm

Seria: Dünya Şiir Okyanusu – Çağdaş Dizi 5

Libri është tashmë i pranishëm në libraritë turke edhe online dhe në katalogët letrarë të Turqisë.

Botimi i tij përbën jo vetëm një sukses për Visar Zhitin, por dhe një akt i rëndësishëm për praninë e letërsisë shqipe në kulturën turke dhe në dialogun poetik ndërkombëtar.



Poeti Ataol Behramoğlu

Është ndër të rrallët apo i vetmi në Turqi që ka një statujë në Stamboll, në Parkun Sailer Sofasi, duke qenë edhe vetë në jetë, aq aktiv. Poezia e tij konsiderohet si ndërgjegje dhe thirrje për ndriçim. Ka qenë i arrestuar në vitin 1982 (Visar Zhiti në këtë kohë ishte në burg) si antar i shoqatës turke të paqes dhe u mbajt në kushte të tmerrshme në burgun ushtarak, e liruan me kusht dhe më pas e dënojnë me 8 vjet punë të detyruar dhe me 32 muaj internim, por në mungesë, sepse, i detyruar, kishte ikur në Francë e vende të tjera të Europës dhe kthehet në atdhe vitin 1989, bëhet President i Sindikatës së Shkrimtarëve, përkthen në turqisht poetë të mëdhenj nga bota si Aragon, Ricos e Neruda, të cilët dhe i kishte takuar, etj, etj.

Gazeta ExLibris ka botuar poezi të Ataol Behramoğlu dhe një bisedë ma atë,

“Poeti që na tregoi statujën e tij”.

Po sjellim fjalën e tij hyrëse në librin “Gjithçka që më pret - Të mbledh diell”,

MBI VISAR ZHITIN DHE POEZINË E TIJ

- Nga Ataol Behramoğlu -

Kur lexon poezitë e një poeti, që, qoftë edhe për afërsisht, ke përjetuar gjëra të ngjashme me atë, ndjen adhurim dhe habi, të përziera bashkë.


Po flasim për një poet që arrin të pasqyrojë jetën dhe vëzhgimet me një ndjesi realiteti të denjë për ta adhuruar...

E megjithatë gjithçka është kaq origjinale, kaq thellësisht e veçantë dhe e poandashme nga vetë personaliteti i këtij poeti.

Teksa lexon poezitë e tij, të duket sikur mban në duar zemrën e njeriut që i ka shkruar...

Qoftë në burg apo jashtë tij, në vendin e vet apo në vende të tjera, në mërgimin e detyruar, çfarë force vëzhgimi, çfarë pasioni për jetën, çfarë rrëfimi i rrjedhshëm dhe çfarë zemre e lartësuar dhe e pjekur nga dhimbjet, që edhe përballë vuajtjeve të veta, nuk e ka humbur humorin, - jo domosdoshmërisht falës, por njerëzor dhe i madh.

Njohja me Visar Zhitin si poet dhe si njeri ishte për mua një lumturi e madhe, një pasurim i pashtershëm shpirtëror dhe mendimesh. Edhe botuesi “Tekin Yayınevi”, duke sjellë një poet të tillë, i jep një kontribut të vyer botës sonë poetike.



E hënë, 27 prill. Ndërtesa me adresën 53 Washington Square Park South ngrihet buzë parkut me të njëjtin emër, i cili sot, si çdo ditë me diell, është i stërmbushur me njerëz, kafshë, tregtarë ambulante dhe muzikë.

Në katin e tretë ndodhet Qendra për Studime Evropiane dhe Mesdhetare e Universitetit të Nju Jorkut. Jashtë sallës është shtruar një banket. “Jemi munduar t’i afrohem kuzhinës shqiptare me aq sa kishim mundësi” – më thotë asistentja e qendrës. “Po deshe të hash, merr që tani, para se të fillojë leksioni, se studentët tanë nuk të falin për ushqim mesdhetar”.

Larry Wolff, profesori që më ka ftuar të flas për Kadarenë me rastin e 90-vjetorit të lindjes, është një nga autoritetet më në zë të akademisë amerikane. Ai ka botuar një sërë librash, ndër të cilët *Shpikja e Evropës Lindore: Harta e qytetërimit në mendjen e Iluminizmit* (1994), që e rrëfen idenë e Evropës Lindore si një lloj ‘shpikjeje konceptuale’ të filozofëve, udhëtarëve dhe mendimtarëve evropiano-perëndimorë gjatë Iluminizmit të shekullit XVIII.

Është edhe admirues i Kadaresë. Studentët pjesëmarrës, që vijnë nga gjithë bota, kanë lexuar *Pasardhësin* (2003), ndoshta edhe ngaqë Larry-t i kam folur për punën time me Vilën Nr. 31 në Tiranë, në ish-Bllokun aq misterioz për gjeneratën time. Vend po aq historik sa letrar, e, mbi të gjitha, fole urbane intrigash dhe teorish për pushtetin komunist pas vdekjes së numrit dy të pushtetit komunist në vitin 1981.

Si edhe gjetkë në universin kadarean, romani ndërtohet mbi prapaskenën (*prapaskenat?*) e një ngjarjeje madhore, por dhe të mistershme. Lexuesi përballlet me teori rivale për ç’mund të ketë ndodhur, apo pse. Nën diktaturë e vërteta duket e paarritshme; në vend të njohjes së drejtpërdrejtë, njerëzve u mbetet të

Prilli i Kadaresë në Nju Jork

Nga Elidor Mëhilli



interpretojnë shenja, ogure, fragmente, dhe kode. E vërteta historike shqiptare mbetet shpesh pezull.

Ç’mund të thuash për të vërtetën sot? Sot, kur, në përgjithësi, e vërteta as ka përparësi, as tërheq vëmendje apo kokërdhokë në rrjetet sociale. Përkundrazi. Të përmendësh “të vërtetën” sot në universitetet amerikane, rrezikon të provokosh të qeshura. Jemi të ndërgjegjshëm se punojmë e jetojmë në një epokë *post-të vërtete*. Ka shumë të vërteta sot. Aq shumë, sa është marrëzi t’i numërosh. Secili ka të vërtetën e vet.

Te trupi letrar i Kadaresë rrugët e mundimshme drejt të vërtetës janë shpesh qorre e plot kurthe. E vërteta nuk përfitohet domosdoshmërisht si çështje autoriteti të padiskutueshëm, madje as si mbajtje premtimi, por si çështje që hedh dritë mbi hijet e gjithsecilit prej nesh. Kështu që besoj ka ende ç’të na mësojë edhe sot—sidomos sot.

Si edhe tjetërkund, *Pasardhësi* mund të lexohet si një reflektim mbi barrën e madhe të së shkuarës të shqiptarët. Ç’të bëjnë me atë barrë? Të mundohen ta harrojnë? Janë munduar ta harrojnë, e harresa ka qenë madje e suksesshme.

Mirëpo pikërisht kur barra e historisë duket sikur zbehet, e shkuara rishfaqet sërish dhe kërkon haraç.

Në sallën e Universitetit të Nju Jorkut u fol për këto, e për shumëçka tjetër: Gjirokastrën, Tiranën, Moskën, Parisin. U diskutua se si botëndërtues, Kadareja është një lloj ftese për të gjëmuar koordinata nga njëri libër të tjetri, nga fiksimi në fiksim, nga obsesioni në obsesion. Folëm edhe se si *Pasardhësi* është një lloj rikthimi të rrënjët makbethiane, por edhe rikthim të arkitektura si sferë përherë në marrëdhënie komplekse me pushtetin.


Folëm për përkthyesit. Kujtuam përkthyesin dhe studiuesin David Bellos, për shumë vite profesor në Universitetin Princeton, i cili vdiq vitin e kaluar, vetëm një vit pas Kadaresë. Falë Bellos-it, *Pasardhësi* erdhi në anglisht përmes frëngjishtes, dhe më duket se, kur e rilevoj, në disa zgjedhje e kthesa gjuhësore e njoh Bellos-in, me nënqeshjen e tij lozonjare. Edhe ai ka lënë gjurmë në mënyrën se si Kadareja hyri në botën anglofone, e kjo nuk është pak.

Një profesore mori fjalën dhe tha se kishte marrë pjesë në një konferencë për letërsinë në gjuhën tamile (me 85

milione folës në botë), ku autori sri-lankez Appadurai Muttulingam kishte përmendur pikërisht rastin e Kadaresë si një shembull se si letërsia e një vendi të vogël bëhet e njohur përmes përkthimit. (Gjendet këtu: <https://livingtamillitfest.org/>)

“Nga t’ia filloj me Kadarenë?”, më pyesin shpesh amerikanët. U them: “Fillo ku të duash, por mos mendo se e ke mbaruar udhëtimin me leximin e një libri të vetëm”. Tani që e shkrova këtë fjali, dyshoj edhe vetë. Kudo përballemi me leximin në rënie drastike, në Shqipëri si edhe në Amerikë. Edhe gazetaret më prestigjioze amerikane nuk botojnë më recensione librash si dikur. Studentët po ua lënë leximin platformave të inteligjencës artificiale. Një agent AI që do të vizatonte hartën e universit të Kadaresë do të ishte jashtëzakonisht interesant, por a mund të jepte të njëjtën kënaqësi që vjen përmes mundit të madh të zbulimit vetjak?

Takimi mbaron. Shkëmbejmë adresat elektronike. Muaji prill në Amerikë sinjalizon fundin e semestrit akademik. Pas udhëtimit në botën e Kadaresë, dalim jashtë dhe shpërndahemi drejt parkut. Na përpin Nju Jorku.



David Bellos, përkthyesi i romanit “Pasardhësi” të Kadaresë

Isha vetëm dhjetë vjeçe kur fati tragjik i Frosinës m'u lthye në një idengulitje të frikshme. Në fillim njoha vetëm vdekjen e saj të tmerrshme. Shumë vite më vonë mësova historinë. Jetonim në Tiranë, por sa mbaronte shkolla, së bashku me tim vëlla, shkonim të kalonim pushimet verore te gjyshërit në Vlorë. Pothuaj ngjitur me shtëpinë e gjyshërve nga ana e babait, në lagjen "Karabash", që në arabisht do të thotë "kokë e zezë", ndodhej një shtëpi e thjeshtë qerpiçi, brenda me një truall prej dheu të ngjeshur si dysheme. Aty jetonte një çift të moshuarish, kështu i gjykoja asokohe, nënë Zyla dhe xha Jakupi. Sa herë që ne fëmijët zbarkonim në shtëpinë e gjyshërve, nënë Zyla, mikeshë me time gjyshe, na sillte herë fruta nga kopshti i vogël i shtëpisë dhe herë petulla me sheqer.

Një ditë kuturisa në shtëpinë e tyre e cila, ndryshe nga pamja e saj e varfër, kishte orendi që m'u dukën shumë të çmuara. Tablo të mëdha të vjetra me korniza prej druri të zi të ngjeshur – nga ato që nuk më kishin zënë sytë kurrë, përveçse në një revistë të ngrënë e të zverdhur nga koha, të gjetur në bodrumin e shtëpisë së gjyshërve – vishnin muret e pasuvatuara dhe i bënin të ngjanin madhështore. Perde prej kadifeje, të rënda, ngjyrë blu e thellë me shkëlqim, mbulonin dritaret e vogla me xhama të marrtë, ndërsa në një qoshe rrinte një senduk hijerëndë, i madh, i errët, me disa sumbulla prej bakri dhe pranë tij, njësh me tokën, dy kashunë zarzavatesh që mbanin libra sërë-sërë, të veshur me lëkurë vishnje, të cilëve nuk guxoja t'u avitesha, nga një lloj autoriteti që shpërhapnin në ajër.

Me kohë mësova të shkoja pothuaj përditë në shtëpinë e tablove dhe të qëndroja me minuta të gjata përpara njërës prej tyre, e cila edhe më mrekullonte me ngjyrat e saj, edhe më frikësonte për vdekje. Skena e tablosë: në plan të parë një varkë në liqen, një ushtar egërshan në varkë që mban përpara duarve një grua të re dhe shumë të bukur, e cila i ka duart dhe këmbët të lidhura – në këmbë mban të varur një gur të rëndë. Ushtari po bëhet gati ta hedhë gruan në ujërat e liqenit. Një tjetër grua qëndron e ulur në fund të varkës, me kokën mbi gjunjë mbuluar nga flokët e gjatë – vajton. Pranë saj një tjetër ushtar i armatosur. Në breg, në të majtë të tablosë, mbi një shkëmb, është figura e largët e një burri në moshë, me një çallmë në kokë, me mjekër të gjatë të bardhë, me një xhybe të trashë me peliçe, që duket se vëzhgon skenën duke e dominuar. Gjithçka ishte aq e gjallë, sa më dukej se po të zgjasja dorën do të prekja ujin e liqenit. Madje, njëherë m'u duk se u mbyta nga shtëllungat e tymit të trashë e të zi të pishtarit të anijes që ndriçonte skenën, pasi ishte natë dhe hëna ishte e zënë. Mrekullinë që përjetoja ditën duke shijuar tablonë e gjallë me ngjyra të mrekullueshme e paguaja natën me gjumë të trazuar dhe ëndrra të liga. Por nuk hiqja dorë nga soditja e saj. Gjeja një mijë justifikime për të shkuar te nënë Zyla, e cila asnjëherë nuk kërkoi të dinte se përse rrija aq gjatë përpara asaj tabloje, sepse sigurisht e kish marrë vesh pagabueshëm motivin e vizitës. Një pasdreke soditjeje m'u afrua dhe më tha duke treguar gruan e bukur: "Kyra Frosini." Asnjë fjalë më shumë. Por as unë nuk e pyeta më tej, për të mos prishur magjinë. Gjyshja më shpjegoi një ditë se nënë Zyla dhe xha Jakupi ishin çamë të Janinës, që ishin përndjekur nga grekët, të cilët u kishin marrë gjithçka, shtëpinë, tokat, bagëtinë. Nuk kishin fëmijë, të afërmit ua kishin masakruar grekët. Një ditë tjetër më tha se rridhnin nga një familje e vjetër pashai. Dhe vërtet, kundruall tablosë që sodisja ndodhej një tjetër, pak më e vogël, por gjithsesi madhështore, ku burri plak me çallmë dhe xhybe i tablosë së Kyra Frosinit zinte tani të gjithë panoramën, autoritar, me mjekër të bardhë dhe sy të kaltër, gjysmështrirë në shilte të buta, me poture të blerta dhe me një lloj pipe shumë të gjatë, që më vonë mësova se quhej nargjile. Ndërsa burri plak ishte vetë Ali pashai i famshëm. Me mendjen time fëminore e vendosa ngjarjen e gruas së bukur me emrin Kyra Frosini në Janinë që, siç më shpjeguan prindërit, ndodhej në Greqi, pranë kufirit me Shqipërinë. Nuk isha gabuar. Ndërsa Ali pashain e quajta stërgjyshin e xha Jakupit. Këtë nuk e mësova dot kurrë.

Vitet kalonin, vajtjet në qytetin e lindjes u rralluan. Dikur mësova se janinasit e shpërngulur me dhunë nuk jetonin më. Tabloja pothuaj ishte zbehur në kujtimet e mia, por pengu i vrasjes së zonjës Frosina ishte fosilizuar diku në shpirt.

Gjer kur, fare rastësisht, pothuaj njëzet e ca vjet më vonë, gjeta të shkruar në historinë e Janinës të kohës së sundimit të Ali pashë Tepelenës historinë e vrasjes së Kyra Frosinit së bashku me shtatëmbëdhjetë gra të tjera. Dënimi kish ardhur nga dora gjakatare e pashait shqiptar për të shlyer fajin e përbashkët: shkëljen e kurorës. Lexova se Janina, e mësuar me gjakësitë e Ali pashait, ishte drithëruar gjer në palcë nga vrasja e grave të pafajshme. M'u rikthyen ëndrrat e liga dhe gjumi i trazuar i fëmijërisë.

Këtu nis edhe koha e kërkimeve, e grumbullimit

Frosina e Janinës

jetoi gjatë në ëndrrat e mia

Shkrimi dhe ripunimi i romanit

Nga Mira Meksi

të gjithçkaje që gjeja, jo vetëm për zonjën Frosinë, për tragjedinë e mbytjes së saj dhe të shtatëmbëdhjetë grave në liqenin Pamvotidos, por edhe për Janinën e asaj epoke dhe vetë oborin e Ali pashë Tepelenës. Në fillim dukej sikur zelli për këtë punë kishte qëllim të zbuste pengun e fosilizuar të fëmijërisë dhe ndoshta edhe ta shkrinte tërësisht atë lloj pengu. Por me kohë kuptova se e vetmja mënyrë për ta arritur këtë ishte shkrimi i tragjedisë së zonjës Frosinë, të cilit i veshja dhunti shëronjëse. Ishte romani im i parë. Më mori mbi gjashtë vjet punë pothuaj të përditshme kërkimore dhe shkrimi. Busulla ime në qëmtimin e materialeve dhe të dhënave që do të më tregonin jo vetëm historinë, por edhe gjeografinë, klimën, zakonet, veshjet, ndërtimet, organizimin shoqëror, besimet, luftërat, ambiciet e pashait të Janinës, por edhe të grekëve janinas, ishte vepra madhore *Udhëtim nëpër Greqi* në gjashtë vëllime e François Pouqueville-it (1770-1838), i cili ishte anëtar i Institutit të Francës dhe anëtar i Komisionit të Arteve dhe të Shkencave, që kishte shoqëruar ekspeditën e Bonapartit në Egjipt. Nga viti 1806 deri më 1815 Pouqueville-i ushtroi funksionin e konsullit francez në Janinë, në oborin e Ali pashë Tepelenës, në kohën e Napoleonit I dhe më pas detyrën e konsullit të Francës në Patra, nga viti 1815 deri më 1816. Në Kështjellën e Versailles-s, në Muzeun Kombëtar, kam parë portretin e tij, me krahu e përthyer mbi gjoks në një përshëndetje masonike, me Janinën në sfond. Portreti i mrekullueshëm është vepër e partneres së tij, piktores Henriette Lorimier. Ai flet gjerësisht për Janinën, për Ali pashain dhe për zonjën Frosinë. Çfarë u shton vlerën rrëfimeve janë skicat e bukura, hartat e përpikta, gravurat që shoqërojnë udhëtimet e tij nëpër viset e Shqipërisë, Greqisë dhe Ballkanit në përgjithësi.

Ali pashë Tepelena ka bërë të derdhet jo pak bojë në letër. I quajtur Luani i Janinës apo Napoleoni i Ballkanit, është konsideruar si një figurë madhore e kryengritjes kundër Perandorisë Osmane, duke u përmendur shpesh në letërsinë romantike franceze të shekulli XIX. Balzaku ka shkruar: "I vetmi kolos i shekullit XVIII që sfidoi Napoleon Bonapartin." Edith Durham: "Një gjeni i lindur për t'u bërë mbret." Ndërsa A. Dumas-i në koleksionin *Krime të famshme* ka shkruar një tregim për Ali pashë Tepelenën. Viktor Hygoi në vëllimin e tij poetik *Orientalët* ka një poezi të quajtur *Dervishi* dhe *Ali pashë Tepelena*. Takimi midis poetit romantik anglez Lord Byron dhe sovranit shqiptar Ali pashë Tepelena, më 1809, ndikoi në veprën e poetit dhe në vetë perceptimin e tij për Lindjen. Ai e përshkruan pashain si një sovran kompleks, duke ndërthurur

admirimin për fuqinë dhe trimërinë e tij dhe neverinë ndaj mizorisë që ai shfaq. E ka quajtur *Bonaparti muhamedan*, por edhe *remorseless tyrant*¹, i aftë për gjakësi, po ashtu një mikpritës i jashtëzakonshëm dhe i kultivuar. Në Perëndim, Byron-i e bëri të njohur Ali pashain nëpërmjet poemës së tij *Shtegtimet e Çajld Haroldit*.

Në të gjitha veprat ku shkruhej për Ali pashain projekt-tohej zonja Frosinë dhe fati i saj tragjik, e cila gjatë procesit të të shkruarit mori emërtimin Frosina e Janinës. Emri i saj i vërtetë është Frosina Vasilei, lindur më 1773, e martuar me një tregtar të pasur grek, Dimitri Vasilein, me të cilin kishte dy fëmijë. Frosina i përkiste aristokracisë greke dhe ishte mbesa e dhespotit të Janinës. Thuhet se ishte gruaja më e bukur e atyre viseve, tepër inteligjente dhe shumë e kultivuar. Nisma të shumta kulturore dhe shoqërore krijoheshin dhe drejtoheshin prej saj në Janinë. Thuhet se në një nga këto ngjarje kulturore e pa dhe u dashurua me të djali i madh i Ali pashait, Muktar pashai, i martuar me të bijën e pashait të Beratit. Ka historianë që mbrojnë tezën se pikërisht kjo dashuri solli dënimin e Frosinës. E shoqja e Muktarit nxiti Ali pashain kundër saj. Të tjerë flasin për një vrasje politike, sepse Frosina Vasilei përfaqësoonte kulturën dhe shpirtin e Perëndimit në Janinë. E lidhur me aristokracinë europiane, me dashurinë e saj për Muktar pashain Frosina promovonte shpirtin liberal, çka binte ndesh me moralin që predikonte Ali pashë Tepelena.

Gjithsesi, një nga burimet e mia të rëndësishme për Frosinën dhe sidomos për perceptimin që grekët kishin për të dhe tragjedinë e saj u bë një poemë e gjatë e poetit dhe politikanit grek Aristotelis Valaoritit (1824-1879), e titulluar *I Kira Frosini*², e botuar më 1859. Frosina është heroinë e historisë së Greqisë.

Paskëtaj nisën udhëtimet e mia në Janinë. E kujtoj si sot rrugëtimin e parë në vitin 1994 dhe zbulimin e qytetit, kryeqendrën e pashait shqiptar që kish sunduar vendin gjysmë i pavarur nga Porta e Lartë dhe ishte përpjekur me thonj e dhëmbë për të krijuar një principatë të pavarur në Epir dhe Shqipërinë e Jugut – si edhe të qytetit të Frosinës së bukur, të jetës dhe vdekjes së saj. Udhëtimin njohës e bëra me një mikeshë të shtrenjtë, diplomatën gjermane në Tiranë, Christine Freudreich. Ishte ajo që ngiste makinën me targa diplomatike dhe që ma bëri të lehtë kalimin e kufirit grek, megjithëse kisha një vizë greke disamujore. Mikesha ime e kishte fort për zemër historinë dhe më erdhi pas në të gjitha vizitat dhe hulumtimet e mia në Janinë, sidomos në ishull, pa u ankuar asnjëherë, edhe kur

¹ *Remorseless tyrant* – tiran i pamëshirshëm.

² *Për zonjën Frosinë.*



më duhej të qëndroja për një kohë të gjatë duke mbajtur shënime.

Shtëpia dykatëshe e Ali pashait në ishullin e Pamvotidosit ishte edhe muzeu i tij. Në oborrin përpara shtëpisë, ku ndodhej topi me gjyle, ngrihej një rrap madhështor me një tabelë ku shkruhej: "Rrapi 700-vjeçar i Ali pashait." Hyra në një tjetër kohë dhe në një tjetër botë. Gjeta shumëçka për jetën e pashait të Janinës, veshjet, armët, nargjilenë legjendare, veshjet e së shoqes, Vasiliqisë, objektet e jetës së përditshme, sallonin shqiptar ku priste personalitet e botës, sixhadetë dhe shillet ku ulej, tablotë, oxhakun...

Diku në një hapësirë të muzeut më priste Frosina. Një skenë butaforike e frikshme: varka me zonjën Frosinë ulur, kokën të përkulur mbuluar nga flokët e gjatë, me një skufje me temina ngjyrëvishnje mbi kokë. Pelerina po vishnje prej kadifeje të trashë me gajtanë të artë të qëndisur i mbulonte supet dhe zbriste përmbi fustanin e gjatë ngjyrë mjalti. Duart i kishte të lidhura me një litar, i cili përfundonte me një gur që dilte jashtë varkës. Përballë varkës dy fëmijët e Frosinës. Përçark varkës manekinë të veshur kokë e këmbë me të zeza. Pa fytirë. Hije. Ndihej tragjedia në çdo element. Kur zonja e muzeut ktheu krahet, preka skufjen e Frosinës. U drithërova. Dhembja m'u duk ende e gjallë.

Në ishull ekziston një gji që quhet Gjiri i Frosinës. Vendi ku e kanë mbytur më 11 janar 1801, në moshën 27-vjeçare. M'u desh ta vizitoja Janinën edhe në janar. Shkrimi i romanit ishte drejt fundit. Shkova në ishull pranë Gjirit të Frosinës një agim, kur drita porsa kish nisur të zbulonte ujërat. Ishte një i ftohtë therës. M'u duk se dëgjova për një çast zhurmëzën e cipës së akullit që kish zënë uji dhe që çahet nga varka. Janina ishte mbuluar nga një mjegullinë në ngjyrën e çelikut prerës. Veshi më zuri vajtimin dyqind vjet të largët të grave... Dhe rrahjet e fundit të zemrës së Frosinës përfund ujit.

E dija se Frosina ishte varrosur me nderime të mëdha nga xhaxhai i saj, dhespoti Gabriel, në Manastirin e Shën Anargyroit, pranë kalasë. Së bashku me gratë e tjera. U përpoqa ta vizitoja varrin e saj sa herë shkova në Janinë. Nuk më lejuan të hyja në manastir. Në ndërjegjen time varri i Frosinës, të cilin sytë e mi nuk arritën ta shohin dot, vijonte të ndodhej përfund ujërave të Pamvotidosit. Kështu shfaqet në roman.

Pothuajse i gjithë romani u shkrua nën tingujt e pareshtshëm të këngës *Una rosa es una rosa*³ të grupit spanjoll Mecano, që kishte një efekt magjik në shkrimin tim. Ende i kam në mendje disa vargje të saj: *Desha të këpusja lulen më të njomë të trëndafilishtës/ duke menduar se nga dashuria nuk do të më gjembonte/ dhe ndërsa më ngulte gjembin më dha një mësim/ se trëndafilja mbetet trëndafil...* Lajtmotivi i romanit, kënga e marrokut të Janinës: *Kush një trëndafilë prek/ shpuar gjembash le të vdesë*, është frymëzuar pikërisht nga kjo këngë.

~ ~ ~

Pas pothuaj tridhjetë viteve nga koha kur u shkrua romani *Frosina e Janinës* dhe rreth njëzet e pesë vjet nga botimi i parë në vitin 2001 nga Shtëpia Botuese Onufri (romani ka njohur disa ribotime), me arritjet e sotme të teknologjisë, arrita të shoh portretin e Frosina Vasileit (nuk e kisha parë kurrë më parë). Ky portret shfaqet në kopertinën e këtij botimi. Ishte një zbulim i jashtëzakonshëm. Në të vërtetë, shumë pranë përfytyrimit tim. E sodita për ditë me radhë. Zbulova se kongjilli i jetë-vdekjes së Frosinës vijonte të më përvëlonte shpirtin. Rinisa me kërkimet. Në Erën e Re teknologjike gjeta dhe dëgjova operën *Kyra Frosini* të kompozitorit Pavlos Carrer (1858), frymëzuar nga poema e Aristotelis Valaorititit – uvertura e saj, luajtur nga Filarmonia e Athinës, ishte magjike. Më vonë, gjeta dhe pashë filmin *Pëshpërimat e liqenit*, realizuar në vitin 1959 nga regjisori Grigoris Grigoriou, kushtuar Frosinës, heroinës kombëtare greke, ku rolin e saj e luante Irene Papas. Me kohë jam bërë e ndërgjegjshme se asnjë libër i shkruar nuk është i përfunduar. Dhe iu futa ripunimit të romanit tim *Frosina e Janinës*. Jo vetëm në nivel gjuhësor – gjuha është e gjallë dhe zhvillohet, pëson ndryshime – por edhe në dritëhije stilistikore, pasuruar nga gjetjet dhe përjetimet e fundit. E pashë të udhës ta pajis këtë variant të romanit me një aparat shpjegues të fjalëve, pasi shumica e tyre, të prejardhura nga turqishtja apo greqishtja dhe që i përshtaten kohës së romanit, nuk kuptohen nga lexuesi i ri.

Sidoqoftë, çdolloj ripunimi që mund t'i bëhet tekstit të romanit *Frosina e Janinës*, sot apo në të ardhmen, nën dritën e zbulimeve të reja, s'do të mund të prekte thelbin e tij të patjetërsueshëm si romani i një dashurie të madhe të penguar dhe tragjike.



Paul Despiere-i priti të mugej që të shkonte në qimite-rin e vjetër. Në dorë mbante një karafil të bardhë, të cilin e nuhaste hera-herës pa mendje. Karafili lëshonte një kundërmim të freskët vjeshte dhe pastaj mblidhej iriqthi dhe ngjante si i vyshkur.

Qimiteri i vjetër kishte kohë që e kishte mbyllur portën e rëndë, me kangjella të kthyer si kthetra bishe, për vizitorët e gjallë. Kishte ndodhur në një datë të panjohur, fare papritur, kur në qimiterin e vogël kishin kallur në dhë një ortodoks të vobektë pa familje. Askush nuk ndërmendej të shtynte portën e rëndë me kangjella që gërvinte dhembshëm nga një sëmundje kohe për të vizituar varrin e ri të mjeranit, ndërsa mbi varret e tjera pluhuri i harresës mblidhej me grushte.

Qyteti kishte pasur nevojë për një kohë tjetër dhe për një vendvdekje tjetër. Dhe e kishte ndërtuar.

Paul Despiere-i hoqi me mundim prej hallkës zinxhirin që mbante të mbërthyer dy fletët e portës dhe hyri brenda. Kohët e para të braktisjes, një bimësi e harlisur kish pushtuar truallin e varreve dhe e kishte gjelbëruar në mënyrë të padurueshme. Pasi kish ngrënë padenjësisht çdo gjë që hahej, ajo kishte zënë të brente sinorët dhe gurët e varreve, folezat dhe sidomos kryqet e zeza prej druri. Më pas kish nisur të depërtonte poshtë, duke kërkuar e duke gjetur, ku ishin e nuk ishin, të gjithë damarët e tokës brenda varreve. Së fundi, e panginjur, pati përtpur vetveten dhe tani prej saj kishin mbetur vetëm disa njolla të kobshme ngjyrë pahu.

Ai u çapit disa minuta mbi breza bimësisë të shuara dhe mes qiparisave që asaj ore po e ndërtonin pak nga pak hijen e tyre të natës dhe vuri re se mbi përmendoren që kërkonte qielli ishte ngjyer me purpur. Përpara se të shkelte pragun e saj dëgjoi fëshfërimën e një gjarpri që shkante vrik mbi njollat e pahta dhe mbajti vesh këngën solo të një bulkthi vetmitar.

Përmendorja pa lavdi i ishte dorëzuar rënimit. Dukej sikur ishte vulosur prej qindra vjetësh, por, kur hyri brenda, Paul Despiere-i gjeti mbi dyshemenë e shtruar me një mermer të plasaritur zishëm nga rrënjë pemësh dy gjethe të arrira vjeshte dhe u habit.

Në stelën në mur, një gjysmë qiriri ishte kthyer në gur, emri i saj pothuaj ishte shuar, kishte mbetur vetëm viti 1801, ndërsa statujëza e Virgjëreshës dukej e brejtur së brendshmi, ndonëse përsipër ruante një si shkëlqim të vjetër varaku. Përkundrazi, në të djathtë të stelës, figura e Artemisit – perëndeshës që nuk iu nënshtrua kurrë zgjedhës bashkëshortore – i kishte qëndruar kohës.

Paul Despiere-i vendosi në stelë karafilin e bardhë të dëlirësisë dhe u përpoq edhe një grimë të shquante emrin e saj pothuaj të shuar. E dinte se ajo nuk ndodhej aty. Nuk pati qenë asnjëherë. Furtuna e madhe që kishte shpërthyer përpara pothuaj dyqind vjetësh dhe që kishte hedhur në breg plot kufoma grash, nuk kishte mundur dot t'ia shkëpuste liqenit prenë e vyer.



Tej, përmbi pyjet e Dodonës, ishin formuar masive resh të zeza. Herë pas here vijëzoheshin reve vetëtima të mprehta, që shoqëroheshin nga gjëmime të kobshme, të cilat nuk arrinin gjer në bregun perëndimor të Pamvotidosit.

Fushat Eliziane notonin në një pellg të kuq perëndimi dielli.

Në breg të liqenit, mbi një shkëmb të thepisur, Paul Despiere-i ngriti sytë vetiu nga qielli dhe e kaploi frika: ende nuk kishte zënë të errësohej, por hëna ishte formuar befaz e plotë dhe vezulluese përmbi kokën e tij. Një frymë ere krijonte mbi liqen pllanga drite rrudhace.

Ekipi i arkeologëve nënujorë punonte ende përfund ujërave. "Edhe gjysmë ore mbetet", - mendoi Paul Despiere-i duke ua vënë veshin shushurimave të freskëta të erës nëpër shelgje, çapit të natës dhe iu shua shpresa e asaj fundite që tanimë kishte marrë arratinë.

Befaz, çdo zhurmë u tulat mbi liqen. Heshtja që pasoi ishte aq e thellë, sa djaloshi mbajti frymën padashur. Më pas, një hungërimë e fuqishme u çlirua nga rropullitë e liqenit, ndërsa qielli u ngjye me mellan¹ të zi. Paskëtaj u ndie një shkundullimë e fortë dhe hënë nuk pati më: rripi i tokës mbi liqen zuri të lëkundej çdo gjysmë ore, njëlloj si përpara dyqind vjetësh, në vjeshtë.

Paul Despiere-i, arkeologu i ri francez, që ia kishte kushtuar jetën studimit të Egjeut, u habit me atë fenomen që po përsëritej i përpiktë dhe po me ato karakteristika pas kaq shumë kohësh. Po hidhte disa shënime të shpejta në bllok kur liqenit e përfshiu një furtunë e vërtetë dhe dy silueta njerëzore buthtuan në çast nga ujërat e nxira të përshkumura. Në bregun e shkëmbtë, Paul Despiere-i pa siluetat që tërhiqnin pas vetes me mundim një formë të zezë. Atë çast, për herë të parë në jetë, Paul Despiere-i mendoi me bindje se Zoti ishte e vetmja qenie që ekzistonte me të vërtetë dhe se gjithçka, koha, njerëzit dhe ajo formë e zezë e porsadalë nga liqeni, nuk ishin veçse ëndrra të Zotit që përsëriteshin e përsëriteshin pa fund...

Paul Despiere-i iu afrua formës së zezë – furtuna ishte qetuar – dhe e njohu atë sënduk me veshje metali që s'donte t'ia dinte nga uria e kohës, njëlloj siç do ta kishte njohur ushtari fatzi që e kishte mbyllur dhe vulosur me duart e tij, që s'kish pushuar më pas së thëni se vdekja vetë e pati detyruar t'ua bënte kurban ujërave të liqenit bukurinë e pashoqe të Frosinës dhe që i pati ngrysur ditët në errësirat e humbamendjes, i lumtur që të paktën e kishte ruajtur të paprekur bukurinë e gruas nga tmerri i ujit...

Përpara atij sënduku-arkivol, Paul Despiere-it iu kujtua vetëtishëm se në kartërat relikte të një gjysheje antike, mikeshë e kontit Choiseul-Gouffier, kishte gjetur një letër dashurie të padërguar nga një drojë mistike, ku shkruhej: "Merrmë, i dashuri im, merrmë e mbyllmë në një sënduk të argjenditë si të bukurën Frosinë dhe mbytmë në hauzin e kopshtit tënd. Çdo mëngjes, mbush një grusht ujë nga hauzi dhe dehu me dashurinë time..."

Djaloshi pati gdhirë një natë të tërë duke lexuar korrespondencën e gjysheje antike, që ndodhej në një shkrim-tore bakëmi të lartuar me një *bonheur du jour*² dhe të qëndisur me fijeza bakri të praruar, frymëmarrë nga pluhuri i viteve, derisa, duke i vajtur pas një kundërmimi të vjetër lulesh portokalli, zbuloi letrat e kontit, të lidhura me një kordele ngjyrë deti.

Ndër të gjeti të shtrirë gjithë historinë e dashurisë dhe vdekjes së Frosinës, me një pasion aq të madh e të hollësishtëm, saqë iu duk se konti jo vetëm e pati njohur dhe adhuruar Frosinën, porse edhe pas vdekjes së saj lëngonte nga dashuria e tij e pathënë, me vagëllimën e së cilës tani përpiqej të ndriçonte shpirtin e zonjës Despiere.

Konti ishte kthyer disa herë në Janinë, i dërrmuar nga fati i tmerrshëm i Frosinës, por i vendosur të hetonte për vdekjen e saj. Paul Despiere-i gjeti një letër të shkurtër dhe pa komente, ku jepej deponimi i një murgu të arratisur nga Janina:

"Zonjën Frosinë e mbyllën në një sënduk venecian të larë në argjend dhe pak përpara se të zbardhte e hodhën në ujërat errtane të liqenit. Pas saj, diku më larg, zbrazën në liqen gjithë mllëfin e Ali pashait, vezirit të Janinës, duke mbytur, lidhur këmbë e duar, edhe shtatëmbëdhjetë gra të tjera që lebetiteshin duke thirrur qiell e Zot.

Kurse ajo kishte hyrë pa zë në varrin e larë në argjend, duke duruar përunjazi kurorën e turpit mbi kokë: ngjante si hije; fytyra i qe tretur dhe zbardhur si shkumës, flokët i qenë bërë të tejdukshëm, duart i mbante të lidhura në një lutje të përjetshme, vetëm buzët e përvëlura dukeshin sikur kishin mbledhur gjithë dashurinë e botës. Ndërsa dritën e syve nuk e kishte më, sepse kishte pranuar braktisjen..."

Kaloi edhe një agim dhe një muzg tjetër përpara se Paul Despiere-i të mund ta merrte në sy të hapte sëndukun e vulosur të Frosinës.

Gjithçka ishte kthyer në pluhur. Ai nuk guxoi të për-dorte sytë për të verifikuar shkatërrimin; zgjati dorën dhe nisi të kërkonte verbazi brenda sëndukut dhe përpara se të prekte unazën e moçme me gurë në formë zhuzhaku, e cila i kujtoi në çast unazën fatale, ndjeu një pickim të fortë në gisht. E tërhoqi dorën vrik dhe në gishtin e përgjakur gjeti një gjemb të vjetër trëndafil.

¹ Mellan (vjet.) – bojë shkrimi.

² *Bonheur du jour* – mobilie e vogël, pjesë e shkrimtëtores.

³ *Una rosa es una rosa* – Trëndafilja mbetet trëndafil.

Humori si formë kritike dhe emancipimi kulturor

Ribotimi i veprave të themeluesve të komedisë korçare përfaqëson një ndër ndërhyrjet më të rëndësishme në historiografinë e letërsisë dramatike shqiptare. Ky vëllim është akt rivlerësimi kritik e kulturor, që rikthen në qarkullim autorë si Kristo Floqi, Mihal Grameno, Foqion Postoli, Dhori Koti dhe Ilo Mitkë-Qafëzezi, të cilët, megjithëse hodhën themelet e komedisë shqiptare në fillimshkullin XX, për dekada mbetën jashtë kanonit letrar për arsye kryesisht jashtestetike. Riaktivizimi i kësaj tradite pasuron kujtesën letrare dhe forcon identitetin kulturor, duke e vendosur komedinë korçare në një rrafsh të ri të studimit akademik dhe të qarkullimit publik. Për më tepër, botimi i rikthen këto tekste në përdorim aktiv, duke u shërbyer studentëve, studiuesve dhe regjisorëve si burim i vlefshëm për kërkim dhe interpretim skenik.

Themeluesit korçarë të komedisë shqipe shquhet për përmasat e tij filologjike dhe arkivore, duke risjellë tekste të vështira për t'u gjetur nga studentët dhe studiuesit, shpesh të dëmtuara nga kalimi i kohës. Pajisja e tyre me aparate kritike të strukturuar për çdo autor dhe vepër e shndërron përmbledhjen në një burim orientues për studimet e ardhshme mbi teatrin dhe komedinë shqiptare, veçanërisht atë korçare. Redaktimi, shënimet shpjeguese dhe vëzhgimet kritike krijojnë një urë komunikimi midis tekstit historik dhe lexuesit bashkëkohor, duke ruajtur autenticitetin gjuhësor e stilistik të veprave.

Botimi dëshmon se komedia korçare e hershme ishte një formë e angazhuar e shprehjes artistike, e aftë të artikulonte kritika të mprehta shoqërore e morale. Humori, ironia dhe satira shfaqen si mjete për të demaskuar hipokrizinë, materializmin, ryshfetin dhe përplasjen midis traditës, që duhej ruajtur, dhe së resë, që duhej përqaftuar. Këto komedi i bashkon funksioni klasik i zhanrit: imitimi kritik i realitetit përmes së qeshurës, ashtu siç thekson Aristoteli te *Poetika*. Vlera e tyre qëndron edhe në aktualitetin e mesazheve: konfliktet që trajtojnë – mashtrimi, etja për para, kriza morale e individit, përplasia e dukjes me thelbin – mbeten të gjithkohshme. Kjo i bën komeditë, nga njëra anë, objekte studimi historik, dhe nga ana tjetër, materiale për lexim, vënie në skenë apo dhe analiza kritike. Humori dhe satira, si mjete të zbulësës morale, kontribuojnë në ndërgjegjësimin qytetar dhe në pasurimin e kujtesës kulturore.

Ky botim kontribuon në forcimin e vetëdijes për trashëgiminë dramatike shqiptare, duke e vendosur komedinë në një raport të barabartë me zhanret më të studiuara të traditës letrare. Përfshirja e veprave që trajtojnë çështje të gjuhës, identitetit dhe ndikimeve të huaja e afirmon rolin e komedisë si mjet emancipimi dhe qëndrës kulturor. Njëkohësisht, ky vëllim përfaqëson një model bashkëkohor të ndërthurjes së kërkimit shkencor me botimin kritik, duke prodhuar rezultate të prekshme si në auditorët universitarë, ashtu edhe për lexuesin e gjerë.

Mbështetja institucionale dhe përfshirja e studiuesve dhe studentëve në procesin kërkimor e shndërrojnë këtë projekt në një model funksional bashkëpunimi midis universitetit dhe institucioneve shtetërore¹. Botimi nuk synon thjesht rikthimin e së shkuarës, por rishkrimin e vetëdijshëm të historisë së komedisë shqiptare, duke ftuar artistët, studiuesit dhe lexuesit të rishikojnë rolin e humorit dhe satirës në formimin e mendimit kritik dhe kulturës letrare. Kjo dëshmon se e qeshura, është larg të qenët një formë e lehtë arti, por ajo mbetet një nga mënyrat më serioze për të kuptuar shoqërinë dhe vetveten.

Një projekt me rëndësi kombëtare: vlera dhe kontributi shkencor

Botimi kushtuar themeluesve të komedisë korçare përbën një përpjekje të rëndësishme në fushën e studimeve letrare, jo vetëm për nga lënda e ofruar, por edhe për nga qasja metodologjike dhe kritike që ndjek. Vlera e tij konsiston në faktin se e trajton komedinë shqiptare jo si zhanër periferik, por si diskurs estetik dhe shoqëror themelor në ndërtimin e modernitetit kulturor shqiptar. Në rang kombëtar, botimi kontribuon në rishikimin e historisë së letërsisë shqiptare, duke rikthyer në vëmendje autorë dhe vepra që për dhjetëvjeçarë kanë qenë të përjashtuar nga kanoni letrar për arsye ideologjike, politike ose edhe për shkak të neglizhencës akademike. Ribotimi i teksteve origjinale, i shoqëruar me aparat kritik, i jep studiuesve shqiptarë një bazë të qëndrueshme dokumentare dhe interpretative, duke plotësuar boshllëqe të ndjeshme në historiografinë e dramës dhe teatrit shqiptar. Në raport me qendra të tjera kulturore, botimi shërben si mjet rikujtese kulturore dhe identitare, duke ndihmuar në rivendosjen e lidhjeve midis krijimtarisë letrare, realiteteve sociale vendore dhe zhvillimeve historike, duke nxitur një ndërgjegjësim të ri mbi rolin e qyteteve në formimin e traditës dramatike shqiptare. Në këtë pikë, projekti e tejkaloi funksionin akademik, duke u shndërruar edhe në akt kulture.

Hartuesit e *Themeluesit korçarë të komedisë shqipe* janë profesorët e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, Jonela Spaho dhe Eris Rusi, pa harruar edhe kontributin e prof. Ilir Shytës në përgatitjen e aparateve kritike. Korniza teorike dhe kritike e shfrytëzuar i vendos veprat dramatike në raport me kontekstin historik, shoqëror dhe ideor të kohës. Leximi i komedisë si mjet emancipimi dhe ndërgjegjësimi qytetar thekson përmasën didaktike dhe qytetare të këtij zhanri në vendin tonë.

¹ Ky projekt u mbështet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), duke dëshmuar angazhimin për kërkimin shkencor dhe inovacionin, si dhe për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, edukimin kritik dhe afirmimin e identitetit kombëtar.

Mbi botimin *Themeluesit korçarë të komedisë shqipe**

Komedianët korçarë: rikthimi i një tradite

Nga Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)



Analiza strukturore e zhanrit komik, duke u përqendruar në ndërtimin e intrigës, karaktereve dhe situatave komike, si dhe në mekanizmat e humorit, ironisë dhe satirës, e bën botimin të vlefshëm për studiuesit dhe studentët e letërsisë, por edhe për profesionistët e teatrit, duke ndihmuar në kuptimin e komedisë shqiptare si formë artistike me rregulla dhe traditë të konsoliduar.

Arti dramatik në Shqipëri ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndriçimin e realitetit shoqëror dhe politik, shpesh duke shërbyer si ndërgjegjësim për vetëdijen kombëtare. Ndaj, botimi në fjalë sjell një perspektivë historiko-letrare dhe filologjike, duke u ndalur në çështjet e gjuhës, variantet tekstuale, kontekstin e botimit dhe qarkullimin e veprave. Hartuesit janë përkujdesur në besnikërinë ndaj teksteve dhe gjuhës së kohës, duke mundësuar që ky vëllim të mos jetë thjesht rishtypje e teksteve origjinale, por ruajtje e trashëgimisë letrare.

Struktura e botimit dhe parimet editoriale

Një nga aspektet bazë të këtij botimi lidhet me strukturën, e cila ndërthur tekstin letrar me analizën kritike dhe aparatit shpjegues. Përmbledhja është ndërtuar mbi parimin e paraqitjes së veprave në formën e tyre më autentike të mundshme, duke ruajtur integritetin tekstor dhe duke i shoqëruar ato me ndërhyrje të kujdesshme – për shembull, rastet e komedive të botuara para Kongresit të Alfabetit (1908) me "alfabetin e Stambollit" janë sjellë në alfabetin e unifikuar shqip, si dhe është ndërhyrë vetëm aty ku kërkohet sqarim filologjik, gjuhësor ose kontekstual. Kjo qasje e bën botimin të përdorshëm për lexuesin e gjerë dhe të besueshëm si burim studimor.

Ruajtja e veprave origjinale përbën një nga kontributet më të rëndësishme të këtij projekti, duke dëshmuar përkujdesjen filologjike të hartuesve. Tekstet janë ribotuar duke respektuar variantet e para të botimit, gjuhën e kohës, trajtat dialektore dhe veçoritë ortografike, të cilat përbëjnë dëshmi të rëndësishme për historinë e gjuhës dhe të shkrimit shqip. Në vend që të standardizohen apo modernizohen artificialisht, këto veçori ruhen dhe shpjegohen përmes shënimeve kritike, duke kthyer botimin në një formë të "restaurimit letrar". Një qasje e ngjashme përdoret edhe në botimet filologjike ndërkombëtare, siç është rasti, për shembull, i ribotimit kritik të veprave të William Shakespear nga The Oxford Shakespeare, ku tekstet origjinale ruhen dhe shpjegohen përmes aparatit kritik, duke mundësuar një studim historik dhe gjuhësor të detajuar, pa humbur autenticitetin. Ky parim editorial shërben si model për ribotimin e këtyre komedive shqipe, ku ruajtja e variantit origjinal lejon një lexim historik dhe gjuhësor të thelluar, ndërsa ndërhyrjet përfshijnë vetëm përafrimin grafemik, kur është i nevojshëm, për lehtësi leximi dhe përdorimi.

Struktura e botimit e organizon lëndën në rrjedhë koherente historiko-letrare, ku secili autor dhe secila vepër vendosen në marrëdhënie me zhvillimin e zhanrit dhe me kontekstin kulturor të kohës. Kjo qasje e bën librin njëkohësisht antologji,

botim kritik dhe tekst orientues për studime të mëtejshme, duke garantuar që trashëgimia e komedisë shqiptare ruhet dhe rishkruhet me përgjegjshmëri shkencore. Një parim themelor që udhëheq botimin është ndërhyrja e kujdesshme në tekstet origjinale; ndërhyrje që synon lehtësimin e lexueshmërisë, duke ruajtur plotësisht strukturën sintaksore, leksikon, trajtat dialektore dhe veçoritë stilistike të autorëve. Botimi ruan me rigorozitet vlerën dokumentare dhe estetike të teksteve burimore.

Përzgjedhja e titujve në këtë botim synon të përfaqësojë tipologjinë dhe funksionin kritik të komedisë korçare, duke përzgjedhur për secilin autor vepra që shfaqin vlerat artistike dhe rolin e tyre në formimin e traditës komike kombëtare. Përfshirja e *Reklamë e blofë* e Kristo Floqit, e cila u vu në skenë nga studentët e Universitetit "Fan S. Noli", shërben si rast paradigmatic i satirës shoqërore dhe i ndërtimit të intrigës komike, për të pasqyruar problematikat morale dhe shoqërore të kohës. Teksti dramatik ka funksion të dyfishtë: tekstual dhe skenik/performativ. Për autorë të tjerë, si Mihal Grameno, Foqion Postoli, Dhori Koti dhe Ilo Mitkë-Qafëzezi, janë përzgjedhur vepra që dëshmojnë funksionin kritik të zhanrit, lidhjen e tyre me çështjet e identitetit kombëtar dhe ruajtjen e gjuhës amtare, po dhe rolin e komedisë në proceset e emancipimit shoqëror. Çdo përzgjedhje shoqërohet me hyrje analitike që e lidhin strukturën dramatike dhe mekanizmat e humorit me ndikimet shoqërore dhe historike; dokumentimi performativ dhe transparenca filologjike janë kushtet metodologjike për t'u siguruar që botimi të shërbejë si mjet i besueshëm kërkimor dhe pedagogjik.

Hartuesit theksojnë se komeditë e Kristo Floqit, Foqion Postolit, Dhori Kotit, Ilo Mitkë-Qafëzezit dhe Mihal Gramenos përfaqësojnë tipologji të ndryshme të funksionit komik, duke e vendosur komedinë si pasqyrë morale dhe si mjet emancipimi shoqëror:

Kristo Floqi, me komeditë e tij njëaktëshe (*Reklamë e blofë*, *Akraballëket*, *Ministri kandidat*), përfaqëson tipologjinë e satirës qytetare, të ngjeshur dhe të drejtpërdrejtë. Këto komedi trajtojnë dukurinë e mashtrimit, korrupsionit dhe ambicies politike, duke e bërë komedinë pasqyrë morale të shoqërisë. Përmes dialogut të shpejtë dhe situatave orvatëse e të kota në dukje, lexuesi dhe publiku njihet me realitetin e përditshmërisë dhe me "njeriun e vogël", të vendosur përballë mekanizmave të mashtrimit dhe burokracisë, duke e shndërruar humorin në kritikë të mprehtë shoqërore.


Foqion Postoli, me *Martesa e një avokati* dhe *Vllazni e interesë* përfaqëson një tipologji të veçantë të komedisë morale dhe shoqërore, ku marrëdhëniet familjare dhe interesat e ngushta shfaqen si terren i hipokrizisë dhe materializmit. Figura e avokatit, e cila në parim duhet të mishëronte drejtësinë dhe ndërmjetësimin shoqëror, shfaqet e shpërfytyruar nga interesat vetjake dhe nga ambicia, duke e vendosur individin në konflikt të drejtpërdrejtë me normat shoqërore. Këto komedi pasqyrojnë tensionet e jetës së përditshme, ku humori shërben si mjet për të zbuluar kontradiktat morale dhe për të nxitur ndërgjegjësimin e shoqërisë.

Një element i rëndësishëm për të kuptuar funksionin emancipues të komedisë është edhe *censura*. Në Shqipëri, sidomos gjatë periudhave të mëvonshme, censura politike dhe ideologjike e detyroi humorin të përdorte alegorinë, nënkuptimin dhe ironinë e fshehtë për të shmangur ndëshkimin. Kjo e bëri komedinë më të rafinuar, por edhe më të rrezikshme për autorët. Në rastin e Postolit, temat e hipokrizisë dhe materializmit mund të lexohen si kritika të fshehta ndaj shformimeve të shoqërisë së kohës, të cilat, në një kontekst të mëvonshëm, do të duhej të maskoheshin edhe më shumë për shkak të mbikëqyrjes totalitare. Ndryshe nga vendet fqinje, si Italia, ku satira politike pas Luftës së Dytë Botërore gëzonte liri më të plotë, komedia shqiptare shpesh duhej të mbijetonte përmes figurave tipike dhe mesazheve të mirëkoduara.

Me Dhori Kotin kemi një zhvillim të ri: zgjerimin e strukturës dramatike. *Luloja* me dy akte shënon zhvillimin e karaktereve dhe situatave më të ndërlikuara, duke dëshmuar kalimin nga komedia e shkurtër satirike drejt një forme më të plotë, ku humori ndërtohet mbi tensionet e jetës shoqërore dhe marrëdhëniet ndërvetjake.

Me Ilo Mitkë-Qafëzezin kemi një tjetër moment kyç në zhvillimin e komedisë shqiptare: kalimin drejt komedisë së karaktereve. Komedia *Dhaskal Gjoka* në katër akte ndërton një figurë tipike – *dhaskalin* – që mbart konfiktin e kohës midis dijës, traditës dhe së resë. Kjo figurë shndërrohet në simbol të

² Shfaqja *Reklamë e blofë* u vu në skenë në dhjetor të vitit 2025 në Amfiteatrin e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe u interpretua nga studentët e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë. Aktiviteti u realizua në kuadër të projektit "Themeluesit e komedisë shqiptare nën dritën e kërkimit shkencor, botimit dhe artit skenik".



Projekt institucional i mbështetur financiarisht nga Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

debatit kulturor dhe shoqëror të fillimshkullit XX, ku komedia shërben si mjet për të artikuluar mëdyshjet mes përfaqimit të së resë dhe ruajtjes së traditës. Ndryshe nga komeditë e shkurtra satirike, *Dhaskal Gjoka* ka një strukturë më të gjerë, që lejon zhvillimin e karaktereve dhe situatave në shfaqje më të plotë.

Me Mihal Gramenon kemi rastin kur komedia shqiptare merr funksion të dyfishtë: politik dhe identitar. Komedia *Mallkimi i gjuhës shqipe* (pjesë kombëtare në vjershë me tre pamje, ngjarë në Korçë më 1886) përbën një akt të vetëdijshëm kulturor dhe politik. Ajo pasqyron problematikat e kohës për ruajtjen e gjuhës amtare dhe afirmimin e identitetit kombëtar, duke e shndërruar komedinë në mjet të qëndrësës kulturore dhe identitare. Humori nuk shërben thjesht për të argëtuar, por për të përcjellë mesazhe të qarta dhe të forta – mbrojtjen e gjuhës amë si themelin e identitetit kombëtar. Figurat dhe karakteret komike, së bashku me situatat në të cilat vendosen, mbartin simbolikë politike, duke parashtruar marrëdhëniet e pushtetit, konfliktet shoqërore dhe tensionet ideologjike të kohës.

Komeditë e përzgjedhura dëshmojnë jo vetëm për një proces tipologjik, por krijojnë edhe një rrjetë funksionesh të humorit dhe të ironisë, ku secila vepër përfaqëson një mënyrë të veçantë të përdorimit të së qeshurës si mjet kritik. Satira qytetare e Kristo Floqit demaskon mashtrimin dhe korrupsionin, komeditë morale të Foqion Postolit nxjerrin në pah hipokrizinë familjare dhe materializmin, Dhori Koti i jep jetë zhvillimit të karaktereve, Ilo Mitkë-Qafëzezi ndërton figura tipike që mbartin konfliktet kulturore, ndërsa Mihal Grameno e shndërron komedinë në akt politik e identitar. Ky zinxhir funksionesh tregon se humori dhe ironia shndërrohen në mjete të ndërgjegjes kulturore që pasqyrojnë mëdyshjet e kohës dhe nxisin emancipimin shoqëror.

Tradita që krijon një botim i tillë dhe horizontet për studime të mëtejshme

Një element që meriton interes të veçantë është fakti se ky botim nuk përfaqëson vetëm një rezultat kërkimor, por krijon një traditë – model metodologjik – për trajtimin e trashëgimisë letrare shqiptare. Për herë të parë, një korpus tekstesh dramatike të periudhës së hershme trajtohen sipas një metodologjie editoriale të unifikuar, ku të njëjtat kritere filologjike, gjuhësore dhe kritike zbatohen për çdo autor dhe çdo vepër. Rëndësia e kësaj qasjeje qëndron në faktin se kultura jonë letrare ka vuajtur jo vetëm nga mungesa e teksteve, por edhe nga mungesa e një metode të qëndrueshme për trajtimin e tyre, boshllëk që ky botim e adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në zhvillimin e studimeve letrare shqiptare është ndier nevoja për krijimin e një tradite të tillë për trajtimin e teksteve të trashëgimisë. Kjo përmbledhje arrin të balancojë dy nivele, që zakonisht trajtohen veçmas: *tekstin burimor* dhe *interpretimin*, përmes analizës kritike, kontekstualizimit historik dhe leximit bashkëkohor. Përveçse rikthen në vëmendje tekste dhe autorë të para një shekulli, ky botim formon një traditë editoriale që garanton koherencë metodologjike, duke balancuar tekstin burimor me interpretimin kritik, ai krijon një standard të ri për mënyrën se si duhet trajtuar trashëgimia letrare qytetare.

Ky botim hap horizonte të reja studimore dhe krijon hapësira për kërkime të mëtejshme. Tekstet e ribotuara, së bashku me aparatën kritik që i shoqëron, ofrojnë mundësi për analiza krahasuese dhe ndërdisiplinore, duke e lidhur letërsinë me zhvillimet historike, shoqërore, politike dhe gjuhësore, sidomos në formësimin e normës. Njëkohësisht, botimi nxit studime mbi receptimin e veprave dramatike dhe historinë e vënies së tyre në skenë, duke u shndërruar në burim referues për programet universitare dhe në mjet didaktik për studentët e gjuhë-letërsisë, teatrit ose studimeve kulturore, po dhe në stimul për rikthimin e këtyre veprave në praktikën skenike bashkëkohore. Përtej vlerës dokumentare, botimi krijon një bazë të qëndrueshme për studime ndërdisiplinore, ku komedia shqiptare mund të analizohet në raport me historinë e ideve, sociologjinë e kulturës dhe humorit. Ribotimi i teksteve të hershme hap mundësi për krahasime me traditat ballkanike dhe evropiane, duke e vendosur komedinë shqiptare në një rrjet më të gjerë kulturor.

Një tjetër horizont i rëndësishëm është përkthimi i këtyre veprave në gjuhë të huaja, çka do të mundësonte njohjen e tyre jashtë vendit dhe integrimin e komedisë shqiptare në diskursin ndërkombëtar mbi satirën dhe humorin si forma të ndërgjegjes shoqërore. Pra, një botim i tillë mund të rijetësojë projekte të tjera, pse jo edhe bashkëpunime rajonale ose dhe mbarëkombëtare mbi historinë e humorit dhe satirës, duke përbërë një arritje afatgjatë në kulturën dhe letërsinë shqipe, çka dëshmon se komedia, është larg të qenët një zhanër "i lehtë" dhe mbetet një nga format më serioze të ndërgjegjes kulturore dhe shoqërore të kohës.

* Shih: *Themeluesit korçarë të komedisë shqipe*, përmbledh. Jonela Spaho, Eris Rusi; aparatë kritik: Jonela Spaho, Eris Rusi, Ilir Shyra; red. Jorina Kryeziu. Botim i mbështetur nga Universiteti "Fan S. Noli" Korçë. Tiranë: Ada, 2025. 519 faqe. Përmban: Kristo Floqi: *Reklamë e blufë: komedi me një akt*, *Akraballëket: komedi me një akt*, Ministri kandidat: *komedi me një akt*; Foqion Postoli: *Martesa e një avokati: komedi me një akt*, *Vllazni e interesë: komedi me një akt*; Dhori Koti: *Luloja: komedi me dy akte*; Ilo Mitkë-Qafëzezi: *Dhaskal Gjoka: komedi me katër akte*; Mihal Grameno: *Mallkimi i gjuhës shqipe: pjesë kombiari në vjershë me 3 pamje ngjarë në Korçë më 1886*.

ALBAN TUFA

Katër poezi për katër lloje mungesash

ME ASHENSOR

me zbret melankolia,
gjithë mashtueshëm hyn në hollin tim,
Dhe me gishtin tregues m'i numëron mungesat.
Mungesat që me tehet e dëshirave mu hapën gropë,
Mungesat që kujtimet mi bënë kapak.
Në këtë holl të zbrazët
si sallë dasmash pa dasmorë,
nis vallëzimin e radhës melankolia.
Me shikimin e saj m'i tejshpon mungesat,
kujtimet kapakë,
kapakë mbi gjiriz.
Gjithë-gjithë njeriu është gjiriz,
ku qelben mungesat, kujtimet,
dëshirat.
Dhe gjirizet janë të pavënë re,
deri kur melankolia zbret me ashensor,
dhe si lugë hallve
trazon
bërsitë e pavetëdijes.

Darmstadt
Prill 2026

PSIKOLOGJIA E KORES

Në pamje të parë gjërat s'duken keq,
të gjitha kanë kore, të gjitha kanë mbulesë,
por ajo çka fshihet për nën mushama
është pak ta quash si: faqja e zezë.
Dhe paqja, dhe heshtja, rrojnë mbi kore,
por jeta dhe tmerri, zënë fill nën lëvore.

Si unë edhe ti, kësaj bote i përkasim,
bërë prej mekanizmash të prishshëm lehtë
njëjtë përbrendësas si ingranazh kërcasin
shpirtin ta[
pickojnë si një thikë e mprehtë.
Por paqja dhe heshtja buejn në lëvore,
dhe jetës i japin atë dukë mortore.

Diç paska përherë më të rëndë se sa
çka mundet me rrokë mendja jonë përtace
vetmia, limontia, e plogësht sa s'ka,
dhe dita që tregohet skajshmërisht koprrace.
Dhe dashje pa dashje zhytem në lëvore,
të kujtimeve që krijuam bashkë përdore.

Në pamje të dytë, në pamje të tretë,
gjërat ndërrojnë formë si pikselë në ekran,
gjithë që thjeshtë dukej, ka zënë duket keq,
korja ime e trashë tash e tutje s'mban.
Dhe ka zënë është çarë mbulesë e lëvore:
vetmia më udhëheq si të qe dashnore.

Ober-Ramstadt
Maj 2026

NË DHOMËN TIME RRINË

të dëshpëruara disa orendi minimaliste:
një krevat tek,
një gjysmë gardierobë,
një karrige,
një raft me dy sirtarë
dhe një tavolinë.
Mbi të rrinë shatë libra
vetëm njëri në shqip
I mbërthyer si në pranga
nga tre anglezë dhe tre gjermanë.



Me një vështrim të parë
mund ta shohësh si dhomë burgu.
por nëse sheh kompjuterin në tavolinë
mund ta shohësh si zyrë burgu.
Mure të bardha
këto mure të bardha m'i vrasin sytë,
bashkë me to edhe mendimet,
ndër të cilat përherë
njësoj si në çdo luftë,
si në çdo burg
njëri ia del të mbijetojë.
Dhe këtë farë mendimi,
këtë dhomë si burg
e bëra shtëpi.
Në të, të vizatova ty,
kudo: në krevat tek çel sytë
në karrige tek ha mëngjes,
në gardierobë tek palos rrobat,
pranë sirtarit tek rrëmon diç që s'po e gjen.
Dhe në fund,
të bëra pikturë
dhe të vara në murin e bardhë
shtatëqind herë më të bukur se çdo Mona Lizë.

Ober-Ramstadt
Mars 2026

NE E SHAMË SHQIPËRINË

Ishte ftohtë dhe fytyrat tona ngjanin
si dy kofsha viçi në frigorifer.
Gjermania është frigorifer i madh
Frankfurti është kati
ku mbahet mishi i ngrirë.
Dhe me zhgënjimin që e ndjek
një kofshë mishi të ftohtë
ne u takuam në *altstadt*.
Të dy dhamë selam kur u afruam.
Dy myslimanë në tregun e krishtlindjeve.
Të dy e dinim veten kofsha mishi hallall,
kështu që në vend të verës
pimë lëng portokalli të nxehtë.

Të dy ishim të ikur,
hidhëruar me vendin ku lindëm,
në dëshpërim e sipër
ishim drejtuar në thertoren e parë.
Folëm pak për shkollën,
shumë më pak folëm për punën
dhe për disa orë me radhë folëm për Shqipërinë.
Binte shi i imët,
si çdo ngjarje që ndodh në shi
edhe këtu zë rrënjë melankolia.
I kujtuam ditët e arta,
të ndërsyera me ëndrra që s'u përmbushën,
dhe të dy ia lamë fajet Shqipërisë.
Edhe shiu ngjante i dëshpëruar,
aq sa nga mëria nisi të bëhej rrebesh.

Dhe folëm për orë të tëra,
derisa vendalinjtë
ua lanë skenën të pastrehëve.
Ndërsa ne e shamë Shqipërinë
atë natë
tek pinim lëng të nxehtë portokalli.
Aq shumë folëm për të
sa nga zemërimi ynë
edhe shiu i imët që binte u bë dëborë.

Frankfurt

Jam lindur në një familje, që të themi drejt, jo gjithmonë i kanë tepruar thërrimet... Sidoqoftë, kurrë nuk e kam pasur dorën e shtrirë me i lypë dikujt për kafshatën e gojës. Si të gjithë ju, edhe të mitë u kujdesën për mua e fëmijët e tjerë më shumë se sa i mbaj mend sot me syrin e viteve që kaluan e të cilave kemi mall t'u kthehem herë pas here. Im atë përmendte shpesh që *mundohu deri në ditën e fundit me zanë shokë e miq, kushedi si sillet puna...se jo kot populli ynë ka thënë se "borxhi i vonë e gëzon të zonë"*. Por edhe shlyerja e një borxhi të hershëm, të gëzon e të jep forcë që vetëm ai që e provon ja din vlerën. Ndoshta është kështu edhe për mikun "e vonë", për librin e të cilit po bashkëbisedojmë sot.

Fillojmë: Libri si një mesazh nderimi e përkujtimi

Më ka ndodhur edhe mua kështu, ndërsa po mbyllja një borxh, ose më mirë një detyrim, thuaja si të duash, që më lidhte me një mik të hershëm të jetës sime që në gjimnazin e Durrësit, poetin e ndërjer Moikom Zeqo. Ia kishim botuar një libër të përkthyer në gjuhën malazeze "Përjetësi me qira" dhe kishte shumë dëshirë që libri të promovohet në Tiranë. Ishin ditët e fundit të jetës së tij. Dhe duke u munduar që ai ta mbyllë sa më mirë rrugën e vet poetike, nga spitali në Tiranë, me një çantë të varur në qafë me aparate mjekësore vjen të asistoj në paraqitjen e librit të tij të përkthyer në gjuhën e një komshiu... Shumë do të kisha hyrë borxh që ta shlyeja ashtu si duhej këtë dëshirë të tij. Mbledhur shumë njerëz te stenda jonë, miq e shokë të tij, e ndiqnin syhapur çdo lëvizje të tij. Edhe unë bëja ashtu... Por mbi të gjithë e theu heshtjen dalja e guximshme e një personi që më ndihmoi me shlye borxhin ndaj tij, por duke më futur në borxh të ri të personi tjetër, pikërisht te ky që na ka mbledhur sonte, poeti i madh i fjalës e i gjuhës shqipe, i thjeshti dhe i thinjuri Agim Vinca. Nuk është kollaj të gjesh epitete të bukura që fillojnë me - th -, ... se këtë shkronjë do ta përmend prapë më vonë në këtë diskutim. E kam atë fotografi gjallë, sa me u shlye para jush, se nuk kam shtuar asgjë për ndonjë elozh. Por më vjen mirë, ashtu si i kishte ardhur mirë secilit, kur dikush të kujton e më shumë të ndihmon me u shlye burrërisht.

Asnjë kërkesë nuk kam pasë as unë e as enti prej poetit Agim Vinca që të botohet tek ne. Unë vetëm kam këqyrë mundësinë për ta botuar dhe kur jam siguruar se ekziston në programin tonë mësimor me poezinë Driloni, i jam drejtuar Kryetarit të KK të shqiptarëve zotit Faik Nika, duke i thënë se e kam propozuar për këtë vit veprën e tij poetike për ta botuar në dy gjuhë. Faiku, si gjithmonë, e ka mirëpritur dhe shumë i gëzuar ma ka uruar botimin e saj, bile edhe një takim me të, në Ulqin, pikërisht takimin e sotëm. Çfarë mësojmë në poezinë e Vincës?

Vazhdojmë: Libri si një mision për të gjithë...

Që nga titulli "Falmi sytë e tu, Homer" të duket se je para një muri të Jerusalemit apo rreth Mekës dhe shikon drejt tij për të kërkuar diçka. Muri nuk ka vrima dhe ti e kupton se dikush duhet të të dëgjojë, të të shohë. Muret nuk kanë as duar që të afrojnë. Nuk kanë as gojë të të thërrasin. Por ti e ndjen se ke nevojë t'i drejtohesh dikujt që të kuptojë atë që ke brenda, që do të shfrysh për t'ia thënë së paku ashtu si e ndjen. Nuk e gjen...ose më mirë e gjen në zgavrat e syve të Homerit të madh dhe i lutesh: Falmi sytë e tu të verbër dhe e shkruan vertikalisht fjalën, pra emrin **Homer...** me vargje shkallë-shkallë sikur do ta zbresësh prej qiellit hyjnor drejt tokës ku ndodhet i verbër syri i poetit dhe të gjitha hallet e kësaj bote. Dhe këtë e bën me forcën e poezisë, së cilës i ka vënë misionin e madh që në hyrje te poezia e parë *Të jesh poet*, me fjalët e para të saj:

*Të jesh fanar mes errësirës
Të mos harrosh se në botë ka
kaq shumë të verbër.
(Nga poezia *Të jesh poet*)*

Diskutim në përrurimin e librit "Falmi sytë e tu, Homer" të poetit Agim Vinca

MES VARGJEVE ME VLERA TË PËRHERSHME

Nga Dimitrov Popoviq

Pra ai ka vendosur të mos jetë i verbër në shikim, por i pranishëm kudo dhe i gatshëm të tregojë për çdo gjë që ndeshim në udhën e jetës. Të jesh poet bën të jesh i vogël, bën të jesh i varfër, bën të jesh me një sy, ose pa të dy si Homeri ynë, por nuk bën të mos jesh guximtar, që siç shprehej Azem Shkrelit "Mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë." Duke i hapur e kaluar fletët e librit një e nga një, të del jo pak punë, nëse merr mbi vete të futesh në spektrin e shqetësimeve të tij që janë të shumta, bash të shumta. Si një djalë e baba i mirë, si një gjysh stoik, si një vëlla i përkushtuar për pjellën e vatrës, si një bashkëbisedues koherent, si një krijues modern, por i thjeshtë, si një shok i kohës, si një mysafir kryeqytetesh e qytetesh botërore, si një kalimtar doganash dhe së fundi një njeriu që me një zemër të pastër e shpirt të butë të paraqet ato që ti kollaj thua "se i paska shkruar për mua" ti menjëherë kështu nuk thua asgjë më shumë se njërin nga cilësitë kryesore të poezive të tij, atë për të cilën edhe ajo krijohet, pra **përgjithësimi, për të qenë e të gjithëve**.

Jemi aty: Poezia e tij është e drejtpërdrejtë. Me leximin e saj menjëherë kupton se po ecën në një rrugë që është e krijuar qëllimisht për ty, se edhe ty të kanë përcjellë ato takime e ballafaqime, sepse jemi nënash dhe prej shpirtit të tyre bartim kudo detyrimet për motrën, për plakun, për mbesën etj. Këtu nuk ka kohë për moralizim, këtë sëmundje të kohës së poetëve të paformuar. Janë fjalë të tjera të thëna "ndrysh" prej të përditshmes, ku nuk je tepër, pavarësisht si thuhet. Pas tyre fshihet një e thënë në mënyrë të figurshme që ta afron më ndjeshëm njeriun tënd. Po më kujton dhe afron një vlerësim të Çabejt në revistën "Nëntori" nr. 4, viti 1965, kur shkruan për poezitë e Nolit duke thënë se: "Ai i ka jetuar ato, ka jetuar ai vetë nëpër to, në figurat e heronjve". Te poezia *Ninullë dimri* (mbesës sime Borës) - e pata nxjerrë në fejsbukun tim pa i marrë lejen autorit dhe të them drejt jam mrekulluar me komentet në mesazhet e njerëzve të mirë. Ja sa ndjeshëm shkruhet aty:

Fli, Borëz, princesha e gjyshit. Mbylli sytë e kaltër -
Njëri liqen i Prespës, tjetri liqen i Ohrit - dhe fli.

Dimër është e nata është e gjatë
Jashtë bie shi e flokon borë; pikojnë strehë e çati.

Po ti fli, fli! (Fq. 45)

Poezia e familjes dhe e lidhjes me të është e pranishme thjesht e pa himnizime. Ajo është e shpërndarë nëpër libër me kujdes dhe në çdo lexim të afron një përkujtim të heshtur diku brenda teje. Çdo motër do të krenohej për së gjalli me vëllanë e vet dhe për të do të bënte më shumë se një poezi...Por poezia *Këputa një degë jargavani* është shumë më tepër se kaq. Përmes një simboli të thjeshtë siç është dega e një jargavani dhe ja strofa e hyrjes:

Këputa një degë jargavani
Dhe e vura mbi varrin tënd.

Thjesht, pa ceremoni.

Një degë jargavani nga oborri ynë i vjetër
i rrethuar me avlli.

Apo prapë për motrën, në udhëtimin e fundit të saj, motrës që me sëmundjen e keq kthehej në shtëpi /Si në baladën e lashtë të fjalës së dhënë/ që s' e tret dheu/.

Si në baladën e lashtë
Të Konstandinit të Vogël

Unë e ti, motër.

Metafora shumë e bukur, por edhe krahasimi shumë i gjetur.

Shkoj edhe më tej: Gjeografia poetike e shkrimtarit është shumë e gjerë, ajo ka përcjellë vendqëndrimet e kahershme të tij që fillojnë qysh me lindjen në një qytezë në Maqedoninë e Veriut e me radhë në Prishtinë etj. etj. dhe duke kaluar shpesh kufijtë e shteteve ka bërë që të nxjerrë natyrshëm e të përkufizojë një konkluzion se të vetmet qenie të gjalla që s' kanë nevojë për pasaportë, ndonëse kalojnë gjerë e gjatë globit, janë zogjtë. Ah sa ndryshojnë ata nga shtegtari ynë mendjendritur, kur duhet të sqarohet brenda gjuhës së vet të artë se nuk duhet ngatërruar "th"- ja me "s" si tek emrat kufitarë Qafa-s-an (Qafëthanë) apo Vu-th-aj me Vu-s-anje etj. Por mbi të gjitha dashuria e gjeografisë fizike i jep vlerën e një atdhedashësi të përkushtuar ndaj vendlindjes, ku plepat e rrugës, këta "vëllezër buzëdrinas" ulin kryet për ta nderuar... Jam mahnitur, por s' jam befashuar kur kam lexuar poezinë *Baladë për Malin e Thatë*.

Është një mal në jug
Me emrin Mal i Thatë
Në mes dy liqeneve

etj. Sa do ta dëshiroja që këtë poezi ta kishte lexuar Poradeci i pavdekshëm, kur shkruante: "Fryn veriu në Mal të Thatë / thotë vasha lele, ngriva". Si një mjeshtër i madh i krijimit na ka sjellë një figuracion letrar të fuqishëm. Një antitezë e fuqishme në bazën e kësaj poezie dhe konkretisht: Mali është i thatë, e ndodhet mes dy liqeneve - të Ohrit dhe të Prespës, dhe askush nuk di të thotë si mbet ky mal i thatë mes ujërash. Ose pranë tij shtrihet një lëndinë me emër të çuditshëm - *lëndina e lotëve* - e askush nuk di thotë si mbeti ky mal i thatë edhe pranë lotëve...dhe e konkretizon "Mal i thatë/ pa bimë, pa drurë, pa zogj/ i vdekur për së gjalli". Dhe për ta mbyllur këtë kundërshti pyetjesh, zgjedh një krahasim që i përshtatet aq bukur "Si një njeri / i tharë nga malli". Ta them drejt, në një konkurs letrar ose muzikor, do të doja që ky tekst të recitohej e këndohej me një ndjeshmëri të lartë.


Dhe ndalem këtu: Poezia atdhetare e qytetare e Vincës përbën bazën e të gjitha poezive, se të jesh atdhetar i mirë, duhet ta duash vendin e kombin tënd, ta gëzosh dhe ta lëvdosh, ta nderosh dhe ta mbrosh, ta bësh më të bukur dhe më të fuqishëm. Dhe kjo bëhet duke vënë pranë kështjellave të mëdha të botës jo veç Rozafën, por edhe Eifelin, edhe Trojën, edhe Çanakalanë edhe Termopilet, që të shkosh jo vetëm në Nju-Xhersi e Nju-Jork, Paris, Lugano etj. por të shkosh edhe në Pogradec, në Mitrovicë, në Drenicë, në Shën Naum etj. dhe përkrah personazheve të mëdha të historisë e kulturës botërore të vësh të mëdhenjtë e kombit tënd që u ngjasojnë atyre ose maten me ta, siç janë Skënderbeu, Nëna Terezë, Naimi, Migjeni, Lazgushi, Fan Noli, Kostandini, Shen Nikodimi, Moisiu, Kadareja, Dritëro, Thoma Kacori, Podrimja, Ndoc Gjetja e sa e sa të tjerë që përmenden këtu pranë Homerit, Shekspirin, pranë Hygosë, pranë Apolinerit, Bajronit, Pushkinit, Lermontovit, Mopasanit, Markiz de Sad, Brehtit, Sartrit, Milerit, Bukovskit etj. Të gjitha këto do t'i gjeni në këtë libër në dy gjuhë - shqip dhe gjuhën malazeze, do të thojë mes vargjeve me vlera të përherhme.

Kam të drejtën e shtëpisë sonë botuese ZUNS - të drejtoreshës A. Hajdukoviç, të kryeredaktorit R. Novoviç e M. Dragoviç dhe të tjerëve që janë këtu, të përsëndes dhe të falënderoj përkthyesin e mikun tonë Smajl Smaka. Me kujdesin e duhur ai e ka përgatitur përkthimin e këtij libri. Ai ka përkthyer në gjuhën malazeze për shtëpinë tonë edhe Moikom Zeqon, poetin e madh e të paharruar. Njëkohësisht falënderoj dhe nderoj redaktorin në gjuhën malazeze zonjën Lida V. Tabash, që arriti të përgatisë botimin duke iu dhënë mundësi edhe nxënësve të pakicave të tjera në Malin e Zi që të njihen me krijimtarinë e poetit Agim Vinca, që jo vetëm ta lexojnë, por edhe ta përfshijnë në programet e librat e antologjive të tyre për klasat e ndryshme në shkollën fillore e gjimnaz.

Duke e mbyllur këtë shkrim të thjeshtë, theksoj se e kam për nder që botoj në gjuhën shqipe, që jam njëri nga redaktorët e këtij libri dhe po ri përmend se poeti e akademiku Agim Vinca ka lindur në Veleshtë të Strugës, ka shkruar në Prishtinë, ka "bredhur" në Gjermani, në Francë e në Amerikë, ka qenë edhe në burg, ka kaluar edhe Qafëthanën..., sot ka kaluar edhe dy dogana - Morinë e Sukobinë... e ku nuk ka qenë, dhe pas gjithë këtyre ecejakeve, *duke forcuar thyesën e tij në favor të numëruesit*, po ashtu si e do e mira jonë e përbashkët, sonte e kemi këtu, mes nesh, (bashkë me Zonjën e tij) pak i lodhur nga rruga e gjatë, por i gatshëm të na dëgjojë dhe të ndajë me ne kujtime të tjera shtesë, porosi e mirëdashje.

Mirë se erdhe, profesor e poet i dashur Agim Vinca!

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
Podgoricë, 22. 4. 2026



Montagët na kishin ftuar për darkë këtë fundjavë. Ishim Mortakë në biznes prej vitesh dhe, përtej fitimeve dhe humbjeve, kishim krijuar një marrëdhënie që na bënte të ndiheshim më shumë si miq sesa partnerë biznesi. U nisëm një orë më herët për të shmangur trafikun e fundjavës. Qielli ishte i ulët, dukej sikur po çanim retë përmes, kishte marrë një ngjyrë gri të plumbtë, megjithëse parashikimi kishte qenë për kthjellime. Udhëtonim në rrugën pothuajse bosh. - Çuditshëm bosh për një të shtunë, - më tha bashkëshortja ime duke parë nga dritarja.

Shtëpia e tyre ndodhej rreth tridhjetë minuta larg, në një zonë të qetë me vila të shpërndara larg njëra-tjetrës. Një vilë dykatëshe në stil libertin, me dritare të mëdha dhe një ballkon të harkuar që shikonte nga kopshti. Sapo parkuam vura re se perdet bezhë të dritareve të katit të sipërm ishin ndërruar. Ngjyra blu e thellë e perdeve të reja kontrastonte me fasadën e bardhë të vilës. Atë çast pata një dyshim se mos kishim ardhur në vendin e gabuar. Bëmë para për nga dera. Qielli i plumbtë rëndonte mbi shpatullat tona si pelerinë e nderur nga kapriçot e motit. Kur u afruam, dera u hap vetë. Mbetëm te pragu. M'u kujtua se kamerat termike kanë sensor dhe dera u hapet vetiu njerëzve të njohur. Pamë njëri-tjetrin në sy dhe bëmë para për nga salloni. Ndrimi ishte i butë, të jepte ndjesinë e mirëseardhjes. Kishim vite që frekuentonim shtëpitë e njëri-tjetrit, ishim të miqësuar me atë vilë, me arredimin e dhomave, ndarjet, veprat e artit, bibliotekën, llambadarët. I vetmi ambient që nuk kishim vizituar ishte dhoma e katit të dytë që shihte nga kopshti lindor i vilës.

Ime shoqe lëshoi një zë që u pasua nga unë:

- A ka zot kjo shtëpi?! ... Jemi nga zyra e tatim - taksave. E qeshura e lehtë filloi të na zbehej në fytyrë. Nga dhoma ku zakonisht shtrohej darka për miqtë vinte një muzikë e lehtë: Vivaldi, "Katër stinët". Me një lloj ndrojtjeje kaluam nga salloni te dhoma e darkave pa thënë asnjë fjalë. Ndrimi i butë ngjyrë kremi i dhomës, i përzier me muzikën e Vivaldit, na dha një lloj çlirimi. Llambadari lëshonte një shkëlqim të ngrohtë mbi tavolinën në qendër të dhomës. Mbi të ishte shtuar një mbulesë e hollë e bardhë. Katër pjata ishin të vendosura me simetri të përkryer, secila në pozicionin e saj të përcaktuar. Gotat e verës qëndronin pranë pjatave, të mbushura deri në gjysmë. Kristali i tyre reflektonte dritën dhe krijonte pika të vogla shkëlqimi mbi mbulesën e tavolinës. Një prej gotave dukej sikur ishte prekur pak më parë; kishte një gjurmë të lehtë në buzë, si shenjë gishti që nuk ishte fshirë plotësisht. Në mes të tavolinës qëndronte një shishe vere Barolo, e hapur. Tapa ishte pranë saj, ishte lënë me kujdes mbi një pecetë të palosur. Pranë shishes, një vazo e hollë kristali mbante lule të freskëta orkide me petale të hapura, të bardha dhe pak të përkulura në skaj. Aroma e tyre përziehej me aromën e drurit të mobilieve dhe me tingujt e muzikës që mbushnin hapësirën. Pecetat ishin të palosura në formë të rregullt, thikat dhe pirunët ishin vendosur paralelisht, në një vijë të drejtë, duke reflektuar një lloj rregulli përtej atij të zakonshmit. Ishte shumë ceremoniale ajo tavolinë për një marrëdhënie të shpenguar miqësore si ajo e jona me Montagët. Kishin kaluar minuta dhe ne akoma nuk dinim se çfarë ishte e gjitha kjo: një ëndërr, halucinacion, neurozë apo një skenë...?!

- Unë nuk kam qenë kurrë në këtë vend, - tha ime shoqe. Fillova të kisha dyshime edhe unë, mirëpo, përveç mungesës së Montagëve, gjithçka tjetër ishte siç kish qenë që në ditën e parë që kemi shkelur në këtë shtëpi: kopshti me tulipanë të verdhë, ngjyra e fasadës, ballkoni i harkuar me lule vile, arredimi i brendshëm sipas shijes së Montagëve, vera që na shërbehej darkave, muzika... gjithçka ishte një provë që fliste në favor të Montagëve. Situata absurde ku njeriu nuk e kupton nëse është duke jetuar një jetë tjetër apo një lojë të mendjes së vet. Qëndruam për pak çaste në këmbë, pa prekur asgjë, sikur prania jonë mund të prishte ekuilibrin e brishtë të asaj skene.


- Ndoshta janë lart, - thashë me zë të ulët, më shumë për të qetësuar veten sesa për ta bindur atë. Ime shoqe nuk u përgjigj. Vështrimi i saj ishte ngulur te tavolina, te gota me gjurmën e lehtë në buzë. Dukej sikur po përpiqej të rindëronte një skenë që kishte ndodhur pak çaste më parë: katër njerëz të ulur, një bisedë që rridhte qetësisht, dhe pastaj diçka që e kishte ndërprerë në mënyrë të papritur. Muzika e Vivaldit vazhdonte, tingujt e violinave mbushnin dhomën me një lloj elegancë të ftohtë, sikur vetë shtëpia të ishte duke vazhduar jetën e saj pa pasur nevojë për ne. Bëra disa hapa rreth tavolinës. Shikimi më mbeti te karrigia që ishte paksa e tërhequr nga tavolina, si të ishte ngritur dikush me nxitim.

- Ka njeri këtu...? - thirra me një zë që më doli me pak ndrojtje. Asnjë përgjigje. Ime shoqe u afrua te dritarja e madhe që shihte nga kopshti. Jashtë, tulipanët e verdhë qëndronin të palëvizshëm në dritën okër të hënës.

ARTUR BAKU

Darka e amshuar

Tregim



- Është shumë e çuditshme, - tha ajo. - Sikur dikush të jetë larguar një minutë më parë. U afrova edhe unë te dritarja. Kopshti ngjante me një vepër arti, natyrë e qetë, pothuajse i ngrirë. Nuk dëgjohej asgjë, vetëm muzika që vinte nga brenda. Heshtja që pasoi ishte më e rëndë se më parë. Muzika kaloi në një nga pjesët më virtuozë të katër stinëve, "Vjeshta". Dëgjuam një zhurmë të lehtë që vinte nga kati i sipërm. Hapa, copëza bisedash... ishte e kuptueshme vetiu, të dy kishim të njëjtin mendim.

Morëm shkallët prej druri që të çonin në një korridor të ngushtë gjysmë të errët. Ndërsa ngjiteshim, muzika na vinte më e largët. Në fund të korridorit ndodhej dera e dhomës që nuk e kishim parë kurrë. Një vijë e hollë drite dilte nga poshtë saj. Shtyva derën. Dhoma ishte e ndriçuar pothuajse njësoj si ajo poshtë. I njëjti llambadar, e njëjta tavolinë, e njëjta mbulesë e bardhë, të njëjtat pjata të vendosura me një simetri të përkryer. Edhe shishja e Barolos qëndronte në mes, me tapën mbi pecetë. Ndryshe nga poshtë, këtu tavolina nuk ishte bosh. Katër njerëz ishin ulur dhe po darkonin. Biseda u ndërpre sapo u hap dera. Të katërt kthyen kokën nga ne, pa ndonjë habi të dukshme, sikur hyrja jonë të kishte qenë e parashikuar. Zoti Montag ngriti pak gotën dhe tha me një ton të qetë, pothuaj ceremonial:

- Mirë se erdhët! Ju prisnim.

Pastaj u kthye nga dy të panjohurit përballë tij dhe shtoi:

- Këta janë miqtë tanë. Kapuletët. Ime shoqe më shtrengoi lehtë krahun.

Nuk e kuptova nëse fjala "Kapuletët" u drejtohej atyre apo neve.

Dy të panjohurit në tavolinë na shikonin me një lloj kureshtjeje të përmbajtur, si njerëz që përpiqen të njohin dikë që e kanë parë diku, në ndonjë darkë tjetër... Burri ngriti gotën dhe buzëqeshi lehtë.

- Kemi dëgjuar shumë për ju.

Nuk e kuptova nëse e kishte fjalën për ne apo për veten e tyre.

- Uluni, - tha zonja Montag me një ton të butë, sikur gjithçka të ishte krejt e zakonshme.

Na bëri me shenjë nga dy karriget boshe. U pamë me time shoqe. Në atë çast më erdhi në mendje një pyetje e natyrshme: Nëse ne ishim Kapuletët, atëherë kush ishin ata që tashmë rrinin në tavolinë?

Burri tjetër, ai që nuk e kisha parë kurrë më parë, e vuri re hezitimin tonë dhe tha me një qetësi të çuditshme:

- Mos u shqetësoni. Kjo ndodh gjithmonë në fillim.

- Çfarë ndodh? - pyeta pa e kuptuar pse po flisja me zë të ulët.

Ai ngriti supet lehtë.

- Askush nuk e kupton saora nëse është Montag apo Kapulet.

Në atë çast muzika e Vivaldit kaloi te "Dimri". Kësaj here dukej sikur vinte nga dhoma ngjitur ose ndoshta nga një dhomë tjetër e shtëpisë, ku katër njerëz të tjerë po përpiqeshin të kuptonin se kush prej tyre ishte Montag dhe kush Kapulet.

Botim i ri nga Minerva

P. T. BARNUM

Arti i fitimit të parave ose rregullat e arta për të bërë para


Si të fitosh para dhe si të mos i humbasësh

Që prej botimit në shekullin XIX, "Arti i fitimit të parave" ka mbetur një nga udhëzuesit më të kthjellët, më praktikë dhe më të sigurtë për suksesin financiar. P. T. Barnum, mjeshtrë i marketingut, biznesmen i palodhur dhe një nga figurat më të njohura të Amerikës, distilon përvojën e tij në një seri parimesh të thjeshta, të drejtpërdrejta dhe të përgjithshme.

Ky libër nuk premtion pasuri të menjëhershme, por të mëson si të mendosh, si të veprosh, dhe si të ndërtosh një jetë ku sukcesi nuk është rastësi, por rezultat i disiplinës, ndershmërisë dhe zgjuarsisë praktike.

Me stilin e tij të drejtpërdrejtë, humorin e hollë dhe mençurinë praktike, Barnum të fton të shohësh paratë jo si qëllim, por si mjet për të ndërtuar një jetë më të mirë, më të lirë dhe më të qëndrueshme.

ARTI I FITIMIT TË PARAVE



ose rregullat e arta për të bërë para

P. T. Barnum

Minerva

1- Midis meje dhe teje ...

Nga bregu matanë ti nisje varka prej letre,
kujt ia dërgoje?

Nuk e mësova dot çfarë shkruaje
në trupin e tyre, nëse shkruaje,
pasi ngjarjet, dramet, ujërat, rrjedhin
me shpejtësi,
(as ndalen, as kthehen pas)
përplasen në shkëmbin,
që ngjajnë me dekor teatri surrealist.

Veç një ditë,
një ditë, njëra prej varkave ngeci
në shkurren si mjekra e dendur,
përhitur, venitur,
e babazotit që bridhte i vetëm,
si të thyente një rregull,
në lëndinat e kujtesës së humbur.

Notova shpejt, po varka ishte krejt pa formë,
(si kishin lotuar ëndrrat e fshehta aq
shumë?)
dhe shkronjat, ah ato që s'dalloheshin fare,
ngatëroheshin si rebus,
(ti kish shkruar diçka?)
më ngjanë me psalmet e mëdha.

Psalmet e dashurisë.

Nga bregu tjetër ti dërgon,
parreshtur dërgon,
(përse?) varka prej letre,
që vozisin, vozisin pandërprerë,
kush e di, në ç'lumenj, dete, oqeanë të tjerë,
pasi ujërat nuk i zë kurrë gjumi.

Midis meje dhe teje - lumi.

2- Qyteti im i tjetërsuar ...

Udhëtar,
që vjen nga dhera të largët e ngatërron
rrugët,
në mjegull balade ku përqafohen retë dhe
gurët.
E dallon shenjën e përhimtë në kanavacën e
vjetër,
pikturuar, vrimë - plumbi, nga qiell e botë
tjetër.
Pazarit arbëror, shiten fabula komike të
zbulimit të vetes,
disqe me këngë muezini, psalme, shami të
bardha, perçe.
Kalldrëmeve rrokullisen pengje, popla të
mëdhenj harrese,
të lagura, që shndrijnë papritur nga shira
pranvere.

Dhe ca histori mëkati, varen qiellit në balona
kotësish,
ngjyrë e verdhë aziatike, shkronja cirilike
sllave.
Në tavolina, djathin, mishin mjaltë të
Labërisë,
guzhinieri afgan e servir: si famë greke me
pajdhaqe ...

3- Mirënjohja nuk është më fjalë amtare ...

Mirënjohjet e vogla njerëzore,
kanë humbur. Thasët e drogës kanë nderim,
tituj qytetarie natyrisht.
Njeriu i djersës humbi, u trodh, doli jashtë
loje,
nuk ka më vend për të as zyrtarisht.

Mjerimi u zevëndësua me shpresa digitale,
të rrejshme, si kriptovalutat e tregut të zi.
Fjala trafik - uzurpoi gjithçka humane,
bën ligje atje në Tempull të Drejtësisë.

Një copëz hëne fshati, këngë a degë ulliri,
si t'ia shpiësh "mirëbërësit" tënd për dhuratë.
Duhën hotele, pallate e bizhu floriri,

ODISE KOTE**Midis meje
dhe teje***Poezi*

përndryshe: zhduku o qelbanik i ngratë.

Tani në vendin tim mbledhur, dhimbje -
galiç,
nga kancer hormonesh në tëmth e pankreas.
Mirënjohja - fjalë amtare, nuk është më hiç,
por veç mallkim fati që të ndjek nga pas.

4- Unë e di e dashur nënoke ...

Fëmijëria ime asnjëherë nuk e dëgjoi lutjen,
si t'i kishte marrë leje zotit:
"ulu në fund të trenit
aty je më i sigurt."

Endesha, luftoja në vijën e parë,
herë brinjëshqepur,
herë kokëçarë,
në realitetin që shpërblen maskën,
guxova të mbetësia fytyrë.

Po tren e lokomotivë nuk pashë askund,
rrethuar gjithnjë nga fantazma e gurë,
brenda çmimit të lirisë,
në qytetin ku magjia e andejshme,
rriëmben legjendat e këtejshme,
e rropullitet një pìrg i tërë pandehmash.

Unë e di e dashur nënoke,
pa ty, bota sakaq do të shkërmoqej.
Ti je e shtrenjta që ishe njëherë,
që je sot e do të vish dhe nesër,
për të më dhënë një shenjë,
për ndryshim në enët e gjakut,
sikur herë tjetër të më thuash kuptimin e saj
...

5 - HOMERI

Kur Zoti gjeti kohën e duhur të zbulonte
në bibliotekën shkruar të Trojës,
vargun "Këndo hyjneshë mërinë e Akil
Pelidit",
e kuptoi se zemërimi nuk ishte rrëmbimi i
Helenës,
po urrejtja për etninë tjetër.

Me Akilin shndërruar në syndrom,
frymëzim shkrimtari,
zotat ia përdhosën me ngazëllim
kufomën Hektorit.

Zhburrërruan mbretin Priam,
neveritshëm e detyruan të shkojë
e t'i puthë këmbët vrasësit të të birit.

Troja u digj, u shkatërrua,
sepse keshtu deshi Homeri,
(medet historia është gjithnjë me të fortin).

Gjithçka e çnderuar.
Neoptolemi kap për flokësh plakun Priam
dhe ia hedh kokën e prerë,
në pellgun e gjakut.

Zoti nuk e duroi dot më blasfeminë,
(sigurisht me vonesë të paspjegueshme)
urdhëroi siç urdhëron ai, po ato zota,
të verbonin Homerin,
për t'ia dhuruar verbimin
kohëve të ardhme,
pas-post-modernizmit,
me dronë e inteligjencë artificiale.

6- Më kërk!

Më kërk dhe shpejt, bëhem lundërtar,
në çdo det, stuhi, vozitës guximtar.

Le të jesh mbështjellë me erë e shtrëngatë,
jam brenda stuhisë, ardhur nga shumë larg.

Të mos ketë as hënë, dritë e orientim,
nuk humb nëpër shtjella, në asnjë qortim.

Nuk humb në shtegtim, qiellit mes reve,
era do më shtyjë a krahët e lejlekëve?

Hyjnore është varka, shpirtin ma përflak,
poshtë harkut ylber zbret ngadalë një ag.

Premtim ëngjëlltar, unazë rri në gisht,
det i egër shumë, hiri i dhimbjes trisht.

Më kërk dhe dashur do jem lundërtar,
ëndrrash bredharake, vozitës guximtar.

7- Fati im dhe fati yt ...

Fati im qëndron duarkryq duke pritur të
rrembehët.
I kanë thënë, vish këmishë të kuqe në ngjy-
rën e gjakut

dhe prit dronët, ndërsa një prift lutet çdo
minutë,
në kishën çatishqyer si gojë ujku.

Pendohet që nuk ka bërë ato që do kishte
dashur,
intimitetet që ka anashkaluar, çastet në
nxitim,
një vajzë e paputhur, romanin e pashkruar,
duke pritur, duke pritur, pa asnjë kuptim.

Ia kanë sulmuar ëndrrat, udhëtimet, porto-
folin,
para se të shpërthejnë pusët, të mbyllet
Hormuzi.
Diçka s'ka shkruar, perandori perse o pe-
randori Kir,
si një këmbë e thyer e pangjitur siç duhet.

I duhet të bëjë paqe me rrënojat, të paprit-
urat,
teatrin e luftës, mënyrën e gabuar të mend-
mit.
Mësimet e pakuptuara që indiferenca i fsheh,
vuajtja nuk është armik, por disi mësonjës.

Fati im qëndron duarkryq duke pritur të
rrembehët.
I kanë thënë, vish këmishë të kuqe në ngjy-
rën e gjakut
dhe prit dronët, ndërsa një prift lutet çdo
minutë,
në kishën çatishqyer si gojë ujku.

8- Ti duhet të ikësh ...

Ti duhet të ikësh,
thjesht ik sa më parë,
klithin pasionet e ndaluara
në zemrën prej mermeri.

Të iki? Po ku të shkoj?

Ik ku të duash, veç ik.
Mer me vete vetëm kitarën,
dhe një ëndërr si kujtim,
je thjesht shpenzim.

S'ka vend për fjalën,
lakuriqët e natës
e urrejnë dritën.

Ik.

Ti duhet doemos të ikësh,
tani nuk je as iluzion,
bota digjet nga zjarri,

që përvëlton dhe foletë
e milingonave.

Të iki? Po kush më qas?

Në aeroporte, trena, tramvaj,
je më i shëmtuar se Ezopi,
parathotë pasqyra,
talent, punë, skandal.

Ik.

Leri gjithë gjërat e zbuluara
nga çastet dhe ik.

Ka gjithnjë një kohë për të ikur,
dhe sikur llava,
rrugës të të mbërrijë ...

9 - Je hiri magjik ...

Trupat preken, ç'rrokullisje e pjerrët,
avuj pengjesh që digjen në zjarr.
Ti puth si e çmendur, je mahnitje e freskët,
shkrumbim universi nën lëkurën e bardhë.

Ti nuk je kurrsesi si baladat e gjata,
me hollësi folklorike e një fund të trishtë.
Që mbështjell me harresë, stinët, mallin,
në varrin e thjeshtë, nën një qiparis.

Je hiri magjik ku fletë dhe zgjohen,
pasionet fillestare dhe mëkati i vjetër.
Milionat balerina, ç'muzikë pikëlore,
zbret nga qielli, nga ajo bota tjetër.

10- Rrëmbehen pas ca gjërave të çuditshme ...

Sytë e mi rrëmbehen pas ca gjërave
të çuditshme.
Sapo kaluan një histori tornado
që ndryshoi të gjitha planet.

Shkuan pas zogjve Kagaro,

dhe pas ca pelikanëve
që fluturonin mbi oqeanet.

Pastaj u rrëmbyen nga ca gjëra të tjera,
jetuan të etura histori të reja,
dashuri të pamundura më parë,
jo aventura kot së koti.

Ankoruar tek horizonti
më shumë se thellësitë,
tek liria më shumë se horizonti.

Të tjera histori si dallgë përplasen
tek jeta ime trysni, rrëmujë,
që s'shmanget dot kurrë,
po të ndjek nga pas si shtizë.

Dhe zbulojnë inverse kundërthënëse:
„Roma ishte ëndërr e një plaku,
Augusti grabitqari më i pasur,
Iran - Persia, qendër e botës,
kërthizë?”

Sytë e mi çdo sekondë rrëmbehen
pas ca gjërave të çuditshme.

Përshembëll: pas një kërcelli të njomë
që shpërtheu blerim - rrëpirës,
ku rrëkeza e nëndheshme sapo nisi.

Lutem çdo mëngjes dhe bekoj sytë e mi:
Mos vdisni!

11- EH, EHU ...

Të hënë i krishterë,
të martë mysliman.
Të mërkurë i lodhur,
Djall e puritan.

Të enjten përzier,
Judë e Jehovah,
Bektashi të premte,
serbes për pazar.

Të shtunën gjith' dita,
çorodi e madhe,
tallava dhe cica,
helme dhe maraze.

Të dielën në meshë,
rrëfim për mëkate,
pastaj në xhami,
hallvë e tarikate.

Të hënë sërish,
histori e vjetër.
Hyr nga njëra derë,
dil nga dera tjetër ...

12- O zot ç'krijësë që paske shpikur.

Sa çelte manushaqe e borës,
atje në shkëmb të plasaritur.
Në vrap drejt teje fluturoja,
O zot ç'krijësë që paske shpikur.

Pa gurgullonte çurg rrëkeza,
blerim në tokën e stolisur.
Në ëndje lulësh të kërkjoja,
O zot ç'krijësë që paske shpikur.

Dhe iknim larg nëpër dredhore,
ku pret dëshira e panisur.
Gjithçka rreth teje princërore,
O zot ç'krijësë që paske shpikur.

Nuk kish me ty as aeroporte,
as udhëkryqe të bezdisur.
Sinjalistikë veç zemra jote,
O zot ç'krijësë që paske shpikur.

Ka qindra vjet kjo bredharake,
kjo hënë e plotë e prushëritur.
Më zgjon, me gjak të ri ndër deje,
O zot ç'krijësë që paske shpikur.

13- Të shohësh yjet në janar...

Të shohësh yjet në janar është si të udhëtosh
në kohë,
prej fobisë së fluturimit me avion, ti ende s'je
shëruar.

Mbështillesh në krahët e mi dhe unë të
pëshpëris,
tragjeditë janë për ata, të dehurit nga humb-
jet e veta.

Ti përpiqesh të kuptosh sa të dua, dhe ky
ekuacion,
është si të kuptosh madhësinë e universit.

Muzika endet mbi re, si e bërë me kokriza
dëbore.
Kitarë duhet të jetë fryma ose era e detit që
vjen prej larg.

Eja të bëjmë një vizatim të bukur me ato
shenjat tona,
histori dhimbjesh pasi gjërat mësohen duke
gabuar.

Çmimi i heshtjes, është si të fërkosh sytë e
mendjes,
të bëhesh gati, t'i vërtetosh vetes se ti mjaft-
ton.

Ajo vija ndarëse ku mendimet mbërrijnë të
qarta, ti e di,
vjen si gëzim i ngrohtë kur piloti guximtar
shkel tokën...

Të shohësh yjet në janar është si të udhëtosh
në kohë,
kjo është grua, e kupton o pema yllësore e
qumështit?

Rikthehet sa herë ndihet fillikate, me dënese
e qeshje,
se dashuria e vërtetë është përlogaritje e
ndërlikuar...

14- ÇUPËZ E PËRMETIT

Çupëz e Përmetit ç't'i vërvita sytë,
molla që kafshoja më mbeti në grykë!

Çupëz e Përmetit, faqekeqe - shega,
veshur me petale, trëndafil me dega.

Çupëz e Përmetit, re rozë në maja,
shenja që më bëre, më mbajti mos qaja.

Çupëz e Përmetit, nga syri më humbi,
duke rënë prapa tek rend nga rend lumi.

Çupëz e Përmetit, mallin dot s'ta sosa,
I ziu në Vjosë rashë dhe u fundosa...

Tek ty na rri syri ngado që të vemi,
O Përmeti i çupës, si Jeruzalem!

Besa Kalaja

Kati i tretë

Tregim

Qëndroja drejt, me sytë te dera
metalike që reflektonte një version
të zbehtë të fytyrës sime. Ashensori po
vonohej shumë. Dikush e kishte thirrur
në katin e tretë dhe aty po qëndronte prej
minutash. E dija atë ndalesë, më ishte
ngulitur në kokë që aty do të ndalej.

Mendova se, kur të vinte radha ime,
do të ishte i mbushur. Nuk di të qëndroj
me shumë njerëz në ashensor, më zihet
fryma. Përshëndetja me bezdis dhe
bisedat e vogla pa kuptim ma mendojnë
shpirtin.

Kur më në fund erdhi, dera u hap me
zhurmën që t'i gërryen veshët.

Brenda nuk ishte askush.

U ndala për një çast, prisja që
dikush të dilte me vonesë nga një cep i
padukshëm. Asgjë. Vetëm drita e butonit
të katit të tretë që qëndronte ende
ndezur.

Hyra.

Shtypa butonin për në katin e fundit.
Për një çast u ndez sërish treshi. Mendova
se ishte gabim, një lojë fëmijësh, ndoshta.
Ashensori u ndal përsëri në katin e tretë.

Dera u hap.

Korridorin ishte bosh.

Qetësi e pazakontë, sikur aty të mos
kishte jetuar kurrë njeri. Asnjë zë, asnjë
lëvizje. Vetëm një ndjenjë se dikush po
më qëndronte mbrapa.

Nuk u ktheva.

.....

Nëna më tha një ditë se unë kurrë nuk
isha frikësuar nga asgjë.

Desha t'i thosha që gjërat kishin
ndryshuar, nuk e bëra. Lava enët me ngut
dhe i dhashë një buzëqeshje të shtirur.

“Ti ke ndryshuar shumë” - tha ajo.

Nuk e pyeta si e dinte. E dija që do
t'më jepte një përgjigje me takt të cilën
unë se honeps dot.

Ajo u afrua po merrte frymë te krahu
im.

“Do të të ndihmoj”, -më tha.

Afërsia e saj më shqetësoi shumë.
Raporti ynë s'e duronte këtë afërsi.

U mbështeta për një çast në krahët
e saj dhe qava. Jo shumë. Aq sa për të
mos u dukur që nuk shqetësohesha nga
kujdesi i saj.

Kati i tretë?- më pyeti.

Si e dinte, nuk e kisha përmendur
kurrë.

Çka, kati i tretë e pyeta.

Ai ka qenë gjithmonë problematik,
më tha pa më dhënë shumë detaje.

.....

E takova pranë shkallëve.

“Kam kohë që po të pres” - më tha.

Era e tij më goditi menjëherë e rëndë,
nuk ishte larë prej ditësh.



“Në katin e tretë?” - e pyeta.

Pohoi me kokë.

Tha se kishte improvizuar një shtrat,
se nuk ishte rastësi që ishte aty. Tha
shumë gjëra që nuk më bindën, por as
nuk më lanë të largohesha. Nuk pashë
asnjë ndryshim as në sjellje, as në
qëndrime, vetëm fytyra që i ishte plakur
më shumë se sa vitet e tij. Energjinë s'ia
kam duruar kurrë dhe në të gjitha rastet
jam munduar të largohem prej tij. Çfarë
rastësie që ta takoja prapë dhe atë në
banesën ku unë jetoj.

Ndjeva që trupi po më djersitej nga
mundimi kur më kapi për krahu.

Forca e tij ishte e papritur.

“Duhet t'i biesh ziles së kësaj dera”,
më tha.

Nga shenjat para derës banesa dukej
e braktisur. Megjithatë, e bëra.

Asnjë përgjigje.

“E sheh këtu nuk jeton askush” - i
thashë.

Nuk foli, goditi derën me grusht.

Dera u hap. Nga errësira doli një
fytyrë, e zbehtë, e thatë, pothuajse pa
jetë.

M'u deshën disa sekonda për ta
njohur.

Një shok i vjetër.

Sytë i ndriçuan kur më pa. Si të kishte
pritur gjatë për këtë moment, pa e ditur
pse.

Ata filluan të grindeshin menjëherë.
Bënin fjalë për bashkëjetesë, për fëmijë,
për një grua tjetër, për para. Biseda më
vinte shkëputur, asgjë nuk po merrja
vesh.

Hyra mes tyre për t'i ndarë. Një e
gjallë mes dy të vdekurish.

Një dorë më kapi për beli.

“Ka ngecur koha për ty”, më pyeti.
Buzëqeshi.

“Jo koha nuk ka qenë e mirë as me
mua”, -ia ktheva.

Ia bëra të qartë që po largohesha se
kisha punë të tjera. Do të takohemi i
premtova.

Kur u largova, ashensori po vonohej
përsëri.

Këtë herë nuk u ankova.

Dera u hap, hyra menjëherë. Brenda
ashensorit një xham i thyer, njolla kafeje,
një pako cigaresh në dysheme. Dhe në
pasqyrë, një fytyrë që nuk e dija më e kujt
ishte.

U ndala në katin tim.

Çelësi më dridhej në dorë. Edhe një
rrotullim dhe gjithçka do të mbaronte.
Kur futa çelësin në bravë, një dorë e
nxehtë më kapi

“Ku the se po shkon?”

“Në katin e tretë”.

LIGJËRATË PËR
QUMSHËTIN E DERDHUR

I.

1.

Në Krishtlindje erdha me xhepa të tharë.¹
Botuesi romanin po ma shpie zvarrë.²
Kurani moleps në Moskë çdo kalendar.³
Nuk mund të ngrihem të shkoj në gosti,
as tek miku im, që i qajnë fëmija,
as tek vajz' e njohur, as tek shtëpia.
Duhet ngado paratë e mia.⁴
Rri në karrige, dridhem në mëri.⁵

2.

Ah, o zanat i mallkuar poeti.⁶
Telefoni hesht, - dieta më mbeti.
Mund të marr borxh nga Komiteti,⁷
por kjo është si të hysh borxh te një grua.
T' humbësh pavarësinë është më zi⁸
se t' humbësh pafajësinë. Gjithsesi,
t' ndërrosh për burrin është kënaqësi,
ka hije të thuash: erdh koha për mua».⁹

3.

Duke ditur statusin, e fejuara ime
për pesë vjet - s' lëviz një thërrime;¹⁰
se ku bëhet tash, s' di të jap sqarime:
t' i nxjerrë të vërtetën, as djalli nuk di.¹¹
Ajo thotë: "mos bjer në dëshpërim.
Kryesorja - ndjenjat! Jemi unanimit?"¹²
Tingëllon bukur nga ky këndvështrim.
Por ajo, me ç' duket, është atje ku pi.¹³

¹ Krishtlindja me "xhepat bosh" (kontrasti sakrale-profane). Poema nis me një paradoks të dhimbshëm. Krishtlindja është koha e bollëkut, e dhuratave dhe e bashkimit. Por për poetin, kjo festë vjen me "xhepa të tharë". Ky detaj nuk tregon vetëm varfëri, por një zhveshje totale. Ai është i përjashtuar nga gëzimi kolektiv.

² Tregon varësinë e krijesit nga sistemi. Nuk është thjesht çështje parash, por çështje vlerë. Romani i tij (jeta e tij, puna e tij) është peng i dikujt tjetër. Kjo krijon ndjenjën e ngecjes në vend.

³ Nuk është sulm ndaj fesë islame, por një metaforë për "ndryshimin e gjakut" të qytetit. Moskë po humbet identitetin e saj evropian/kristian dhe po kthehet në diçka tjetër (një lloj orienti të vrazhdë). Për Brodskin, kjo është shenjë e dekompozimit të rendit të vjetër.

⁴ Këtu paraqitja nuk është luks, është "karburant" i socializimit. Pa të, njeriu pushon së qeni qenie shoqërore.

⁵ Strofa mbyllet me imazhin e poetit të gozhdur mbi karrige duke u dridhur nga zemërimi: është pika zero e poemës, nga ku nis i gjithë monologu i tij i brendshëm.

⁶ Mallkimi i Zejes: "Ah, o zanat i mallkuar poeti!". Brodski e sheh poezinë jo si lavdi, po si një rrugë që të çon në izolim (telefoni që hesht) dhe uri (dieta e detyruar).

⁷ Mundësia për të kërkuar ndihmë në "Mestkom" (komiteti i lagjes/sindikata) shihet si poshtërim. Krahasimi me "borxhin te gruaja" shpjegon kodin e vjetër të nderit: të lypësh te sistemi (apo te një grua, sipas mendësisë së kohës) do të thotë të dorëzosh burrërinë dhe lirinë.

⁸ Për Brodskin, të humbasësh pavarësinë (të bëhesh i varur nga dikush) është më e rëndë se humbja e pafajësisë. Virgjëria humbet një herë, por pavarësia e humbur të kthen në skllav përjetë.

⁹ Është këndshëm të ndërrosh për një "burrë" (një mbrojtës/strehë) dhe të thuash "erdhi koha", por për poetin kjo "strehë" është thjesht një burg tjetër që vret lirinë e tij të egër. Poeti zgjedh dietën dhe heshtjen përpara nënshtrimit, duke e parë varësinë si vdekjen e vërtetë të krijesit.

¹⁰ Statusi i poetit si "i tepërt" dhe pa perspektivë e ka ngrirë marrëdhënien. Dashuria këtu nuk është lëvizje, por një amulli pesëvjeçare.

¹¹ Izolimi i poetit është aq i thellë, saqë ai ka humbur jo vetëm shoqërinë, por edhe fillin e njeriut më të afërt. E vërteta është bërë e paarrtshme, as drejt s' e nxjerr dot.

¹² Klisheja e ndjenjës: vajza përdor retorikën boshe: "Rëndësi kanë ndjenjat!". Kjo është ironia e Brodskit ndaj idealizmit fallco. Ajo ofron "ndjenjën" si zëvendësues për praninë, një lloj "dakordësie unanime" që ngjan më shumë me një mbledhje partie sesa me dashuri.

¹³ Ndërsa ajo flet për "shenjtërinë e ndjenjave", në fakt ndodhet aty ku ka argëtim, ku ka pije, ku jeta rrjedh pa mundimin e varfërisë së poetit. Ajo zgjedh pragmatizmin e jetës përballë sakrificës së dashurisë. Shkurt: tradhtia e "pambuktë". Vajza e braktis poetin jo me zhuvmë, por me fjalë të bukura, duke zgjedhur komoditetin e pijes përballë shkretëtirës së statusit të tij.

JOSIF BRODSKI
(1940 – 1996)Ligjëratë
për
qumështin
e derdhur

Përktheu nga origjinali
dhe pajisi me komente:
AGRON TUFA

Fuqia e talentit letrar të Josif Brodskit mund të shqyrtohet në shumë rrafshje. Në dritën e realiteteve të sotme, zgjedhja ime ra mbi këtë poemë si mbi një shëmbëlltore profetike dhe një reflektim filozofik mbi kohën, përjetësinë dhe vetveten.

Poema "Ligjëratë për qumështin e derdhur" u shkrua nga Josif Aleksandroviç Brodski në janar të vitit 1967, pak kohë pas kthimit të tij nga internimi në rajonin e Arhangelskut.

Ky cikël prej 40 oktavash përbën një spirale depërtuese ndjenjash të ndrydhura, që derdhen mbi shpirtin e një heroi njëherësh tragjik dhe ironik. Një poet marginal, i braktisur nga e fejuara, pa para, por që mbi gjithçka çmon pavarësinë e vet; një njeri në kërkim të vetëpërsosjes së përhershme, i vetmuar në epokën e Terrorit të Madh, me vetëdijen e përgjigjes përpara Gjykatës së Fundme.

Kjo është historia e humbjeve të shumta për të cilat, me sa duket, nuk ia vlen të vajtohet. Në sfond të titullit qëndron proverbi anglez: "Nuk ka kuptim të qash për qumështin e derdhur". Por Brodski bën pikërisht të kundërtën: ai mban një ligjëratë të gjatë mbi atë që është derdhur. Bota është e papërsosur, por e brishtë; ajo që është bërë, është bërë. Njeriut i mbetet të ruajë vetveten dhe të ecë përpara.

Mbyllja e poemës lë të hapur një shpresë të heshtur për ndryshim: në trajtën e një vajze të vogël dhe të fshikakuqit (euonymus-it) që lulëzon, simbol i vijmësisë krijuese dhe i një krenarie të fituar jo prej detyrimit apo moralizimit, por prej një shërbimi të painteres ndaj artit.

Lexuesit i uroj një zhytje të kujdesshme dhe të gjallë në hapësirën e kësaj poeme.

4

Përgjithësisht të afërmit i shoh me mosbesim.¹⁴

Fyej kuzhinën me të tepërtin - barkun tim.¹⁵

Përveçse i bezdis me timin këndvështrim¹⁶ mbi njeriun që në jetë ka një rol.

Ata mua më konsiderojnë bandit,¹⁷ ata tallen me timin apetit.

Nuk gëzoj ndër ta asnjë kredit.
"Hidhini atij pak më të hollë!"¹⁸

¹⁴ Mosbesimi si Mburojë: kjo nuk është mizantropi e thjeshtë, por një instinkt mbrojtës. Në një botë ku fqinji është spiu dhe shoqëria është syri i shtetit, mosbesimi është kushti i vetëm i mbijetesës së shpirtit.

¹⁵ Poeti e quan stomakun e tij "të tepërt". Duke mos qenë "punëtor krahu" apo pjesë e zinxhirit prodhues, vetë ekzistenca e tij biologjike (të ngrënit në kuzhinë) shihet nga të tjerët si një vjedhje ose fyerje ndaj kolektivit.

¹⁶ Ai nuk i bezdis njerëzit me zhuvmë, por me mendimin e tij unik mbi njeriun. Në një sistem që kërkon uniformitet, të kesh një "vështrim personal" është akti më i lartë i rebelimit.

¹⁷ Për shoqërinë, kush nuk punon sipas normës është "bandit". Tallja me oreksin e tij dhe refuzimi i "kreditit" (besimit) tregojnë izolimin total ekonomik dhe moral.

¹⁸ Kjo është kuintesenca e ligësisë njerëzore. Hakmarrja e vegjëlisë ndaj mendjes së madhe bëhet te

5

E këqyr në qelq veten time beqar.¹⁹

Një fakt të thjeshtë vesh s'po e marr:
gjer në Krishtlindje vallë si kam çarë
të vitit nëntëqind e gjashtëdhjetë e
shtatë.²⁰

Njëzet e gjashtë vite pa sosje - tronditje,²¹ rrënim nëpër xhepa, zvarritje në gjyqe,

pjata: t'ia hollojmë supën, t'ia pakësojmë jetën, ta lemë të uritur që të ulet në gjunjë. Konflikti i papajtuashëm mes "Mendimit Vetjak" dhe "Gjellës Kolektive". Poeti pranon të jetë i uritur dhe i përbuzur, mjafton që të mos dorëzojë këndvështrimin e tij mbi botën.

¹⁹ Pasqyrimi (ne xhamin e dritares ose të dollapit) është i ftohtë. Ai nuk sheh një burrë në kulmin e moshës, por një qenie të mbetur fillikat, një "fakt" që as ai vetë nuk e rrok dot.

²⁰ Mbijetesa si Habi: habia e tij se si arriti deri në Krishtlindjen e vitit 1967 nuk është festim, por dëshmi e një lodhjeje epike. Viti në origjinal përmendet me të gjitha shifrat (1967) për t'i dhënë rëndësi kohës që ka rrjedhur si rërë mes gishtave.

²¹ Kjo është kuintesenca e biografisë së tij. Jeta nuk përshkruhet me arritje, por me tronditje: pasiguri, ankth i përhershëm. Rrërimi në xhepa: varfëria kronike. Tersllëku gjyqësor: persekutimi (kujtojmë procesin e famshëm të Brodskit dhe dënimin si "parazit").

ushtrim sa për sy e faqe me Ligje,
të shtiresh vuv i ngratë.²²

6

Përreth si në vaj jeta shkon - vijë.²³
(Nënkupto masën, gjithsesi).
Marksi shfaqësohet. Por, sipas tij,
prej kohësh duhej të më kishin therë.²⁴
S' e di në dobi të kujt është' kjo saldo²⁵.
Ekzistenca ime është paradoksale.
Unë nga epoka po bëj një salto.²⁶
Më ndjeni për gjallërinë e prerë!²⁷

7

Pra, të gjitha arsyet me qenë i qetë.
Më askush "Mbi kuaj!"²⁸ nuk bërtet.
Fisnikët u zhinë me rrënjë e degë.
S' ke as Pugaçov²⁹, as Stjenkë³⁰.
Pallat' i Dimrit³¹ ra, sipas legjende.
Xhugashvili³² ruhet në kuti konserve.
Hesht artileria sipër kuverte.³³
Në kaploqen time - veçse lekë.

8

Ndër kasaforta, banka, fshihen paratë,
në trarë tavani, dysHEME, çorapë,
në formularë poste, në kasa antiflakë.
Përmbytja e natyrës vjen.
Shushurijnë tufat fringo të
kartëmonedhave,
si majat e akacieve, mështeknave.
Jam përpjërë prej haluçinacioneve.
Jepmëni pak oksigjen!

9

Fërfëllimë flokëboresh. Natë.
Qetë gërvisht kalldrëmin një lopatë.
Karshi, te dritarja, digjet një lampadë.
Mbi një sustë çeliku strukon.
Shoh veç lampadën. Pa ikonë:
atë s' e shoh. Avitem në ballkon.
Mbi çati velenxën bora shtron,
dhe shtëpitë si të huaja duken.

²² Për të mbijetuar, poeti është detyruar të bëjë lojën e sistemit: "t' i hedhë hi syve Ligjit" (të flirtojë me autoritetin për të shpëtuar lëkurën) dhe të bëjë si i memec. Një poet që luan memecin është imazhi suprem i dhunës shpirtërore. Shkurt: një autoportret i dërrmuar. Në moshën 26-vjeçare, poeti ndjen se ka harxhuar energjinë e një jete të tërë thjesht duke u fshehur, duke lypur nëpër xhepa dhe duke heshtur përballë gjykatësve.

²³ Shprehja "jeta shket vaj..." këtu përhapet një helm i hollë. Ai sqaron menjëherë: "nënkupto masën". Për masën kolektive, jeta rrjedh pa probleme, sipas planit, por për individin, ky "vaj" është helmi ku po mbytet.

²⁴ Marksi si Gjykatës: Brodski bën një lojë brilante me teorinë e vlerës. Sipas ligjeve të Marksit, një njeri si ai, që nuk prodhon mallra materiale, është një "parazit" që duhet eliminuar ("duhej therur"). Ai e pranon se, në syrin e ideologjisë, ekzistenca e tij është një gabim llogaritës.

²⁵ Duke përdorur terma kontabël (saldo), ai tregon absurditetin e jetës së tij. Ai nuk e di nëse është në "humbje" apo në "fitim", sepse ekzistenca e tij nuk matet dot me kutin e sistemit. Ai është një mbetje jashtë bilancit zyrtar.

²⁶ I gjendur para murit të epokës, poeti nuk e godet atë, por bën një "salto" mbi të. Është akti i artistit që kapërcen kohën përmes hirit dhe shkathtësisë mendore.

²⁷ Është një tallje finale: kërkon falje që është ende gjallë, që lëviz dhe që guxon të jetë i shkathët në një kohë që është e rëndë dhe e palëvizshme si guri. Shkurt: përplasja mes Logjikës së Masës dhe Lirisë së Individit. Poeti e pranon se sipas "librave" ai nuk duhet të ekzistonte, ndaj e vetmja rrugëdalje është ta kthejë mbijetesën në një akt akrobatik, një salto që e nxjerr jashtë historisë zyrtare.

²⁸ "Mbi kuaj!": Thirrja e famshme e luftës civile, e heroizuar në filmat sovjetikë.

²⁹ Jemeljan Pugaçov - udhëheqës i kryengritjes fshatare kundër Perandorisë Ruse (shek. XVIII), simbol i revoltës popullore kundër pushtetit carist.

³⁰ Stepan Razini - Stenka Razin — prijës kozak i kryengritjes së madhe anticariste në shek. XVII, figurë mitike e rebelimit popullor rus.

³¹ "Pallati i Dimrit" - rezidenca perandorake në Shën Petërburg, e marrë nga bolshevikët gjatë Revolucionit të Tetorit (1917).

³² "Xhugashvili" - Josif Visarionoviç, emri origjinal i Stalinit; këtu aludim për figurën e tij të ruajtur/"konservuar" në kujtesën historike sovjetike.

³³ Aludim për kryqëzimin "Aurora" dhe sinjalin e tij simbolik gjatë Revolucionit të Tetorit, që shënon fillimin e sulmit mbi Pallatin e Dimrit. ...Dhe që tani hesht.

II.

10.

Barazia, vëlla, përjashton vëllazërinë.³⁴
Për këtë duhet interpretim.
Skllavëria gjithnjë lind skllavërinë.
I vjen në ndihmë dhe revolucionit.
Kapitalisti mbarështrou komunistët.
Komunistët u shndërruan ministra.
Këta të fundit pjellin morfinistët.
Çfarë shkruan Luci³⁵, lexoni.

11.

Peshku i artë nuk na vjen në breg.³⁶
Marksi në prodhim - as djeg e as pjek.³⁷
Puna nuk është mall për treg.
Po e the këtë - punëtorët fyen.
Puna është qëllim i qenies dhe forma.
Paraja, si me thënë, është platforma.³⁸
Diç më përtej se e mbijetesës norma.
Le ta shpëstjellim nyjen.

12.

Sendet janë më shumë se ç'kanë vlerën.
Ekonomia tash thjesht përbën qendrën.
Në vend të kishës - na lidh me veten³⁹,
na shpjegon aktet dhe mundin.
Përgjithësisht, çdo njësi me peshë
në thelb të vet është virgjereshë.⁴⁰
Ajo dëshiron me u përngjeshë.
Pantallonat lypin fundin.⁴¹

13.

Topi synon gropën sipas qëllimit.⁴²
(Ndoshta, po lodh Muzën përtej durimit).⁴³
Jo Konkurrencës, por Bashkimit⁴⁴
e ardhmja e bukur i takon.
(Të bëj profetin - nuk gjakoj asfare.)
Ka shumë mundësi që këto vargje
t'i shkurtojnë të pritjes afate;
"Një vit për dy numëron".⁴⁵

14.

Ora ra, dhe erdh' koha që s'fal
për lidhjen martesore Punë - Kapital.⁴⁶
Shkëlqimi i të përçmuarit metal
(më tej - paraqitje në fytyra) -

³⁴ Një goditje direkte sloganit të Revolucionit Francez. Për Brodskin, ku ka barazi mekanike, nuk mund të ketë lidhje shpirtërore.

³⁵ Luci (Lucius): Ky është një emër i rëndomtë romak. Mund të jetë Lucius Annaeus Seneca (që shkroi mbi moralin dhe tiraninë) ose Lucius Apuleius. Brodski gjithmonë thërret antikitetin për të dëshmuar se asgjë nuk ka ndryshuar në natyrën njerëzore.

³⁶ Referencë nga përralla e famshme ruse mbi peshkun e artë. Poeti na thotë: te ne nuk vjen peshku i artë që t'i plotësojë dëshirat qyl. Këtu jemi në realitetin e vrazhdë.

³⁷ Në origjinal është një shprehje idiomatike ruse ("Ne vjazzhet lyka", - nuk lidh dot një gjalmë), që në shqip i jemi përgjigjur po me idiomë.

³⁸ Kjo është tallja e epërme. Sipas dogmës komuniste, puna nuk është mall (si në kapitalizëm), por është vetë "forma e qenies". Brodski e merr këtë slogan dhe e kthen përmby: "Nëse puna është forma, atëherë paraja është thjesht një platformë".

³⁹ Ekonomia si Kishë: Ky është një konstatim i ftohtë. Në vend të fesë, sot na bashkon interesi, paraja, këmbimi. Ajo na "shpjegon" pse bëjmë atë që bëjmë. Sendi është më shumë se çmimi: Një send ka një shpirt, një ekzistencë që e tejkalon vlerën monetare.

⁴⁰ Çdo njësi është "vjazë e virgjër" (djevica): Këtu Brodski bëhet lojçak. Ai thotë se çdo mall, çdo send, ka dëshirën "femërore" për t'u bashkuar me diçka tjetër.

⁴¹ Pas gjithë atij diskutimi për Marksian dhe vlerën, gjithçka përfundon te një imazh i thjeshtë, njerëzor dhe komik: pantallonat që lypin fundin.

⁴² Topi dhe vrimëza: Si në bilardo. Gjërat shkojnë aty ku e kanë vendin. Është një lloj fataliteti.

⁴³ Poeti e pranon se po e "përdhunon" pak poezinë duke futur brenda terma ekonomikë e politikë.

⁴⁴ Konkurrenca vs Bashkimi: Kjo është ironia supreme. "E ardhmja nuk i përket Konkurrencës (Kapitalizmit), por Bashkimit (Sovjetik)". Poeti luan me emrat e sistemeve.

⁴⁵ Ky është zhargoni i kampeve të punës (GULAG). Për punë të rënda ose sjellje "të keqe", vitet e dënimit llogariteshin ndryshe. Ai e di që kjo "Ligjëratë" do t'i kushtojë shtrenjtë..

⁴⁶ Martesa e Punës me Kapitalin: Ky është sarkazmi i tij mbi fundin e historisë. Ora ra dhe këta dy armiq "të përjetshëm" duhet të martohen.

është më i këndshëm se boshi në xhepa,⁴⁷
më i thjeshtë se rrokopuja e tiranëve,⁴⁸
më i mirë se qytetërimi i narkomanëve,⁴⁹
shoqëri e rritur mbi shiringa.

15.

Mëkatin fillestar s'e ka thelb jetimësia.⁵⁰
Për shumëkënd është më e dashur
shtazëria.⁵¹
Më lehtë gjendet dallimi sesa ngjashmëria.
"Mes Punës e Kapitalit kontakt s'u gjet".⁵²
T'fu-t'fu, në Islam nuk u rritëm.
Mjaft dërdëllitëm për ndarjen përgjysëm.⁵³
Ekziston mes gjinive ngashënjimi.
Polet e krijojnë një planet.⁵⁴

16.

Si beqar, kam trishtime martesore.⁵⁵
S'pres, merret vesh, mrekulli në gaforre.⁵⁶
Familja ka gropa e zgafilella prora.
Por bashkëshortët janë - i vetmi tip
pronari⁵⁷
të asaj që krijojnë në kënaqësi.
S'ka nevojë t'u thuhet "Mos bëj hajni".⁵⁸
Ndryshe, do të dilnim të gjithë për lypësi.⁵⁹
Ruani foshnjat së pari.⁶⁰

17.

Kjo, si poet, m'është e huaj tani.
Madje: di që "hakun e vet çdo njeri....".⁶¹
Shkruaj dhe rrëqethem: ja ç'marrëzi,
mos qenkam kundër pushtetit legjitim?⁶²
Nëse s'kanë të drejtë, koha na shpëton.
Kjo famë skandaloze mua më mjafton.
Por politika qelb çdo zakon.
Është kjo, që tash në pjesë na hyn.⁶³

18.

Paratë të ngjashme janë me virtut.⁶⁴
S'bien nga lart — Allahun shahit —⁶⁵
Paratë flatrojnë n'erë përditë
jo më keq se fjala e nderit.⁶⁶

⁴⁷ Shkëlqimi i metalit të përbuzur: poeti përdor klishe sovjetike "metali i përbuzur" (për paranë), por thotë se shkëlqimi i tij është më i mirë se xhepat bosh.

⁴⁸ Një imazh i fuqishëm i diktatorëve që ndërrojnë vendet me njëri-tjetrin si në lojërat e fëmijëve, duke lënë pas vetëm rrënoje.

⁴⁹ Brodski parandien një botë që, në mungesë të lirisë ekonomike dhe shpirtërore, përfundon te shiringa (si drogë fizike ose ideologjike).

⁵⁰ Mëkati i Zanafillës: Nuk është një lloj si të jesh jetim. Poeti po thotë se ne jemi "fajtorë" që në nisje, nuk jemi thjesht viktimë të rrethanave.

⁵¹ Shtazëria: një fjalë e rëndë. Poeti thotë se shumë njerëzve u pëlqen të jetojnë si kafshë, pa menduar, pa zgjedhur, mjafton t'u japësh "tagjinë".

⁵² Refuzimi i kontaktit: Poeti citon sloganin marksist "Puna dhe Kapitali nuk kanë kontakt" vetëm për t'u tallur me të.

⁵³ Islami dhe "përgjysma": Këtu ai ironizon barazinë absolute (përpjesëtimin). "Të mos lllapim më për përgjysmën" (ndarjen përgjysëm).

⁵⁴ Polet krijojnë planetin: Kjo është mbyllja gjeniale. Konflikti, ndryshimi, të kundërtat (polet) janë ato që e mbajnë botën në këmbë, jo barazia e rrafshët dhe e vdekur.

⁵⁵ Beqari që trishtohet për martesën: poeti e nis me një rrëfim personal. Por kujdes, nuk po flet vetëm për unazën, po flet për institucionin që të mbron nga shteti.

⁵⁶ Mrekullia në gaforre (Çuda v rakje): Kjo është një idiomë ruse që lidhet me diçka të pamundur (kur gaforra të fishkëllej në mal). Ai nuk pret mrekulli, e di që martesa ka "gropa e zgafilella".

⁵⁷ Bashkëshortët si pronarë: Kjo është teza: Vetëm çifti zotëron vërtet atë që krijojnë në kënaqësi.

⁵⁸ "Mos bëj hajni" (Mos vidh): Ata nuk kanë nevojë për këtë urdhëresë, sepse ajo që është e tyre, është organike.

⁵⁹ Nëse shkatërrohet kjo celulë, do përfundojmë të gjithë lypës.

⁶⁰ Mbrojeni foshnjat: Thirrja finale. Mbrojeni familjen, se është e vjetra gjë që i shpëton fëmijët nga "makineria" e madhe.

⁶¹ Referencë nga Ungjilli (secilit hakun sipas veprave). Për Brodskin, kjo është drejtësia e vërtetë, jo barazia e dhunshme.


⁶² Poeti bën ironi me frikën. Është tallje e hollë me censurën.

⁶³ "Është kjo, që tash në pjesë na hyn": poeti nuk merret me ligje, por merret me atë që ligji i bën moralit të njeriut.

⁶⁴ Një provokim i pastër. Ai thotë se paraja i ngjan virtutit (ndoshta sepse të jep lirinë për të qenë i mirë).

⁶⁵ Një shprehje që e përdor për të përforcuar faktin se paraja nuk bie nga qielli si "manaja" (mëshirë hyjnore).

⁶⁶ Si paraja, ashtu edhe fjala e nderit, ikin shpejt.



Me to në borxh nuk duhet hyrë.
Me ne në varr s'kanë për t'u shtrirë.
Veç të shumohen u është prirë,
si në fabulat e Krillovit⁶⁷ njëherit.

19.

Mendimet e prapme - më t'forta i gjen.⁶⁸
Çdo shpirt një akullnajë kapërcen.⁶⁹
Sigurisht, shoqërisë një predikues i vlen
më shumë se një bravaxhi, shkencëtar.
Por, sa kohë askund profet nuk dëgjohet,
propozoj - që ende para kohet
në krah të vesit askush t'mos dorëzohet:
merruni me diç që ju vjen për mbarë.⁷⁰

20.

Me lumturinë e tjetrit, në thelb, s'jam
marrë;
Kjo duket gjest i bukur sqimatar.⁷¹
Veç përsosjen e brendshme kam parë.
Një lirë - gjysmë kanaçe - mesnat⁷² e vonë.
Për mua një dru vlen më shumë se pylli.⁷²
Me interes t'përgjithshëm s'më puqet ylli.
Por shpejtësia e përparimit të brendshëm⁷³
shpejtësinë e botës tejkalon.

21.

Për çdo izolim të njohur, ky është
fundament.
Miqësia me humnerën paraqet⁷⁴
interes të ngushtë lokal, vërtet,
në ditët tona. Pos kësaj, e papajtueshme

⁶⁷ Krillovi është La Fonteni i rusëve. Brodski ironizon "shumimin" e parave sikur të ishin personazhe kafshësh nëpër fabula.

⁶⁸ Mendimet e prapme: poeti thotë se ato që mendojmë "përmby" ose fshehurazi janë më të forta se ato që themi hapur.

⁶⁹ Shpirti i njeriut është aq i fuqishëm sa mund ta "lërë pas" (mundë) edhe një akullnajë.

⁷⁰ Që të mos biesh në kthetrat e vesit, gjej një punë. Puna si shpëtim nga çmenduria ideologjike.

⁷¹ Gjesti i bukur: poeti tall altruizmin e rremë të atyre që thonë se "duan njerëzimin" por nuk duan njeriun.

⁷² Triniteti i Brodskit: Mesnatë, alkool, poezi. Kjo është "zyra" e tij e punës. Pema vs Pylli: Ky është slogani i individualizimit. Pylli është ideologjia, pema është njeriu.

⁷³ Shpejtësia: Bota mund të vrapojë drejt progresit teknik, por poeti, i mbyllur në kasollen e tij me gjysmë shishe para, ecën më shpejt se bota në dimensionin shpirtëror.

⁷⁴ Miqësia me humnerën: Ky është imazhi kyç. Të merresh me "humnerën" (vdekjen, asgjë, ekzistencializmin) është diçka që nuk "shitet" dot në shoqëri, prandaj ai e quan "interes lokal" (diçka që i përket vetëm atij, jo masave).

është, sidoqoftë, kjo veti
me vëllazërinë, barazinë⁷⁵ që, gjithsesi,
nuk zëvendësohet as me fisnikëri,
te një burrë - është e papranueshme.⁷⁶

22.

Kështu, i përmalluar për epërsinë,
si Toptygini⁷⁷ që printe qeverinë,
po ju këndoj prodhimtarinë.
Po qe se, t'lartpërmendurën procedurë
gjithkush drejt do ta kuptojë,
arrin me t'mirë bij shoqëria jonë,
pishtarin e arsyes s'do ta lëshojë,
dhe do lumturojë çdo grua e burrë.

23.

Përndryshe - marrin përpjetë telepatët,
nudistët, spiritistët, preparatet,
frojdistët, neurologët, psikopatët,⁷⁸
trallisa, gjendja e euforisë,
do na diktojnë ligjet e veta.
Drogaxhinjtë ngjeshin grada në spaleta.⁷⁹
Shiringën do varin në vend të ikonës⁸⁰
së Shpëtimtarit dhe Shën Mërisë.

24.

Shpirtin do ta veshin me një vual.
Do na lidhin me t'pafundmin spiral.⁸¹
Do na vënë në prizë me etil-moral.⁸²
Ligjëratën nga folja do ta tëharrin.⁸³

⁷⁵ Këtu Brodski ironizon parullat e Revolucionit Francez dhe Socializmit. Njeriu që miqësohet me humnerën nuk mund të jetë pjesë e "tufës" apo e idealeve kolektive.

⁷⁶ Sipas moralit shoqëror, një burrë duhet të jetë "i dobishëm", "social" dhe "ndërtues". Melankolia dhe izolimi i thellë shihen si dobësi ose tradhti ndaj shoqërisë.

⁷⁷ Toptygin - figurë arketipale e ariut në folklorin rus (sidomos në fabulën satirike të Saltykov-Shchedrinit), shpesh përdoret si simbol i pushtetit të rëndë, të paditur ose burokratik.

⁷⁸ Brodski i fut të gjithë në një thes: mistikët e rinj (budistët, telepatët) dhe shkencëtarët e mendjes (frojdistët, neurologët). Për të, të gjithë këta janë "psikopatë" që kërkojnë të kontrollojnë njeriun.

⁷⁹ Narkomanët jo vetëm që do të sundojnë, por do të kenë pushtet zyrtar (ushtarak/policor).

⁸⁰ Droga bëhet feja e re. Shiringa zëvendëson Kryqin.

⁸¹ (Spirali i pafund) i pandërprerë: Humbja e individualitetit; të gjithë të lidhur në një strukturë të vetme teknologjike.

⁸² (Etil-moral): Një përzjerje mes alkoolit (etil) dhe moralit. Një lloj "etike" që të deh ose të mpin, që vjen përmes kabllit (prizës).

⁸³ Imazh i tmershëm antiutopik: Folja është veprim,

Libri gjithmonë ndez debate: disa e vlerësojnë, disa të tjerë e pëlqejnë, disa nuk e çojnë dot as në gjysmë, disa lënë kokën për të dhe kushedi se sa raste të tjera. Ama ka edhe disa libra, që duken sikur i ndajnë lexuesit me thikë në dy grupe: ose pendohesh që e lexove, ose e shndërron në një pjesë të personalitet tënd dhe je i gatshëm të zbrërthesh çdo një të mundshme. Zakonisht, këta libra janë ata që nuk të zhvendosin nga realiteti, por të vendosin mu në zemër të tij: në tensionin e heshtur midis dy njerëzve, si Mariana dhe Konelli. Në pamje të parë, historia e tyre duket e thjeshtë dhe asgjë jashtë përditshmërisë: dy të rinj irlandezë, nga dy botë sociale të ndryshme, të lidhur dhe të tërhequr nga njëri-tjetri në mënyrë të pashmangshme. Por poshtë këtij petku të qetë, romani vjen si një studim i thellë për pushtetin, turpin, gjuhën emocionale dhe paaftësinë për të kuptuar plotësisht veten dhe pastaj tjetrin.

Shkrirja e zërit: stili pa thonjëza

Pikërisht këtu hyn në lojë stili minimalist i Selli Runit, që shpesh e kap lexuesit të papërgatitur. Ajo zgjedh të mos përdorë thonjëza për dialogun, duke e shkrirë të folmen e personazheve me mendimet, ndjesitë e tyre dhe përshkrimin e mjedisit. Kjo teknikë duket sikur krijon një rrjedhë të pandërprerë, ku kufiri mes asaj që thuhet me zë të lartë dhe asaj që ndihet në heshtje bëhet pothuajse i padukshëm. Pa ato barrierat vizuale që zakonisht ndajnë dialogun nga rrëfimi, lexuesi humb në një lloj intimiteti që nuk i takon. Është një stil krejt i zhveshur nga çdo ngjyresë letrare, pa zbulurime, që të detyron të hysh brenda lëkurës së personazheve. Duke na e hequr distancën mbrojtëse që ofrojnë shenjat e pikësimit, Runi na lë të pambrojtur para teksteve dhe nënteksteve dhe na detyron t'i dëgjojmë personazhet jo me veshë, por përmes një rezonance të drejtpërdrejtë emocionale.

Trupi si gjuhë e përbashkët

Një nga temat më të forta të romanit është turpi, një strukturë e brendshme që formëson mënyrën si personazhet e shohin veten dhe njëri-tjetrin. Konelli vjen nga një familje e thjeshtë dhe punëtore dhe shpeshherë e ndien veten "të padukshëm" në hapësira sociale ku Mariana duket krejt e natyrshme. Nga ana tjetër, Mariana vjen nga një familje e pasur, por tepër e ftohtë, ku dashuria nuk është kurrë e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë. Ndryshe nga Konelli, ajo e di mirë që nuk përket në turmën e bashkëmoshatarëve të saj, po as përpiket të bëhet pjesë e tyre. Turpi i tyre nuk vjen kurrë njësoj, por funksionon si një gjuhë e përbashkët e pashprehur. Ata nuk flasin gjithmonë për atë çka ndiejnë, por e jetojnë këtë vorbull në mënyrë fizike, duke u hedhur nga një pauzë në tjetrën, mes keqkuptimeve, nëpër largime dhe rikthime.

Kjo ndjesi trupi shtrohet nga mënyra se si Runi trajton klasën shoqërore, aspak si manifest politik, por si një akth të vazhdueshëm që zor se largohet. Për Konellin, paraja dhe statusi janë barrierat që i vijnë nga pasiguria, ndërsa për Marianën, pasuria është një lloj burgu, që e ka lënë gjithmonë në vend numëro dhe të pambrojtur emocionalisht. Ky kontrast krijon një dinamikë të atillë, ku turpi nuk pasqyron vetëm individin në fjalë, por një shoqëri të tërë, që i etiketon njerëzit para se ata të njohin veten.

Mbi "Njerëz Normalë" të Sally Rooney-t, Onufri

A jemi vërtet "njerëz normalë"?

Nga Xhoina Salaj

Brishtësia e komunikimit të munguar

Një nga shtyllat më të forta të romanit është se kleçka e dashurisë midis dy të rinjve nuk vjen nga mungesa e ndjenjës, por nga mungesa e komunikimit. Mariana dhe Konelli e duan njëri-tjetrin, por nuk dinë se si ta artikulojnë dhe qëmtojnë këtë dashuri në mënyrë që të jetë e qëndrueshme, e jetueshme. Sa histori dashurie kemi dëgjuar, ku ndjenja nuk ka qenë kurrë problem, por çifti zor se ka gjetur urën e komunikimit me shoshogin? Autorja e trajton dialogun si një hapësirë tepër të brishtë: fjalët shpesh vijnë atëherë kur nuk duhen më, ose nuk thuhet fare. Ajo që mbetet gjithmonë e ndehur është një lloj inteligjence emocionale e fragmentuar, ku ata e kuptojnë njëri-tjetrin më shumë në distancë sesa kur janë pranë. Pikërisht kjo gjë e bën romanin të dhimbshëm në një mënyrë shumë moderne, ku nuk kemi temena, po një rrjedhë të vazhdueshme keqkuptimesh të vogla që, me kohën, bëhen fatale.

Mungesa e thonjëzave në dialog i bën këto keqkuptime edhe më të ngatërruara për lexuesit. Duke mos pasur shenja që ndajnë mendimin nga fjala, shpesh bëhemi dëshmitarë atëherë kur fjalitë mbeten ashtu në ajër, ose, kur një "po" e thënë mbyturazi nënkupton një "jo" të madhe. Kjo lloj proze imiton vetë ankthin social: atë çastin kur do të thuash diçka, por fjalët të mbeten në grykë, nga frika se si do të interpretohet.

Dinamikat e pushtetit dhe vetmia në çift

Në marrëdhënien e tyre, pushteti nuk lëviz vazhdimisht sa te njeri, tek tjetri. Në shkollë, Konelli ka "status social", ndërsa Mariana është e izoluar. Në universitet, dinamikat përmbysen dhe kthehet bumerang: Mariana bëhet më e qëndrueshme, më e çlirët dhe fillon të përkasë diku nëpër turma, ndërsa Konelli ndihet i pasigurt dhe i huaj. Ky ndryshim i vazhdueshëm i roleve krijon një tension të



hollë, ku asnjëri nuk e zotëron tjetrin, por as nuk arrin ta lërë plotësisht. Dashuria e tyre nuk e prek kurrë vijën e drejtë, por më shumë ngjan me një seri rikthimesh ku secili kërkon vetes përmes tjetrit. Po edhe kur janë bashkë, ata mbeten thellësisht të vetmuar. Kjo është ndoshta një nga arritjet më të forta të romanit, sepse nuk e sheh kurrë vetminë si mungesë, por si pamundësi për t'u bërë plotësisht i kuptueshëm për tjetrin.

Runi nuk përdor drama të mëdha apo kthesa të papritura për të të mbajtur gatitu mbi libër, por në vend të kësaj përdor kohën si mjet presioni. Kapitujt e ndarë me intervale kohore ("Tre muaj më vonë") krijojnë një ndjesi fragmentimi, siç është edhe vetë jeta e njerëzve në të njëzetat e tyre. Ne shohim vetëm majën e ajsgut të marrëdhënies së Marianës dhe Konellit dhe kuptojmë se pjesa më e madhe e rritjes, por edhe e dëmit, ndodh në hapësirat e bardha midis faqeve.

Trupi si terren i dorëzimit dhe si zonë e minuar

Në mungesë të komunikimit të plotë verbal, trupi shndërrohet në mjetin kryesor të shprehjes. Marrëdhënia e tyre intime vjen si një formë e të kuptuarit të ndërsjellë, që shpesh zëvendëson fjalët. Seksi më shumë vjen një si një lloj operacioni pa anestezi. Po edhe këtu shfaqet një paradoks shumë interesant: sa më shumë afrohen fizikisht, aq më e vështirë bëhet afërsia emocionale. Trupi nuk arrin të kompensojë boshllëqet e gjuhës. E megjithatë, pikërisht përmes kësaj afërsie fizike, Runi eksploron edhe temën e dorëzimit dhe të kontrollit. Për Marianën, intimiteti është shpesh një kërkim për ndëshkim ose vërtetim, ndërsa për Konellin është vendi i vetëm ku ai mund të jetë plotësisht i pranishëm, pa u fshehur pas maskës së djalit popullor apo studentit brilant.

Triumfi i të qenit "normal"

"Njerëz normalë" nuk vjen si ato Nromancat klasike ku ankthi të pëshpërit gjithë kohën: "A do të përfundojnë bashkë këta të dy?", sepse në kokë të vërtiten kushedi se sa pyetje të tjera, jo vetëm për personazhet, por edhe për ndjesitë dhe marrëdhëniet e tua; për herët kur ke heshtur atëherë kur duhej të flisje, apo për njerëzit që të kanë ndryshuar rrënjësisht pa qëndruar gjithmonë në jetën tënde. Ky libër nuk të stolis në fund të kapur me fongo, por të kujton se të jesh "normal", nuk do të thotë të jesh "i përsosur", të kesh një jetë pa dritëhije apo një marrëdhënie pa krisje. Përkundrazi, të jesh normal do të thotë të pranosh brishtësinë tënde, të humbësh dhe ta gjesh veten vazhdimisht tek tjetri, të kuptosh se triumfi më i madh nuk është domosdoshmërisht jetuan të lumtur përgjithmonë, por fakti që prania e tjetrit të ka bërë njeri më të plotë, më me këmbë në kokë dhe më të aftë për të dashuruar veten dhe të tjerët.

"I jashtëzakonshëm dhe prekës". OBSERVER

SALLY ROONEY

Njerëz normalë



Përktheu:
Andreas Dushi

Onufri

Karikaturë nga Arben Mexsi

